



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

DEPARTAMENTI  
PËR INTEGRIM  
EVROPIAN DHE  
KOORDINIM TË  
POLITIKAVE

**RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË  
VEPRIMIT KOMUNAL PËR  
NEGOCIMIN E MARRËVESHJES SË  
STABILIZIM ASOCIIMIT JANAR –  
DHJETOR 2013**

---

*Prishtinë, 2014*

# **PËRMBAJTJA**

- Hyrje
- Qëllimi i raportit
- Përmbledhje ekzekutive
- Kriteret politike
- Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve
- Aftësia për të përballuar obligimet që dalin nga MSA-ja
- Bujqësia
- Kontrolli financiar
- Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik
- Mjedisi dhe ndryshimet klimatike
- Bashkëpunimi financiar

## Hyrja dhe përmbledhja ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si autoritet mbikëqyrës i komunave, në vazhdimësi është përkushtuar të mbështes dhe të ndihmoj komunat me qëllim të përmbushjes së obligimeve të tyre në raport me proceset integruese evropiane. Gjithashtu, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në fushën e integriteteve evropiane ka rol koordinues dhe bashkërendues në mes të institucioneve lokale dhe atyre qendrore.

Në janar të vitit 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka publikuar Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit <sup>1</sup>pas konfirmimit të Këshillit të Bashkimit Evropian (datë 11 dhjetor të vitit 2012) se Kosova do të fillojë negociatat për MSA-në për shkak të përmbushjes së kriterëve.

Duke e ditur se Republika e Kosovës ka hyrë në një fazë të re të integriteteve evropiane, mobilizimi i institucioneve qendrore dhe atyre lokale ka qenë i menjëhershëm në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky plan.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas miratimit të PVMNSA-së ka punuar për së afërmi me komunat, Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim që të siguroj komunat se perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian është prioritet dhe rëndësi strategjike për Republikën e Kosovës.

Në këtë kontekst, duhet thënë se rruga më e mirë për të ecur përpara është përkushtimi në kryerjen e obligimeve e që për rezultat ndërthun përmirësimin e cilësisë së standardit jetësor dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik për të gjithë qytetarët.

Bazuar në atë që u tha më lartë, ofrimi i të dhënave nga komunat është mjaft i rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të tyre, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Raporti në fjalë pasqyron gjendjen reale të të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të mbeturave dhe sfidave për të ardhmen. Në kuadër të raportit, fokus u është dhënë fushave kryesore të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike dhe aftësisë për të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja. Këto fusha janë bazuar në Planin e Veprimit për Negocimin e MSA-së <sup>2</sup>.

Edhe pse Plani i Veprimit për Negocimin e MSA-së përbëhet nga 200 masa, prej të cilave 47 masa janë nën kapitullin e kriterëve politike, 19 nën kapitullin e kriterëve ekonomike dhe 133 nën aftësitë për të marrë përsipër detyrimet që realizojnë nga MSA, në këtë raport janë shkoqitur vetëm fushat dhe masat që ndërlidhen me komunat.

MAPL, ka dërguar në adresë të komunave pyetësorin për plotësim i cili është nxjerrë nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit. Në këtë drejtim, një pjesë e konsiderueshme e komunave të Republikës së Kosovës kanë raportuar për periudhën Janar - dhjetor të 2013. Është vërejtur se mënyra e raportimit të komunave në dhënien e përgjigjeve

---

<sup>1</sup> Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit

<sup>2</sup> Planin e Veprimit për Negocimin e MSA-së

është mikse, ku një pjesë e përgjigjeve janë konkrete, pjesa tjetër e përgjigjeve i takon mënyrës së përgjithësuar, ndërsa në pjesën tjetër nuk ka fare përgjigje.

Raporti nënvizon kontinuitetin e punës së komunave, sukseseve, të arriturave dhe paraqitjes së sfidave në përmbushjen e obligimeve. Në kuadër të raportit, fokus i veçantë i është dhënë forcimit të kapaciteteve të administratës në nivelin lokal (përfshirë edhe komunat e sapoformuara) përmes ofrimit të udhëzimeve administrative dhe rregulloreve nga niveli qendror në ngritjen e kapaciteteve, zbatimit të kurrikulës në gjuhën rome, sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit, decentralizimin e fondit për ri-integrim, hartimi i politikave, planeve dhe programeve zhvillimore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përmirësimi i infrastrukturës në zonat rurale, shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, zhvillimi i auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) në sektorin publik në harmoni me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve shëndetësore të gjitha komuniteteve minoritare, me prioritet komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, zbatimi i politikave mjedisore me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit, programet e bashkëpunimit ndërkufitar.

Institucionet qendrore kanë ofruar udhëzime administrative dhe rregullore në drejtim të komunave me qëllim të ngritjes së kapaciteteve lokale. Nga të dhënat e siguruar del të jetë se prej 33 komunave, vetëm 14 komuna kanë pranuar udhëzime administrative dhe rregullore, 10 komuna kanë ofruar përgjigje të përgjithësuar, 4 komuna nuk kanë pranuar udhëzime administrative dhe rregullore, kurse 5 komuna nuk janë përgjigjur fare. Numri i përgjithshëm i udhëzimeve administrative të pranuar nga komunat është 143 udhëzime dhe 31 rregullore.

Kur jemi tek niveli dhe numri i trajnimeve të ofruara nga komunat dhe ministritë për zyrtarët komunal, në bazë të të dhënave konstatojmë se numri i përgjithshëm i trajnimeve të mbajtura është 496. Po ashtu, pjesëmarrja e zyrtarëve komunal në këto trajnime ka qenë e evidente, ku në total 1088 zyrtar komunal kanë qenë pjesëmarrës të këtyre trajnimeve.

Sa i përket performancës në punë të punonjësve civil dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, pothuajse të gjitha komunat kanë dhënë vlerësimin e përafërt se në këtë drejtim është arritur një nivel i kënaqshëm, si dhe posedimi i avancuar i teknologjisë informative ka mundësuar një qasje më të shpejtë në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Gjithashtu, komunat janë mbështetur nga institucionet qendrore në pajisjen e programeve të reja (data bazave), e që për rezultat komunat kanë arritur të thjeshtëzojnë dhe shkurtojnë kohëzgjatjen e procedurave administrative. Duhet përmendur se tani qytetarët pajisen me ekstraktet e gjendjes civile me një procedurë të përshpejtuar përmes programit të cilin e ka lançuar niveli qendror.

Në çështjen e ngritjes dhe rritjes së besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara nga komunat, komunat kanë dhënë vlerësimin e tyre se ekziston një siguri e lartë në ruajtjen dhe lëshimin e dokumenteve.

Në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve, komunat kanë bërë përpjekje të vazhdueshme që të zbatojnë kurrikulën në gjuhën rome, sigurimin e qasjes në arsim dhe

luftimin e braktisjes së shkollimit. Vlen të theksohet se në një pjesë të komunave ku ka minoritete të komunitetit RAE, vërehet se ky komunitet më shumë është i fokusuar të mësoj në gjuhën shqipe se sa në atë rome. Ndërkaq, në disa komuna, komuniteti RAE ka shprehur interesimin të mësoj në plan programin e gjuhës serbe.

Lidhur me sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit, komunat dhe shkollat kanë ndërmarrë veprimet e duhura duke formuar ekipet për parandalim dhe reagim të braktisjes dhe mos - regjistrimit sipas U.A. 7/2011 të MASHT-it. Përmes këtyre ekipeve janë ofruar informata të nevojshme mbi arsimin dhe luftimin e braktisjes së shkollimit tek nxënësit, janë organizuar dhe siguruar transporte falas për nxënësit.

Sa i përket decentralizimit të fondit për ri-integrim, thjeshtësimin e procedurave për aplikim në këtë fond dhe përmirësimin e bashkëpunimit në mes të nivelit qendror dhe lokal, komunat janë përgjigjur se ende nuk menaxhojnë me këtë fond, përveç një numri të vogël të komunave janë përgjigjur se pjesërisht menaxhojnë me këtë fond. Kurse, për sa i përket nivelit të zbatimit të procedurave për aplikim në këtë fond, në disa komuna ka pasur vështirësi dhe probleme gjatë zbatimit të tyre, përderisa në pjesën tjetër të komunave këto procedura janë zbatuar në tërësi dhe pa probleme.

Së këndejmi, bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe lokal është treguar i kënaqshëm ku dhe janë mbajtur takime të rregullta me qëllim të shkëmbimit të informacioneve dhe lehtësimit në kryerjen e obligimeve të përbashkëta. Nuk kanë munguar edhe takimet e rregullta në mes të komunave, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare.

Në sektorin e bujqësisë një pjesë e komunave kanë hartuar programe dhe strategji për zhvillimin e bujqësisë konform master planit mbi zhvillimin e bujqësisë në Kosovë 2010-2013 dhe strategjinë komunale për zhvillim. Këto programe janë të zbatueshme për këto komuna, mirëpo pjesa tjetër e komunave nuk e posedojnë një plan të tillë.

Në këtë kontekst, komunat në bazë të planifikimeve dhe mundësive buxhetore, kanë ndarë mjete financiare për mbështetjen dhe modernizimin e sektorit privat të bujqësisë. Një mbështetje të veçantë për sektorin e bujqësisë kanë dhënë organizatat ndërkombëtare dhe ato jo - qeveritare. Kjo mbështetje e komunave dhe organizatave ndërkombëtare në këtë sektor ka mundësuar përmirësimin e efikasitetit në prodhim dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Në përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe të transportit në zonat rurale, komunat kanë realizuar projekte të ndryshme si në: rrugë, rrjet elektrik, sistemin e ujitjes, kanalizimet, transport etj. Në këtë drejtim, Grupet Lokale të Veprimit me ndikim në zonat rurale kanë luajtur rol të rëndësishëm në realizimin e këtyre projekteve, por që një pjesë e komunave ende nuk e kanë të themeluar GLV-në.

Tek shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, disa nga komunat kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në pyllëzimin e sipërfaqeve, ndërkaq pjesa tjetër e komunave nuk kanë ndërmarrë aktivitete. Krahas kësaj, janë bërë edhe kontrolle profesionale nga inspektorët me qëllim të mbrojtjes së pyjeve, ku dhe janë shqiptuar dënime për kundërvajtje dhe vepra penale

për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve. Niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale dhe nga zjarret lëviz nga komuna në komunë.

Në fushën e auditimit të brendshëm, njësia komunale për auditim të brendshëm është e themeluar dhe funksionale në 30 komuna, në 2 komuna NJKAB nuk është e themeluar, kurse 1 komunë nuk ka ofruar përgjigje. Ndërkaq, sa i përket komitetit të auditimit, 23 komuna e kanë të themeluar këtë komitet, 5 komuna ende nuk e kanë themeluar, ndërsa 5 komuna nuk kanë ofruar përgjigje.

Punësimi, politikat sociale dhe politikat e shëndetit publik janë disa nga fushat për të cilat komunat kanë ndërmarrë masa duke nxjerrë strategji komunale, përfshirë edhe OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale. Njëkohësisht, komunat kanë miratuar edhe Planin e Veprimit në të cilin përfshihen komunitetet pakicë (në këtë rast komunitetit RAE) të cilët kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore sikurse të gjitha komunitet e tjera.

Çështjet mjedisore dhe ndryshimet klimatike si fusha prioritare dhe jetike për vendin, karakterizohen me disa nën fusha të tjera në të cilat përfshihet ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin e mjedisit, trajnimet për zbatimin e legjislacionit mjedisor, trajnimet për inspektorët komunal të ambientit, trajnimet për zyrtarët komunal në trajtimin e vendbanimeve jo – formale, për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane, zbatimin e planit lokal të veprimit në mjedis, planet komunale për menaxhimin e mbeturinave etj.

Niveli lokal dhe qendror kanë bashkëpunuar ndërmjet vete në sektorin e mjedisit duke zhvilluar projekte të ndryshme mbi mbrojtjen e ambientit dhe duke mbajtur aktivitete me qëllim të pastrimit të ambientit. Po ashtu, zbatimi i planit lokal të veprimit në mjedis dhe planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, ndikojnë dukshëm në komuna dhe japin efektin pozitiv të menaxhimit të qëndrueshëm të ambientit dhe krijimit të hapësirave të reja gjelbëruese. Si shkaktar kryesor për ndotjen e ambientit në komuna konsiderohen gurëthyesit të cilët nuk respektojnë ligjet dhe aktet nënligjore.

Sa i përket programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, vetëm komunat të cilat përkufizohen me zonat kufitare kanë ofruar të dhënat. Nga komunat që mund të përmendim dhe të cilat kanë realizuar projektet janë: komuna e Deçanit me 27 projekte, komuna e Gjakovës 41 projekte, komuna e Prizrenit dhe Kamenicës me nga 1 projekt dhe komuna e Dragashit me 2 projekte të realizuara.

## **Qëllimi i raportit**

Raporti ka për qëllim prezantimin dhe ofrimin e të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, si dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e të arriturave dhe sfidave, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Hartimi i dokumentit është bërë për secilën fushë veç e veç, duke përfshirë të dhënat e komunave në tre fusha kryesore, si: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe aftësitë për të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja.


Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 33 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që për komunën e Suharekës, Parteshit, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk janë raportuar aktivitetet.

Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, veçanërisht gjetjet e paraqitura si ngecje apo sfidë, do të shërbejnë në të mirë të komunave me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë institucionale dhe ndërmarrjes së hapave konkret drejt përmirësimit dhe plotësimit të kriterëve (në fushën e integriteteve evropiane) të përcaktuara nga BE.


## 1. KRITERET POLITIKE

### **Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, duke përfshirë komunat e sapo formuara, si dhe duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal**


Forcimi i administratës në nivelin komunal ka vazhduar edhe për vitin 2013. Niveli qendror ka ofruar udhëzimet e nevojshme me qëllim të ngritjes së kapaciteteve administrative në komuna. Të dhënat e ofruara nga komunat pasqyrojnë vlerën numerike apo statistikore të pranimi të udhëzimeve nga niveli qendror. Duhet theksuar se po thuajse të gjitha komunat me termin “*udhëzim*” kanë nënkuptuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me “*udhëzime administrative*” dhe “*rregullore*” të ofruara nga niveli qendror, përkundër pyetjes së qartë e cila është e formuluar dhe parashtruar në Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ku thuhet se “*A kanë ofruar ministritë udhëzime në ngritjen e kapaciteteve administrative në komunën tuaj si dhe si janë zbatuar këto udhëzime*”. Në këtë drejtim, pasqyrimi i të dhënave të postuara në raport është bërë mbi bazën e përgjigjeve të dhëna nga komunat. Së këndejmi, nga të dhënat e ofruara nga komunat për këtë fushë, komuna e Gjilanit prinë në raport me komunat e tjera lidhur me pranimin e udhëzimeve ku gjithsejtë ka pranuar 55 udhëzime administrative, komuna e Ferizajt ka pranuar 35 udhëzime, në komunën e Pejës janë ofruar 17 rregullore me të cilat është rregulluar funksionimi i Shërbimit Civil, ZAMV 14 udhëzime, në komunën e Mitrovicës janë ofruar 13 udhëzime, komuna e Malishevës 10 rregullore, në komunën e Junikut 8 udhëzime, komuna e Vushtrisë është përgjigjur se kanë pranuar 5 udhëzime, komuna e Gjakovës, Deçanit dhe Lipjanit kanë pranuar vetëm nga 1 rregullore, komuna e Podujevës dhe Shtimes nga niveli qendror kanë pranuar nga 4 udhëzime, komuna e Prizrenit ka pranuar 3 udhëzime, komuna e Obiliqit 2 udhëzime, komuna e Kamenicës, Istogut dhe Skenderajt nuk kanë pranuar asnjë udhëzim nga niveli qendror, komuna e Prishtinës, Klinës, Graçanicës, Rahovecit, Fushë Kosovës, Drenasit, Shtërpçës, Hanit të Elezit, Novobërdës, Mamushës dhe Kaçanikut kanë ofruar përgjigje të përgjithësuara, kurse komuna e Ranillugut, Dragashit, Vitisë dhe Klllokotit nuk kanë ofruar përgjigje.



*Tab.1. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave*



*Tab.2. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave*



*Tab.3. Numri i Udhëzimeve dhe Rregulloreve të Komunave*



## **Disa nga udhëzimet e ofruara nga Ministritë për nivelin lokal:**

- 1.U.A.01/2011 për menaxhimin dhe përdorimin e Internetit në Institucionet e Republikës së Kosovës;
- 2.U.A.03/2011,për Ueb faqet e Instit.Publike;
- 3.U.A.02/2010 për menaxhimin e Sigurisë Informative;
- 4.U.A.03/2010 për përdorimin e Softuerit dhe Harduer-it;
- 5.U.A.04/2010 për shfrytëzimin e postës elektronike zyrtare;
- 6.U.A.03/2011 për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimeve të qytetarëve në Komuna;
- 7.U.A.02/2011 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- 8.U.A.09/2008 për transparencë në Komuna;
- 9.U.A.08/2008 për marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunave me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane;
- 10.U.A.08/2007 për themelimin e njërive për të drejtat e njeriut në Komuna;
- 11.U.A.2005/08 për përcaktimin e kompetencës dhe përshkrimin e detyrave të punës të zyrtarit për barazi gjinore;
- 12.Nr.05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civile;
- 13.U/A NR.01/2013 për dokumentet e gjendjes civile;
- 14.U/A Nr.03/2013 për vulën verifikuese;
- 15.U.A.Nr.2011/03 për organizimin dhe funksionimin e qendrave për qytetarët në komuna;
- 16.U.A.Nr.03/2011 për funksionimin e QSHQ.
- 17.U.A.2012/1 për monitorimin e K.K.përmes Teknologjisë informative-Teleprezencave

## **ZBATIMI I UDHËZIMEVE TË OFRUARA NGA NIVELI QENDROR**

### **Niveli i zbatimit të udhëzimeve**

Lidhur me zbatimin e udhëzimeve të ofruara nga niveli qendror për nivelin lokal, duhet përmendur se edhe në këtë fushë komunat u janë referuar udhëzimeve administrative si term dhe jo udhëzimeve në kuptimin e përgjithshëm të tyre. Më tej, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar përgjigje duke thënë se të gjitha udhëzimet janë të zbatueshme, komunat si: Gjakova, Gjiçani, Mitrovica, Malisheva, Lipjani, Prizreni, Ferizaj, Kaçaniku, Istogu, Hani i Elezit, Klllokot, Klina, Drenasi, Juniku, Shtërpca, Deçani, Fushë Kosovë, Shtimja, Skenderaj, Peja, Vushtrria, Podujeva, Vitia, Mamusha, Obiliqi dhe Novobërda. Kurse, komuna e Kamenicës, Ranillugut, Dragashit, Prishtinës, Rahovecit, Graçanicës dhe ZAMV-së nuk kanë ofruar përgjigje.

## **NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE NË NIVELIN LOKAL**


### **Numri i trajnimeve të ofruara nga komuna**

Lidhur me numrin e trajnimeve të ofruara nga komuna, numri i mbajtjes së trajnimeve varion nga komuna në komunë. Në këtë drejtim, të dhënat e ofruara nga komunat janë si në vijim: në komunën e Gjakovës, Pejës, Klllokotit, Vushtrrisë dhe Shtimes 0 trajnime, në komunën e Lipjanit

janë mbajtur 63 trajnime jashtë vendit dhe 8 trajnime të mbajtura brenda komunës, në atë të Drenasit 37, në komunën e Dragashit 26, në komunën e Ferizajt 21 trajnime, kurse në komunën e Kaçanikut janë mbajtur 20. Në komunën e Istogut janë ofruar 19 trajnime, në komunën e Junikut 17 trajnime, në komunën e Skenderajt 16 trajnime, në komunën e Deçanit 10 trajnime, në komunën e Gjilanit 7 trajnime, në komunën e Malishevës 6 trajnime, komuna e Podujevës ka organizuar 4 trajnime për zyrtarët e gjendjes civile, si dhe trajnime të tjera të vazhdueshme për sektorët tjerë, në komunën e Kamenicës janë mbajtur 3 trajnime, në komunën e Obiliqit 2 trajnime, në komunën e Prishtinës dhe Prizrenit nga 1 trajnim të mbajtur. Në komunën e Klinës janë organizuar trajnime nga MAPL, MAP, IKAP. ZAMV-ja ka ofruar përgjigje të përgjithësuar ndërsa, sa i përket komunës së Fushë Kosovës, Rahovecit, Graçanicës, Mitrovicës, Shtërpçës, Ranillugut, Vitisë, Novobërdës, Mamushës dhe Hanit të Elezit këto komuna nuk kanë ofruar përgjigje. Marrë në përgjithësi, *numri i përgjithshëm i trajnimeve të mbajtura është 261.*

### Numri i trajnimeve të ofruara nga ministrinë

Qeveria e Kosovës, përkatësisht ministrinë kanë ofruar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve tek niveli lokal (komunat). Komuna e Ferizajt prinë për nga numri i trajnimeve të mbajtura me gjithsejtë 42 trajnime, në komunën e Drenasit 37 trajnime, në komunën e Novobërdës janë mbajtur 25 trajnime, pasuar nga komuna e Dragashit me 21 trajnime. Komuna e Istogut ka mbajtur 17 trajnime, ZAMV 14 trajnime, kurse në komunën e Prizrenit dhe Kaçanikut janë ofruar nga 12 trajnime, në atë të Ranillugut 11 trajnime, në komunën e Pejës 8, në komunën e Shtërpçës 7 trajnime, në komunën e Klinës 5 trajnime, në atë të Gjilanit, Podujevës dhe Mitrovicës nga 4 trajnime, në komunën e Deçanit janë ofruar 4 trajnime nga MAPL, ndërsa ka pasur trajnime edhe nga KE, USAID, GIZI, OSBE, në komunën e Gjakovës dhe Shtimes nga 3 trajnime, si dhe në komunën e Fushë Kosovës dhe Vushtrrisë nga 1 trajnim. Komuna e Kllotit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se të gjitha drejtorit kanë pasur trajnim të organizuara nga ministrinë përkatëse. Tek numri i trajnimeve të ofruara nga ministrinë në komunën e Vitisë plani i trajnimeve për vitin 2013 është dërguar nga MAP - IKAP dhe i është dorëzuar zyrës së personelit.



Tab.4. Numri i trajnimeve të ofruara nga Komunat dhe Ministrinë

Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion për numrin e trajnimeve janë: Fushë-Kosova, Gllgovci, Istogu, Rahoveci, Suhareka, Hani i Elezit, Mamusha, Kllokoti, Parteshi, Ranillugu, Graçanica, Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveqani.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, *numri i përgjithshëm i trajnimeve të ofruara nga Qeveria e Kosovës ( ministritë) për komunat, del të jetë 235.*

### **Numri i punëtorëve që kanë marrë pjesë në trajnim**

Numri i nëpunësve të komunës të cilët kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga komuna dhe ministritë, del të jetë si në vijim: në komunën e Dragashit numri i nëpunësve civil të cilët kanë marrë pjesë në trajnim është 260, në komunën e Gjilanit 151 nëpunës civil, në komunën e Prizrenit 94 nëpunës civil, në komunën e Pejës dhe Istogut nga 84 nëpunës civil janë trajnuar, në komunën e Drenasit 78, në komunën e Ferizajt kanë marrë pjesë 63 nëpunës civil, në komunën e Skenderajt 45 nëpunës civil, në komunën e Podujevës 42, kurse në komunën e Kaçanikut 40 nëpunës civil. Në ZAMV 36 nëpunës civil, në komunën e Gjakovës kanë marrë pjesë 34 nëpunës, në komunën e Kllokotit 30 nëpunës civil, në komunën e Obiliqit janë trajnuar gjithsejtë 20 nëpunës civil, në komunën e Vushtrrisë janë trajnuar gjithsejtë 19 nëpunës civil, në komunën e Kamenicës kanë marrë pjesë 18 nëpunës civil, në komunën e Shtimës 16, në Shtërpcë 15, në komunën e Vitisë 13 nëpunës civil, ndërkaq në atë të Ranillugut 12, në komunën e Junikut 9 punëtor, në Klinë kanë marrë pjesë 7 nëpunës civil, si dhe në komunën e Deçanit kanë marrë pjesë 2 zyrtar. Komuna e Malishevës, Lipjanit, Mamushës, Hanit të Elezit, Rahovecit, Mitrovicës, Graçanicës, Novobërdës dhe Fushë Kosovës nuk kanë ofruar përgjigje për numrin e nëpunësve civil të cilët kanë marrë pjesë në trajnim. Komuna e Prishtinës ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se në trajnim kanë marrë pjesë zyrtarët e lartë për çështje juridike të gjitha drejtorive të komunës së Prishtinës. *Në total, numri i nëpunësve civil të komunave të cilët kanë marrë pjesë në trajnim është 1088.*

### **Ngritja e performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Klinës, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Novobërdë, Malishevës, Prizrenit, Kamenicës, Dragashit, Drenasit, Deçanit, Ferizajt, Junikut, Istogut, ZAMV dhe Fushë Kosovës performanca është duke u ngritur në vazhdimësi. Komuna e Lipjanit është përgjigjur se me datë 18.08.2013 në kuadër të aplikacionit të intranetit është futur edhe moduli i arkës elektronike, ku në kuadër të këtij moduli funksionon edhe sistemi i rregullimit të radhëve sipas sporteleve të caktuara. Krahasuar me vitin e kaluar, në këtë vit, perceptimi i qytetarëve për komunën e Lipjanit lidhur me efikasitetin në administrim, bazuar në raportin e performancës të USAID-it dhe MAPL -së ka shënuar rritje në 30% në kënaqshmërinë e qytetarëve që ofron komuna. Komuna e Kaçanikut, Hanit të Elezit, Shtërpcës, Rahovecit, Mamushës, Prishtinës dhe Graçanicës nuk kanë ofruar përgjigje. Komuna e Ranillugut, Vitiës dhe Kllokotit kanë ofruar përgjigje të përgjithësuar. Në Mitrovicë ngritja e performancës për vitin 2013 është 98.26%.

## **Thjeshtëzimi i procedurave administrative dhe shkurtimi i kohëzgjatjes së procedurave**

Lidhur me thjeshtëzimin e Bazuar në të dhënat e ofruara nga komunat, në komunën e Gjakovës janë thjeshtëzuar shumë procedura administrative nga të cilat vlen të cekem: marrja ekstrakteve nga ofiqarit, regjistrimi i bizneseve, si dhe përgjigja në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, në komunën e Gjilanit, Pejës, Obiliqit, Novobërdës, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Dragashit, Kamenicës, Klinës, Fushë Kosovës, Deçanit, Prizreni, Ferizajt, Hanit të Elezit, Lipjanit, Drenasit, Shtërpçës, Junikut dhe Podujevës procedurat administrative gjithnjë janë duke u thjeshtëzuar, ndërkaq komuna e Malishevës, Kaçanikut, Rahovecit, Mitrovicës, Graçanicës, Ranillugut, Klokotit Vitisë, Mamushës, Prishtinës dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje.

## **Ngritja e sigurisë së Dokumenteve**

Tek ngritja e sigurisë së dokumenteve, komunat si: Gjakova, Kamenica, Ferizaj, Gjilani, Istogu, Dragashi, Klokoti, Klina, Deçani, Drenas, Shtërpça, Skenderaj, Obiliq, Shtime, Vushtri, Podujeva, Peja dhe Fushë Kosova janë përgjigjur se janë në nivelin e duhur dhe sipas standardeve të parapara. Ndërkaq, komunat të cilat kanë ofruar përgjigje më konkrete dhe më të zgjeruar janë si: komuna e Prizrenit e cila në vitin 2013 ka ndërtuar objektin e ri dhe përmirësuar kushtet në infrastrukturë për stafin elemente këto që kanë bëjnë me ngritjen e sigurisë së dokumenteve, ndërsa në komunën e Ranillugut dokumentet ruhen në dollapë të mbyllura. Në komunën e Mitrovicës sistemi unik i MPB-së për sektorët e gjendjes civile ka ndikuar shumë në ngritjen e sigurisë së dokumenteve. Më tej, sigurimi i dokumenteve administrative që lëshohen në ZAMV është rritur me faktin se të njëjtat lëshohen me ndihmën e programeve që janë instaluar nga ana e nivelit qendror. Së fundi, komuna e Malishevës, Lipjanit, Kaçanikut, Junikut, Hanit të Elezit, Graçanicës, Vitisë, Mamushës, Prishtinës, Novobërdës dhe Rahovecit nuk kanë ofruar përgjigje.

## **Rritja e besueshmërisë në dokumentet e lëshuara nga komuna**

Sa i përket rritjes së besueshmërisë në dokumentet e lëshuara nga komuna, komunat të cilat kanë raportuar, nuk kanë cekur asnjë rast të dyshimtë apo falsifikim dokumentesh në komunat e tyre, në vijim janë komunat: Gjakova, Lipjani, Ranillugu, Drenas, Istogu, Prizreni, Gjilani, Vushtria, Obiliqi, Podujeva, Shtime, Dragashi, Klokoti, Kamenica, Klina, Deçani, Fushë Kosova, Ferizaj, Peja, ndërsa komunat si: Rahoveci, Mitrovica, Graçanica, Malisheva, Vitia, Hani i Elezit, Skenderaj, Prishtina, Novobërda, Mamusha dhe Kaçaniku nuk kanë ofruar të dhëna. Duhet të nënvizohet se vetëm këto komuna kanë dhënë përgjigje më të detajuara: Komuna e Junikut ka theksuar se siguria është në nivel të lartë si dhe besueshmëria e dokumenteve është e kënaqshme, po ashtu ka theksuar se nuk ka pasur asnjë dokument të dyshimtë të kontestuar. Në ZAMV besueshmëria e dokumenteve të lëshuara është rritur me instalimin e sistemit elektronik i cili nuk lejon që të bëhen gabime.

Në komunën e Shtërpçës ekziston siguria në dokumente të lëshuara nga QKRC-t dhe në komuna sigurimi i objekteve është 24 orë pa ndërprerë, ndërkaq arkivimi i dokumenteve bëhet në mënyrë të digjitalizuar.

## **VAZHDIMI I PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT PËR KOMUNËN E MITROVICËS SË VERIUT**

### **Faza në të cilën ndodhet Komuna e Mitrovicës së Veriut lidhur me procesin e decentralizimit**

Zyra e Mitrovicës së Veriut është themeluar me Vendimin e Qeverisë nr. 01/75 të datës 23.05.2012. Sipas këtij vendimi, ZAMV ofron të gjitha shërbimet për qytetarët e Mitrovicës së Veriut, siç është parashikuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Pjesa ekzekutive është themeluar dhe organizuar në shtatë drejtori të cilat janë funksionale dhe ofrojnë shërbime për qytetarët. Janë mbajtur zgjedhjet për Kuvendin Komunal dhe për Kryetarin e Komunës, si dhe janë konfirmuar rezultatet. Kryetari i Komunës nuk e ka dhënë betimin, ashtu që pushteti ekzekutiv nuk është themeluar. Kuvendi i Komunës nuk e ka mbajtur seancën inauguruese, ashtu që nuk janë formuar as organet komunale. Deri në themelimin e pushtetit ekzekutiv, të gjitha shërbimet komunale edhe më tutje i ofron Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut.

## **2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE**

*Zbatimi i kurrikulës në gjuhën rome, sigurimi i qasjes në arsim si dhe luftimi i braktisjes së shkollimit*

Niveli i zbatimit të kurrikulës në gjuhën rome (p.sh. cila pjesë e kurrikulës zbatohet, cila nuk zbatohet fare dhe cilat janë arsyet, etj) [\(po e ri-përsëris...informatat nga ky kapitull të verifikohen dhe harmonizohen me divizionin e të drejtave të njeriut...\)](#)

Komuna e Gjakovës ka dhënë përgjigje konkrete lidhur me këtë pyetje duke theksuar se nuk ka të interesuar për të mësuar gjuhën rome, nxënësit romë mësojnë në gjuhën shqipe, në komunën e Gjilanit nxënësit romë mësimin e ndjekin në shkollat serbe dhe punojnë me kurrikulë të R. Serbisë (nuk e respektojnë kurrikulën e MASHT-it), në komunën e Malishevës, Kamenicës, Kaçanikut, Istogut, Hanit të Elezit, Dragashit, Klinës, Deçanit, Rahovecit, Drenasit, Shtërpçës, Junikut, Shtimes, Vitisë, Mamushës, Vushtrisë, Skenderajt, Pejës, Novobërdës, Prishtinës dhe Fushë Kosovës nuk zbatohet kurrikulë në gjuhën rome, në komunën e Lipjanit zbatohet kurrikulë në gjuhën rome kryesisht në shkollat që kanë klasë rome më shumë si në Janjevë, në komunën e Prizrenit nuk ka kurrikulë për gjuhën rome nga se nxënësit romë mësojnë së bashku me nxënësit tjerë, në komunën e Ferizajt nuk ka filluar të aplikohet, ndërsa në komunën e Ranillugut nuk ka romë në territorin e saj. Komuna e Klokotit kanë dhënë përgjigje të përgjithshme duke thënë se aty ku ekzistojnë komunitetet veprohet konform ligjeve ekzistuese në fuqi ndaj këtij komuniteti. Në ZAMV niveli i zbatimit dhe implementimit të programit arsimor për minoritetin romë është reduktuar në vijimin e shkollës fillore e cila është e obligueshme sipas ligjit, kurse komuna e Graçanicës nuk ka dhënë përgjigje. Në komunën e Mitrovicës korniza e re e kurrikulës së Kosovës është në fazën fillestare. Në komunën e

Podujevës numri i komunitetit RAE është i vogël dhe të gjithë ata që vijojnë mësimin janë të përfshirë në arsim të rregullt në gjuhën shqipe, në komunën e Obiliqit mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe dhe serbo – kroate. Me fillimin e mësimave në sh.f.m.U. Dr.I.Rugova do të jenë dhe dy paralele me nxënës nga minoritetet të cilët do të kenë nga një tutor për mësim shtesë apo për nxënësit që kanë mbetur mbrapa me mësim.

### **Numri i nxënësve që mësojnë në gjuhën rome**

Në komunën e Gjilanit numri i nxënësve që mësojnë në gjuhën rome është 102( para fillor, fillor dhe të mesëm), në komunën e Shtërpcës janë 6 nxënës që mësojnë në gjuhën serbe, në komunën e Malishevës nuk posedojnë klasë në gjuhën rome për arsye se nuk ka numër të madh të familjeve rome, në komunën e Lipjanit numri i nxënësve që mësojnë në gjuhën rome në shkollën e ulët fillore është 48, mirëpo ka edhe nxënës që mësimin e vijojnë në gjuhën kroate, në komunën e Prizrenit numri i nxënësve që mësojnë në gjuhën rome është 864 nga para fillorja deri në klasën e IX-të, komuna e Kamenicës nuk ka dhënë numër të caktuar për rastet se sa nxënës mësojnë gjuhën rome por ka cekur se nxënësit romë të cilët përcjellin mësimin në gjuhën serbe mësojnë edhe gjuhën rome. Komuna e Ferizajt është përgjigjur se të gjithë nxënësit romë mësojnë në gjuhën shqipe dhe ndjekin mësimin në shkolla të rregullta. Në komunën e Ranillugut nuk ka romë në territorin e saj, komuna e Hanit të Elezit, Dragashit, Kllokotit, Mamushës, Obiliqit, Vitisë dhe ZAMV nuk kanë ofruar informacione lidhur me këtë fushë. Komuna e Vushtrrisë është përgjigjur se nuk kanë klasë të veçantë për këtë komunitet, në komunën e Prishtinës nxënësit e komunitetit RAE që mësojnë në gjuhën shqipe janë: 52 në SHF “Emin Duraku”, 20 në SHF “Asim Vokshi” 7 në SHF “Gjergj Fishta, në komunën e Novobërdës numri i nxënësve të komuniteti romë është 18 nënës: parashkollorë janë 2 nxënës romë: klasa e parë 2 nxënës romë: klasa e dytë 2 nxënës romë: klasa e tretë 4 nënës romë: klasa e katër 2 nënës romë: klasa e pestë 2 nënës romë: klasa e gjashtë 2 nënës romë: klasa e shtatë 1 nënës romë: klasa e tetë 1 nënës romë. Komunitet tjerë nuk kanë nxënës që mësojnë në gjuhën rome,

### **Numri i mësuesve në gjuhën rome**

Tek numri i mësuesve në gjuhën rome komuna e Gjakovës, Malishevës, Istogut Klinës, Deçanit, Drenasit, Shtërpcës, Junikut, Rahovecit, Ranillugut, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Pejës, Novobërdës, Kaçanikut dhe Fushë Kosovës kanë dhënë përgjigje se nuk kanë mësues në gjuhën rome, në komunën e Gjilanit janë 20 mësues të gjuhës rome, në komunën e Lipjanit është 1 mësues i gjuhës rome, në komunën e Prizrenit janë 4 mësues të gjuhës rome, në komunën e Kamenicës është vetëm 1 mësues. Komuna e Ferizajt, Hanit të Elezit, Dragashit, Kllokotit, Mitrovicës, Graçanicës, Mamushës, Obiliqit, Vitisë, Prishtinës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje.

### **Numri i orëve të mbajtura në gjuhën rome**

Në këto komuna nuk është mbajtur asnjë orë në gjuhë rome në komunën e Gjakovës, Klinës, Deçanit, Drenasit, Shtërpcës, Junikut, Rahovecit, Mitrovicës Fushë Kosovës Kaçanikut, Istogut, Shtimes, Vushtrrisë, Podujevës, Pejës, Skenderajt dhe Ranillugut, në komunën e Gjilanit numri i

orëve të mbajtura në gjuhën rome është 20, nxënësit romë mësojnë në gjuhën shqipe, në komunën e Malishevës nuk është mbajtur asnjë orë në gjuhën rome, në komunën e Lipjanit mbahen nga 4 orë në javë në gjuhën rome, komuna e Prizrenit, Ferizajt, Hanit të Elezit, Dragashit, Graçanicës, ZAMV-s, Mamushës, Obiliqit, Prishtinës dhe Kllokotit nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Kamenicës numri i orëve të mbajtura në gjuhën rome është 8 orë në muaj, kurse në komunën e Novobërdës numri i orëve është 40 orë në javë.

## **NIVELI I BRAKTISJES SË SHKOLLIMIT**

### **Numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën fillore dhe të Mesme të Ulët (obligative)**

Në komunën e Malishevës janë shënuar 28 raste të nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën fillore, në komunën e Gjilanit 4 nxënës e kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët, në komunën e Lipjanit, Mamushës, Pejës, Novobërdës, Vushtrrisë, Kamenicës, Gjakovës dhe Podujevës nuk ka nxënës të cilët e kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët, në komunën e Prizrenit 18 nxënës kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët, në komunën e Ferizajt numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën fillore të mesme të ulët është gjithsejtë 260 nxënës, kurse komuna e Mitrovicës, Graçanicës, Junikut, Kaçanikut, Ranillugut, Dragashit, Obiliqit dhe Kllokotit nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Istogut numri i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët është 37 nxënës, kurse në komunën e Hanit të Elezit numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët (obligative) është 2. Në komunën e Klinës numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët është 118, Fushë Kosovë 25 nxënës për të gjitha komunitetet, në komunën e Deçanit numri 78, Drenas 23, në Shtërpçë nuk ka nxënës romë, në Rahovec 71 nxënës që kanë braktisur shkollën. Në ZAMV fillimi i vitit shkollor ka shfaqur përsëri problemin e parregullsisë pasi që moti i mirë iu mundëson fëmijëve të kësaj moshe të punojnë dhe të fitojnë edhe më tutje, mirëpo nuk janë vërejtur mungesat e vullnetshme nga mësimi të cilat do të sinjalizojnë braktisjen përfundimtare të sistemit arsimor. Tek niveli i braktisjes së shkollimit në komunën e Vitisë që kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët (obligative) është 10 nxënës (konsiderohet për arsye migrimi etj.), në komunën e Shtimës numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët – është 3 nxënës, në komunën e Skenderajt numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën fillore dhe të mesme të ulët është 290, komuna e Prishtinës është përgjigjur se problemi i braktisjes së shkollimit të Komunitetit RAE fillon nga klasa e VI-IX, drejtorja e arsimit të komunës së Prishtinës e ka mundësuar arsimin joformal në shkollën fillore “Emin Duraku”, nxënësit e komunitetit RAE janë të shpërndarë nëpër klasa me nxënësit shqiptarë dhe e vijojnë mësimin në gjuhën shqipe.

### **Numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën e Mesme të Lartë (shkollim jo obligativ)**

Në komunën e Gjakovës 57 nxënës kanë braktisur shkollën e mesme të lartë, në komunën e Gjilanit 1 nxënës e kanë braktisur shkollën e mesme të lartë, në komunën e Malishevës 68 nxënës kanë braktisur shkollën e mesme të lartë, në komunën e Lipjanit, Podujevës, Novobërdës, Kamenicës, Shtërpçës dhe Pejës nuk ka nxënës të cilët e kanë braktisur shkollën e mesme të lartë, komuna e Prizrenit nuk ka ofruar informata rreth numrit të braktisjes së nxënësve të shkollave të Mesme të Lartë ngase nxënësit e kësaj kategorie nuk deklarohen se a janë RAE. Në komunën e Ferizajt shkollimin e mesëm të lartë e kanë braktisur gjithsejtë 310

nxënës, kurse komuna e Kaçanikut nuk ka ofruar përgjigje. Numër i lartë i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën e mesme të lartë është shënuar edhe në komunën e Istogut me gjithsejtë 70 nxënës, komuna e Ranillugut, Drenasit, Junikut, Mitrovicës, Graçanicës, Fushë Kosovës, Dragashit, Prishtinë, Mamushë dhe Klllokotit nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq në komunën e Hanit të Elezit numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën e mesme të lartë (shkollim jo obligativ) është 2. Në komunën e Klinës numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën e mesme të lartë është 23, në komunën e Deçanit 14, në Rahovec 129 nxënës e kanë braktisur shkollën e mesme të lartë. Në ZMAV, vijimi i arsimit të mesëm gati sa nuk ekziston, pasi që komuniteti rom për shkak të jetës së tyre tradicionale nuk i jep rëndësi arsimit profesional, posaçërisht për pjesëtarët e gjinisë femërore dhe sidomos vajzat të cilat janë në moshë për shkollën e mesme kryesisht janë të martuara ose janë nëna. Numri i deritanishëm i nxënësve të cilët e vijojnë arsimin fillor mbetet i njëjtë. Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën e mesme të lartë (shkollim jo obligativ) në komunën e Vitisë është 76 nxënës (për vitin akademik 2013-2014) supozohet se një numër i tyre kanë ndërruar shkollën e kanë lënë dhe disa kanë migruar, në komunën e Shtimes dhe Vushtrrisë numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën e mesme është nga 1, në komunën e Skenderaj është 124 nxënës, në komunën e Obiliqit 10 nxënës që kanë braktis shkollimin për arsye financiare.

#### **Numri i nxënësve të rikthyer në shkolla (pas braktisjes)**

Komuna e Gjakovës nuk posedon shënime lidhur me pyetjen e kërkuar, në komunën e Malishevës 24 nxënës janë rikthyer në procesin shkollor, në komunën e Lipjanit, Vitisë, Podujevës, Novobërdës, Pejës dhe Klinës nuk ka nxënës të cilët kanë braktisur shkollimin apo janë rikthyer në shkolla, në komunën e Prizrenit numri i nxënësve të rikthyer në shkolla (pas braktisjes) gjithsej është 54 nxënës, në komunën e Kamenicës nuk ka nxënës që janë rikthyer në shkolla. Në komunën e Gjilanit dhe Ferizajt në shkolla janë rikthyer nga 5 nxënës. Sa i përket komunës së Istogut 9 nxënës janë rikthyer në shkolla, komuna e Kaçanikut, Ranillugut, Dragashit, Klllokotit, Junikut, Graçanicës, Mitrovicës, Drenasit, Obiliqit, Mamushës, Prishtinës dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje, kurse në komunën e Hanit të Elezit nuk ka nxënës të rikthyer pas braktisjes. Në komunën e Fushë Kosovës nxënës të cilëve ju ka dhënë mundësia të vazhdon mësimin jo formal pas braktisjes janë rikthyer 4 nxënës të klasës së 2 dhe 3, Deçan 51, në Shtërpçë 0, në Rahovec 11 nxënës të rikthyer në sholla pas braktisjes. Në komunën e Shtimes dhe Vushtrrisë nga 1 nxënës i rikthyer në shkollën fillore, në komunën e Skenderaj janë 45 nxënës.

#### **NDËRMARRJA E VEPRIMEVE NGA KOMUNA JUAJ PËR TË SIGURUAR QASJE NË ARSIM DHE PËR TË LUFTUAR BRAKTISJEN E SHKOLLIMIT**

#### **Numri i orëve të mësimin intensiv për të ndihmuar kthimin në shkollë (të ndara në baza etnike, gjinore, moshë, etj)**

Në komunën e Gjakovës mbahen nga 42 orë të mësimin intensiv, komuna e Gjilanit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se këto të dhëna gjinden në shkolla dhe nuk është numër shabllon po varësisht prej shkollave ku ka pasur nxënës të braktisur, komuna e Malishevës,



Prizrenit, Kamenicës, Kaçanikut, Ranillugut, Dragashit, Kllokotit Klinës, Rahovecit, Mitrovicës, Vitisë, Mamushës, Obiliqit, Prishtinës, Novobërdës dhe Graçanicës nuk kanë dhënë përgjigje, në komunën e Lipjanit, Vushtrrisë, Skenderajt, Ferizajt, Shtimes dhe Podujevës nuk ka orë të mësimit intensiv ngase nuk ka nxënës të cilët kanë braktisur shkollimin. Komuna e Istogut ka ofruar përgjigje duke thënë se në shkolla mbahen nga 10 orë në javë për të parandaluar braktisjen e shkollës nga nxënësit e komuniteteve, komuna e Hani të Elezit nuk pasur kthim për t'i ndihmuar. Komuna e Fushë Kosovës 186 orë 4 (javë) për komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në Deçan mbahen 34 orë të mësimit intensiv ku marrin pjesë 25 shqiptar dhe 1 rome, në komunën e Drenasit dhe Shtërpçës nuk ka nxënës të minoriteve tjera, në ZAMV sipas plan programit i cili zbatohet në arsimin e minoritetit rom, është punuar në gjuhën serbe ku është përfshirë edhe respektimi i nivelit obligativ i përshtatur mbi bazën etnike, ku bëhet fjalë për numrin e orëve që janë zgjedhur dhe kryhen sipas mundësive të planit mësimor. Gjithashtu, në ZAMV punohet kryesisht në mënyrë verbale ngase nuk ekzistojnë librat e shkruar në gjuhën rome. Sa i përket numrit të orëve të mësimit intensiv për të ndihmuar kthimin në shkollë në komunën e Pejës 68 orë mbahen në javë nga klasa II-V.

### **Numri i orëve të mësimit plotësues (ekstra-kurrikulare) për nxënësit**

Në komunën e Gjakovës janë mbajtur 46 orë të mësimit plotësues për nxënësit, komuna e Gjilanit, Malishevës, Prizrenit, Kamenicës, Kaçanikut, Ranillugut, Hani të Elezit, Dragashit, Kllokotit, Klinës, Graçanicës, Rahovecit, Prishtinë, Novobërdës, Vitisë dhe ZAMV-s nuk kanë dhënë përgjigje, në komunën e Lipjanit për çdo ditë mbahen nga 4 orë shtesë pas përfundimit të mësimit të rregullt të organizuar nga OJQ-VORAE (Voice of Roma). Në komunën e Ferizajt janë mbajtur 162 orë të mësimit plotësues, kurse në komunën e Istogut, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Podujevës nuk është mbajtur asnjë orë e mësimit plotësues. Komuna e Fushë Kosovës ka gjithsej 232 orë pune për komunitetin REA mësim, shkrim, lexim, Deçani 34 orë të mësimit plotësues, komuna e Drenasit, Shtërpçës dhe Junikut nuk kanë nxënës të minoriteve tjera. Në Mitrovicë aktivitetet ekstra kurrikulare janë duke u organizuar në bashkëpunim DKA me Save the Children (mësim plotësues). Në komunën e Obiliqit pritet që në javë të ketë dy herë nga 30 orë, në komunën e Pejës janë 6 shkolla me 6 mësimdhënës 120 orë në javë.

### **Numri i Ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM) të themeluara në komunë dhe shkolla, sipas UA 7/2011 të MASHT**

Në komunën Gjakovës, Ferizajt Malishevës, Istogut, Klinës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Hani të Elezit, Mitrovicës, Shtërpçës, Gjilanit, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Obiliqit dhe Klinës në të gjitha shkollat janë formuar ekipet sipas U.A. Nr.7/2011 të MASHT-it. Komuna e Lipjanit, Kamenicës, Kaçanikut, Ranillugut, Dragashit, Junikut, Rahovecit, Graçanicës, Novobërdës, ZAMV-s dhe Kllokotit nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë. Ndërkaq, në komunën e Drenasit, Vitisës dhe Deçanit ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollimit ende nuk janë formuar. Në komunën e Mamushës ka pasur disa aktivitete të vetëdisimit të nxënësve për mos braktisje, kurse në komunën e Prishtinës në kuadër të shkollës fillore "Emin Duraku" e ka ekipin për braktisje nga shkolla që punon në bashkëpunim me qendrën për qunë sociale, ku edhe ka pas sukses një kushtëzim që nëse fëmijët braktisin shkollën do të ju ndalet ndihma

sociale, po ashtu ky ekip në bashkëpunim me qendrën për pune sociale del në vizitë familjeve të nxënësve të komunitetit RAE të cilët braktisin shkollën dhe arrijnë që t'i bindin të kthehen.

### **Numri i vizitave nga Qendra për Punë Sociale familjeve të komunitetit pakicë për të vlerësuar mirëqenien e fëmijëve**

Komuna e Gjilanit nuk posedon shënime lidhur me këtë fushë, në komunën e Malishevës janë realizuar mbi 12 vizita nga qendra për punë sociale familjeve të komunitetit pakicë, komuna e Prizrenit është përgjigjur se nuk kemi informata nga qendra për punë sociale, në komunën e Ferizajt janë bërë gjithsejtë 8 vizita, ndërkaq në komunën e Istogut bëhen vizita bazuar në informacione për nevojat që shfaqen. Komuna e Klinës QPS i viziton përfituesit e ndihmave nga 2 herë në vit, ku RAE-t janë përfituesit më të shumët të ndihmave nga komunitetet pakicë, në komunën e Pejës, Deçanit, Obiliqit dhe Shtimes janë realizuar nga 2 vizita, derisa bëhen edhe vizita të tjera sipas kërkesave dhe nevojave të tyre. Në komunën e Vushtrrisë dhe Skenderajt nuk ka pasur vizita, në komunën e Podujevës janë realizuar 6 vizita dhe u janë shpërndarë dhurata, pako ushqimore dhe dru zjarri. Komunitat tjera nuk kanë dhënë përgjigje.

### **3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR OBLIGIMET QË DALIN NGA MSA-ja**

*Decentralizimi i fondit për ri-integrim, thjeshtësimi i procedurave të aplikimit për këtë fond dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis nivelit qendror dhe lokal*

#### **PËRFUNDIMI I DECENTRALIZIMIT TË FONDIT PËR RI-INTEGRIM**

Sa i përket pyetjes së parashtruar, komuna e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Ranillugut, Hanit të Elezit, Kllkotit, Mitrovicë, ZAMV, Klinës, Fushë Kosovës, Rahovecit, Drenasit, Deçanit, Shtërpçës, Junikut, Vitisë, Shtimes, Mamushës, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës, Novobërdës dhe Graçanicës janë përgjigjur se ende nuk menaxhojnë me këtë fond, ndërkaq krahasuar me komunitat e tjera, komuna e Dragashit është përgjigjur se pjesërisht menaxhon me këtë fond.

#### **ZBATIMI I PROCEDURAVE PËR APLIKIM PËR KËTË FOND**

##### **Numri i vendimeve të zbatuara në praktikë lidhur me bizneset dhe ndërtimin/rindërtimin e shtëpive**

Në komunën e Gjakovës janë zbatuar 13 vendime për plane të biznesit, 1 shtëpi dhe 1 renovim të shtëpisë, në komunën e Gjilanit janë miratuar 4 vendime për biznese, 2 për ndërtime dhe 0 për rindërtim, në komunën e Malishevës nga gjithsej 5 kërkesa të parashtruara për plan biznesi,

vetëm 1 kërkesë është aprovuar, ndërkaq kërkesat e tjerat janë në shqyrtim. Kurse, për rindërtim të shtëpive nga 15 kërkesa të parashtruara, vetëm 2 janë zbatuar në praktikë. Në komunën e Lipjanit për biznes janë aprovuar nga MPB-ja 3 kërkesa, kurse 2 kërkesa janë refuzuar. Po ashtu, MPB-ja ka aprovuar 10 vendime për ndërtim të shtëpive, ndërkaq 4 kërkesa janë refuzuar. Në komunën e Prizrenit deri më tani janë marrë mjetet nga fondi për riintegrim për 27 plane të biznesit, kurse gjithsejtë janë parashtruar 34 kërkesa për plan biznesi dhe 7 plane biznesi presin për mjetet, kurse 4 vendime për ndërtim janë në pritje të ndërtimit të tyre. Komuna e Kamenicës është përgjigjur se është paraparë ndërtimi i dy shtëpive, mirëpo vendimet nuk janë zbatuar në teren, kurse janë aprovuar 3 plan biznese. Në komunën e Ferizajt vendimet e zbatuara në praktik për bizneset janë 6, ndërsa për ndërtim dhe rindërtim gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur. Komuna e Kaçanikut është përgjigjur se gjatë vitit 2013 janë pranuar 3 kërkesa për plan biznesi për të cilat janë nxjerrë 3 vendime, 1 kërkesë për ndërtim shtëpisë për të cilën po ashtu është nxjerrë 1 vendim për ndërtim të shtëpisë. Komuna e Istogut është kompetencë e MPB-së për të marrë vendim përfundimtar, Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR) jep vetëm pëlqimin, në komunën e Hanit të Elezit procedurat janë zbatuar varësisht prej kërkesave të parashtruara. Në komunën e Dragashit numri i vendimeve të zbatuara në praktikë lidhur me bizneset dhe ndërtimin / rindërtimin e shtëpive është si vijon: 5 vendime për biznese, 1 shtëpi dhe 2 riparime, ndërsa komuna e Klllokotit nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me bizneset dhe ndërtimin / rindërtimin e shtëpive. Komuna e Klinës ka të zbatuar në praktikë vendimet për: 3 shtëpi, 5 biznese (2000 euro) dhe 5 riparime të shtëpive. Komuna e Fushë Kosovës, Rahovecit, ZAMV-s dhe Shtërpçës nuk kanë dhënë përgjigje. Në Deçan nga planet e biznesit janë zbatuar 16 vendime, ndërsa për ndërtim janë aprovuar 3 shtëpi, njëra është përfunduar, kurse 2 janë në proces për tu ndërtuar dhe janë riparuar 3 shtëpi, në Drenas 14 vendime janë zbatuar për plan bizneset, në komunën e Junikut janë zbatuar në praktikë tre Plane Biznese në këtë periudhë raportuese. Komuna e Mitrovicës prej të gjitha vendimeve të pranuar lidhur me bizneset, përkatësisht për gjenerim të të hyrave vetëm 13 vendime për biznese janë zbatuar në praktikë, disa të tjera janë në pritje për realizim. Gjithashtu, edhe për ndërtim, vetëm një shtëpi është ndërtuar por ende nuk ka përfunduar prandaj edhe nuk është funksionale, 3 shtëpi janë meremetuar, ndërkaq vendimet për sigurimin e pakove ushqimore dhe higjienike pothuajse zbatohen në tërësi. Në Komunën e Graçanicës nuk ka vendim të miratuar për ndërtim dhe as për biznese. Tek numri i vendimeve të zbatuara lidhur me bizneset dhe ndërtimin/rindërtimin e shtëpive në komunën e Vitisë është marr 1 vendim për ndërtim të shtëpisë dhe është në proces, në komunën e Shtimes janë 3 biznese dhe 3 rindërtime të shtëpive (2 komunitetit shqiptar dhe 1 komuniteti ashkalinj), në komunën e Mamushës procedurat për aplikim për këtë fond aplikohet në mënyrë të mirë; në komunën e Vushtrrisë 4 përfitues të biznes planeve, në komunën e Skenderaj 60 vendime për biznese vetëm janë të sprovuara ndërsa edhe 20 janë në procedurë; në komunën e Podujevës janë aprovuara 10 plane biznese dhe 2 të janë refuzuara 1 e aprovuar për ndërtim 2 të refuzuara; në komunën e Obiliqit janë marrë 2 vendime për shtëpi dhe 11 vendime biznes plane; në komunën e Pejës janë në realizim e sipër 4 vendime për biznes plane; në komunën e Prishtinës vendimet e zbatuara në praktikë lidhur me bizneset janë gjithsej 1 ndërsa për ndërtim/rindërtim të shtëpive janë në procedim e sipër në MPB, në komunën e Novobërdës 0.

## **Niveli i zbatimit të procedurave për aplikim për fondin e ri-integrimit (p.sh. cila pjesë zbatohet në tërësi, cila pjesë nuk zbatohet fare, etj)**

Në Komunën e Gjakovës, Drenasit, Junikut, Klinës, Fushë Kosovës, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Kaçanikut, Rahovecit, Shtërpcës, Gracanicës dhe ZAMV-s në tërësi zbatohen kërkesat për banim me qera, pako ushqimore dhe higjienike, ndërsa më pak të zbatueshme janë kërkesat për plane të bizneseve, dru zjarri si dhe kërkesat për medikamente dhe trajtim mjekësorë. Ndërkaq, nuk zbatohen fare kërkesat rreth orendive shtëpiake. Sa i përket komunës së Gjilanit kërkesat që zbatohen në përgjithësi janë ato për higjienën dhe ushqimin, kurse kërkesat e tjera zbatohen pjesërisht. Në komunën e Kamenicës vendimet e nivelit lokal zbatohen më shpejt, ndërsa ato të nivelit qendror vonohen. Komuna e Ferizajt është përgjegjës se nuk ka pasur vonesa të mëdha për të gjitha rastet të aplikuara për fondin për ri-integrim, kurse komuna e Istogut është përgjegjës se duke u bazuar në Rregulloren nr.20/2013, për Menaxhimin e Programit, Organet Kompetente, Procedurat dhe Kriteret e Përfitimit për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar, KKR zbaton në tërësi këto procedurat që janë kompetencë e saj. Komuna e Ranillugut është përgjegjës se fondi shkon në MPB, ndërkaq komuna e Mitrovicës, Hanit të Elezit, Mamushës, Dragashit, Novobërdës nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje, kurse tek komuna e Klllokotit deri më tani janë aprovuar 6 kërkesa. Në Deçan askush nuk ka problem sa i përket procedurave për aplikim, vetëm se zbatimi i kërkesave merr kohë shume të gjatë p.sh. banimi me qera, ushqimi dhe higjiena janë kërkesa që zbatohen më shpejt, ndërsa planet e bizneseve zgjasin shume më shumë. Tek niveli i zbatimit të procedurave për aplikim për fondin e ri-integrimit komuna e Vitisë është përgjegjës se formati dhe procedurat janë në rregulloren për menaxhimin e fondit - respektohen kriteret, komuna e Shtimes ka raportuar se tani zbatohen të gjitha. Në komunën e Vushtrrisë në tërësi zbatohen procedurat lidhur me pakon ushqimore higjienike dhe akomodimit të cilat janë kompetencë të KKR kurse biznes planet, rindërtimi, ndërtimi dhe renovimi janë pjesë e nivelit qendror, komuna e Skenderaj vendimet për pakot ushqimore dhe higjienike zbatohen mirë, ndërsa problem kanë vendimet për ndërtim dhe meremetim. Komuna e Podujevës është përgjegjës se ka nivel të shkëlqyer, në komunën e Obiliqit zbatohen në tërësi procedurat për aplikim për fond, në komunën e Pejës zbatohen vendimet e marra në nivelin lokal dhe qendror me vonesë për shkak të mos ekzistimit buxhetit në nivel lokal; në komunën e Prishtinës niveli i zbatimit të procedurave për aplikim për fondin e ri-integrimit zbatohet në tërësi pjesa që ka të bëjë me procedurat që parashihen lidhur me hartimin dhe procedimin e kërkesave në KKR, marrjen e vendimit nga KKR dhe procedimin e tyre për zbatim në MPB. Ndërsa, pjesërisht zbatohet pjesa që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve, me ç'rast të ri-integruarve u vonohet marrja e asistencës ushqimore/higjienike, që është nën kompetencën e MPB-së (neni 19, pika 3, e Rregullores 10/2012).

## **Numri i kërkesave të dorëzuara në komunë për fond të ri-integrimit (të ndara në bazë të natyrës së kërkesave: ushqim, strehim, ndihmë mjekësore, gjenerim të të hyrave, etj)**

Në komunën e Gjakovës, ZKKK ka pranuar 66 kërkesa për pako ushqimore dhe higjienike, 29 për dru zjarri, 25 për banim me qera, 2 kërkesa për ndërtim të shtëpive, 22 plane të biznesit si dhe 1 kërkesë për orendi, në komunën e Gjilanit gjithsejtë janë dorëzuar 134 kërkesa, prej tyre 25 kërkesa për plan të biznesit, 6 për rindërtim, 54 për pako ushqimore dhe higjienike, 7 kërkesa për ndërtim të shtëpive, 2 asistime komplete, 9 orendi, barna 5, trajtim mjekësor 4, dru zjarri 13,

si dhe për banim 9 kërkesa. Në komunën e Malishevës gjithsejtë janë dorëzuar 52 kërkesa, në komunën e Lipjanit janë dorëzuar 34 kërkesa në komunë për fond të ri-integrimit, në komunën e Prizrenit numri i kërkesave të dorëzuara është si vijon: 33 kërkesa të aprovuara për ushqim dhe pako higjienike, 24 kërkesa të aprovuara për akomodim, 4 kërkesa të aprovuara për ndihmë në barna. Në komunën e Kamenicës janë dorëzuar 15 kërkesa, në komunën e Ferizajt për fondin për ri-integrimin janë dorëzuar gjithsejtë 93 kërkesa, për akomodim 24, kërkesa për pako ushqimore dhe higjienike 25 kërkesa, për drapër dhe ngrohje 2 kërkesa, kërkesa për barna 2, rekomandim për renovim të shtëpive 5, rekomandime për projekte gjithsej 37. Kurse në komunën e Kaçanikut gjatë vitit 2013 janë pranuar 3 kërkesa për pako ushqimore, të cilat janë miratuar. Në komunën e Istogut janë parashtruar 158 kërkesa gjatë vitit 2013, ndërsa në komunën Ranillugut janë dorëzuar 9 kërkesa. Komuna e Hanit të Elezit ka pranuar 2 kërkesa për ushqim të cilat janë aprovuar dhe 1 për biznes, kurse në komunën e Dragashit numri i kërkesave të dorëzuara në komunë për fond të ri-integrimit (të ndara në bazë të natyrës së kërkesave: ushqim, strehim, ndihmë mjekësore, gjenerim të të hyrave, etj) është 17 kërkesa, si dhe në komunën e Kllokotit janë pranuar 6 kërkesa. Në komunën e Klinës kërkesat e dorëzuara për ushqim janë gjithsej 212, për strehim 8 kërkesa, 13 gjenerim të hyrave, 29 për lëndë djegëse (200euro). Numri i kërkesave të dorëzuara në Komunën e Fushë Kosovës janë gjithsej 57, në Deçan ZKKK ka pranuar 6 kërkesa për banim me qera, në Drenas 80 kërkesa të ndara-16 ushqimore,-2 barna,-6 orendi-2 asistencë dru,-25 plan bizmisi-7 për ndërtim-14 renovim, ndërsa në komunën e Junikut janë marrë 18 vendime nga KKR për furnizim me gjëra ushqimore dhe higjienike, 1 Akomodim dhe 1 Vendim për Dru Zjarri , në Rahovec 59. Në komunën e Mitrovicës janë bërë gjithsej 159 kërkesa të cilat kryesisht kanë qenë kërkesa të përgjithshme. Në Graçanicë nuk ka veprime të veçanta të ndërmarra në lidhje me banimin dhe shëndetësinë, përveç përpjekjeve të ZKKK që t'iu ndihmojnë familjeve (këshillim). Në komunën e Shtërpcës për vendime, plane të biznesit, ndërtim, artikuj ushqimorë, për vazhdimin e artikujve ushqimor higjienik dhe për strehim janë aprovuar gjithsejtë 15 kërkesa në praktikë, për artikuj ushqimor- higjienik 5, janë 3 kërkesa për strehim, 3 kërkesa të dorëzuara për plan biznesi, po ashtu edhe 1 kërkesë për shtëpi të ndërtuara për personat e Riatdhesuar, në ZAMV numri i kërkesave të miratuara është 7, të gjitha familjeve të kthyer u është mundësuar akomodimi dhe pakot ushqimore e higjienike. Po ashtu, vlen të theksohet se në Zyrën për riintegrim (ZAMV) është dorëzuar edhe 1 kërkesë e familjes së kthyer nga Gjermania, për të cilën është marrë vendimi për refuzimin e saj për shkak të mosplotësimit të kriterëve. Në komunën e Rahovecit janë gjithsej 59 kërkesa të dorëzuara për pako ushqimore dhe higjienike, ndërkaq komuna e Drenasit nuk ka ofruar të dhëna. Në komunën e Vitisë janë shqyrtuar 20 kërkesa ku 10 kërkesa nuk i kanë plotësuar kushtet, anë dorëzuar 6 kërkesa në qendër – 1 është aprovuar, 1 refuzuar si dhe 4 kërkesa janë në shqyrtim; në komunën e Shtëpcës 1 kërkesë për gjenerim të të hyrave, komuna e Mamushës nuk ka dhënë përgjigje, në komunën e Vushtrisë gjatë periudhës së raportimit janë paraqitur 23 kërkesa për ushqim, 5 akomodim dhe 4 gjenerim të hyrave; në komunën e Skenderaj gjithsejtë 5 vendime për ndërtim të shtëpive të personave të riatdhesuar, 9 familje, 1 prej tyre është e përfunduar, ndërsa tjerat nuk kanë filluar ende; në komunën e Podujevës 76 kërkesa, 35 pako ushqimore, 12 plan biznese, 6 strehim, 1 asistencë me barna, 1 trajtim mjekësorë, 21 Pako dru zjarri, në komunën e Obiliqit kërkesë për ushqim 63, kërkesë strehim 28, kërkesë për mjekim 14, në komunën e Pejës janë paraqitur këto kërkesa: 46 për pako ushqimore/higjienike,26 për akomodim, 10 për medikamente, 10 për dru për ngrohje,

1 për orendi shtëpiake, 11 për biznes plan. Në komunën e Prishtinës numri i kërkesave në komunë për fond të ri-integrimit është si vijon, të ndara sipas natyrës së kërkesave: Ri-integrim: 17 kërkesa; Strehim dhe Asistencë ushqimore/higjienike: 36 kërkesa; Trajtim mjekësor/barna: 7 kërkesa; dru zjarri: 19 kërkesa; pako e harmonizuar e asistencës në orendi: 1 kërkesë; komuna e Novobërdës ka dërguar 13 kërkesa, nga këto 6 kërkesa për biznes plan për të cilat është bërë verifikimi në teren, 3 kërkesa për shtëpi që është bërë verifikimi në teren, 7 kërkesa për ushqim dhe higjienë.

**Numri i kërkesave të aprovuara (të ndara në bazë të natyrës së kërkesave: pako të asistencës si ushqim, materiale higjienike, etj; strehim; ndihmë mjekësore; etj)**

Në komunën e Gjakovës janë aprovuar 56 kërkesa për pako ushqimore dhe higjienike, 23 kërkesa për banim me qera, 23 kërkesa për dru zjarri, 9 kërkesa për plane të biznesit, 1 kërkesë për riparim të shtëpisë, 1 kërkesë për ndërtim të shtëpisë, në komunën e Gjilanit për pako ushqimore dhe higjienike janë aprovuar 231 kërkesa, për strehim 10 kërkesa, ndërtim 2, trajtim mjekësor 2 dhe dru zjarri 37. Në komunën e Malishevës për gjëra ushqimore janë miratuar 7 kërkesa, për orendi shtëpiake 15 kërkesa, material ndërtimor-renovim 15 kërkesa, banim të përkohshëm 1 kërkesë, ndihmë mjekësore 1 kërkesë dhe 5 kërkesa për biznes. Ndërsa, 8 kërkesa janë të personave të cilët janë jashtë kriterëve. Në komunën e Lipjanit janë aprovuar 24 kërkesa, në komunën e Prizrenit nga viti 2011 deri në vitin 2013 janë aprovuar 34 kërkesa për gjenerim të hyrave. Në komunën e Kamenicës janë aprovuar për ushqim të gjitha kërkesat, 1 kërkesë për ndërtim, në disa raste janë përsërit kërkesat, kurse disa kërkesa janë refuzuar për shkak se data e shkuarjes së personave ka qenë jashtë kriterit. Kurse në komunën e Ferizajt 53 kërkesa kërkesa janë aprovuar, 24 kërkesa për akomodim, 37 kërkesa për projekte, 25 kërkesa për pako ushqimore dhe higjienike, 2 kërkesa për ndihmë mjekësore, 2 kërkesa për ndërtim të shtëpive. Në komunën e Kaçanikut nuk ka pasur kërkesa për ndihmë mjekësore, ndërkaq në komunën e Istogut për pako ushqimore dhe higjienike janë miratuar 23 kërkesa, për banim me qera 16 kërkesa, barëra 8, orendi shtëpiake 14, plane biznesi 13, ndërtim shtëpish 3, rindërtim shtëpish 2, dru zjarri 31, veshmbathje 4, shporet me dru 8, të holla kesh gjerë në vlerën 100 € për 1 person, në komunën e Ranillugut janë aprovuar 9 kërkesa. Komuna e Hanit të Elezit ka pranuar 2 kërkesa të cilat janë aprovuar për pako të asistencës për ushqim dhe materiale higjienike, në komunën e Dragashit numri i kërkesave të aprovuara (të ndara në bazë të natyrës së kërkesave: pako të asistencës si ushqim, materiale higjienike, etj; strehim; ndihmë mjekësore; etj) është 14 kërkesa, kurse në komunën e Klllokotit numri i kërkesave të aprovuara është gjithsej 6. Në komunën e Klinës kërkesat e aprovuara për ushqim janë gjithsej 212 persona, strehim 8 kërkesa, 13 gjenerim të hyrave, 29 pra për lëndë djegëse (200€), në komunën e Fushë Kosovës numri i kërkesave të aprovuara për strehim të përkohshëm është 10, për ushqim 43, për orendi 5, për dru 4, në komunën e Deçanit janë aprovuar 153 kërkesa për familje për ushqim dhe higjienë, si dhe 4 për banim me qera, në Drenas 14 kërkesa, në komunën e Shtërpçës 12 kërkesa të aprovuara, në komunën e Junikut ka pasur gjithsej 33 kërkesa, 1 kërkesë për ndërtim të shtëpisë dhe 4 kërkesa për renovim të shtëpisë, 18 kërkesa për pako ushqimore, 1 akomodim, 1 kërkesë për dru zjarri dhe 6 kërkesa për plan biznesi. Po ashtu, janë nxjerrë 18 vendime nga KKR për furnizim me gjëra ushqimore dhe higjienike. Në Rahovec 38 kërkesa janë aprovuar për barna, kërkesat e aprovuara për akomodim janë gjithsej 9, kërkesa për dru zjarri gjithsej të aprovuar 16, kërkesat e aprovuara për ndërtim të shtëpive gjithsejtë 4 (2 shqiptar dhe 2 serb),

kërkesa për plan biznesi gjithsej 8 të aprovuar. Në komunën e Mitrovicës janë aprovuar këto kërkesa: 79 për ushqim dhe higjienë, 33 për strehim, 9 për dru zjarri dhe 3 për barëra. Komuna e Graçanicës nuk ka ofruar të dhëna, në ZAMV të gjitha kërkesave/familjeve u është mundësuar akomodimi dhe pakot ushqimore dhe higjienike. Pesë familje kanë paraqitur kërkesë për hapjen e bizneseve të vogla, të cilat duhet t'i miraton Komisioni Qendror (MPB). Vetëm 1 kërkesë është miratuar nga ana e MPB-së (Komisionit Qendror). Tek numri i kërkesave të aprovuara në komunën e Vitisë janë aprovuar 4 kërkesa – për pakon ushqimore-higjienike dhe dru; në komunën e Shtimës 7 kërkesa për ushqim, 2 për strehim, 1 ndihmë mjekësore, 7 për gjenerim të të hyrave; komuna e Mamushës, Podujeva nuk ka dhënë përgjigje; në komunën e Vushtrrisë 19 kërkesa janë aprovuar për pakon ushqimore dhe higjienike, 5 kërkesa të aprovuara për strehim dhe ndihmë mjekësore 1 kërkesë; në komunën e Skenderaj gjatë vitit 2013 në komunë janë dorëzuar 13 kërkesa të reja për ushqim, 47 kërkesa për vazhdim, 6 për strehim, 1 kërkesë për ndihmë mjekësore, 13 kërkesa për gjenerim të të ardhurave, të aprovuara, pako ushqimore (te reja)10 strehim, 5ndihmë mjekësore 0.40 vazhdim ushqimi dhe higjienë, në komunën e Obiliqit kërkesë për ushqim 63, kërkesë strehim 28, kërkesë për mjekim 14, në komunën e Pejës kërkesat aprovuar gjatë vitit 2013 janë: 35 pako ushqimore dhe higjienike, 18 për akomodim, 6 për medikamente, 4 për dru për ngrohje, 3 për biznes plan, KKR ka aprovuar 1 kërkesë; në komunën e Prishtinës numri i kërkesave të aprovuara nga KKR është si vijon: Ri-integrim: 14 kërkesa të aprovuara; Asistencë ushqimore/higjienike dhe strehim: 31 kërkesa të aprovuara; Trajtim mjekësor/barna: 7 kërkesa të aprovuara; Dru zjarri: 18 kërkesa të aprovuara, pako e harmonizuar e asistencës në orendi: 1 kërkesë e aprovuar; në komunën e Novobërdës 13 kërkesa 7 kërkesa për ushqim dhe higjienë, 2 kërkesa për dokumentacion, 6 kërkesa për biznes plan, 3 kërkesa për ndërtim të shtëpisë, 6 kërkesa për biznes plan.

### **Numri i të kthyerve që janë ndihmuar në arsim, gjuhë dhe trajnime profesionale**

Komuna e Gjakovës është përgjegjgur se çdo fëmijë i kthyer është i kyçur në arsim, ndërsa ZKKK-të nuk kanë patur ndonjë kërkesë nga asnjë person lidhur me arsimimin apo për mësimin e gjuhës. Kurse, sa i përket trajnimeve profesionale, ZKKK me ndihmën e Zyrës Zvicerane ka mbajtur 2 cikle të trajnimeve profesionale lidhur me hyrjen dhe planifikimin e biznesit. Ndërsa numri i të trajnuarve është 35 persona të riatdhesuar. Tek komuna e Gjilanit vetëm 1 i kthyer është ndihmuar për trajnim profesional, në komunën e Malishevës nuk kemi raste të të kthyerve, në komunën e Lipjanit vetëm 1 fëmijë është regjistruar në para shkollim, gjithashtu komuna ka informuar familjet e riatdhesuara që të shkojnë në kurse profesionale në Prishtinë. Në komunën e Prizrenit për vitin 2013 janë mbajtur 5 trajnime profesionale, në komunën e Kamenicës në shkolla janë të përfshirë të gjitha rastet të cilët kanë nevojë, si dhe të gjithë janë regjistruar në librat amë pa ndonjë problem trajtimi në shërbimin shëndetësor social bëhet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Në komunën e Ferizajt duhet të kyçen 4 fëmijë në sistemin e arsimit(rastet janë në proces),për gjuhë dhe trajnime profesionale, kurse në komunën e Kaçanikut janë ndihmuar 2 të kthyer me trajnime profesionale, në komunën e Fushë Kosovës 18 nxënës kanë vijuar kursin e gjuhës shqipe. Në komunën e Istogut dhe Hanit të Elezit nuk ka patur të kthyer, komuna e Ranillugut, Dragashit, Klllokotit, Klinës, Rahovecit, Shtërpcës, Deçanit, Drenasit, Mitrovicës, Graçanicës, Vitisë, Skenderajt, Mamushës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje. Tek numri i të kthyerve që janë ndihmuar në arsim, gjuhë dhe trajnime në

komunën e Shtimës për regjistrim në shkollë janë ndihmuar 2 nxënës (komuniteti shqiptar), në komunën e Vushtrrisë 4 kërkesa janë aprovuar për të ndihmuar në praktikë profesionale, në bashkëpunim me UNDP, në komunën e Podujevës nuk ka të ndihmuar, në komunën e Obiliqit 40 nxënës të nacionalitetit të ndryshme, ku 2 janë shqiptarë, 17 romë, 21 ashkali – egjiptian, në komunën e Pejës, KKR ka aprovuar 1 kërkesë, në komunën e Prishtinës në arsim dhe gjuhë janë të udhëzuar dy persona të riatdhesuar, të cilët kanë kërkuar vazhdimin e kursit të gjuhës shqipe dhe integrimin e tyre në sistemin arsimor. Në trajnime profesionale janë ndihmuar 5 raste, lidhur me trajnimet e ndryshme profesionale që organizohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; në komunën e Novobërdës nuk është asnjë i ndihmuar.

### **Numri i të kthyerve që janë ndihmuar në punësim**

Në komunën e Gjakovës përmes programit të UNDP-së dhe Qendrës Regjionale të punësimit janë punësuar si të përkohshëm 15 persona, në komunën e Gjilanit janë punësuar 2 të kthyer, në komunën e Malishevës janë evidentuar 5 raste të cilët janë paraqitur në qendrën për punësim, në komunën e Lipjanit janë punësuar 3 të kthyer, në komunën e Prizrenit 1 person i riatdhesuar është punësuar me rekomandimin e zyrës së punësimit në bibliotekën e qytetit, në komunën e Kamenicës ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se janë ndihmuar në punësim në sektorin privat dhe në punë sezonale në projekte të komunës me donator. Ndërkaq, në komunën e Ferizajt në punësim janë ndihmuar 7 persona të riatdhesuar, në komunën e Kaçanikut janë ndihmuar për punësim 2 persona të kthyer, në komunën e Istogut 2 persona të ri atëdhesuar janë ndihmuar në punësim nga Qendra Komunale për Punësim, komuna e Ranillugut, Dragashit, Klinës, Rahovecit, ZAMV-s, Shtërpcës, Vitisë, Mamushës, Novobërdës dhe Junikut nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Hanit të Elezit nuk ka pasur ndonjë kërkesë për punësim por vetëm kërkesa për pako të asistencës si ushqim, materiale higjienike dhe biznes, ndërkaq në komunën e Killokotit të kthyerit janë punësuar në punë sezonale. Në komunën e Fushë Kosovës përmes UNDP-së janë punësuar 5 persona, ndërsa në komunën e Deçanit janë punësuar 5 persona nga programi i UNDP dhe Qendrës së punësimit, në Drenas 3 të punësuar, 2 të punësuar nga programi i UNDP, në Mitrovicë janë punësuar 18 persona, komuna e Gracanicës nuk ka ofruar ndihmë në punësim. Tek numri i të kthyerve që janë ndihmuar në punësim në komunën e Skenderaj 6 persona janë ndihmuar me trajnim 9 punë praktike, në komunën e Podujevës janë ndihmuar me punësim sezonal përmes IOM-it dhe zyrës për punësim 5 persona, në komunën e Obiliqit janë ndihmuar 14 persona nga 6 muaj (2013). Në komunën e Pejës, ZKKK nuk ka shënime të tilla-informata kthyes nga enti për punësim, në komunën e Prishtinës në kuadër të projektit për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, në punësim pritet të ndihmohen disa raste, pasi veçse është mbajtur një takim koordinues midis UNDP-së, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ZKKK-ve për koordinimin e përbashkët të adresimit të rasteve për punësim. Ky takim koordinues është mbajtur më dt. 15.05.2013; në komunën e Shtimes nuk ka pasur kërkesa, në komunën e Vushtrrisë janë ndihmuar 4 persona.



## **PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT NË MES TË NIVELIT LOKAL DHE QENDROR NË FUSHËN E FONDIT PËR RI-INTEGRIM**

### **Veprimet e ndërmarra për të siguruar që të kthyerit të kenë qasje në banim të përkohshëm dhe në shërbimet e tjera publike, përfshirë kujdesin parësor shëndetësor**

Në komunën e Gjakovës të gjithë personat e kthyer të cilët nuk kanë pronë, brenda kritereve janë ndihmuar në strehimin e përkohshëm nga programi për riintegrim, në komunën e Gjiçanit janë ndërmarrë veprime me qëllim të asistimit të të riadhesuarve edhe pse kjo është kompetencë e Komisionit pranë ZKKK-së, Komisionit komunal për Ri-integrim dhe Zyrës Regjionale, në komunën e Malishevës veprimet e ndërmarra janë kontakti me koordinatoren regional, komuna e Lipjanit ka ndërmarrë veprime për akomodimin e 20 familjeve nga viti 2013, kurse për mjekim janë ndihmuar 2 raste. Duhet theksuar se të gjithë të riadhesuarit kanë qasje në shërbimet shëndetësore në ambulancat dhe janë të liruar nga participimi i shërbimit. Komuna e Prizrenit është përgjigjur se për të gjithë të kthyerit të cilët kanë pasur nevojë për akomodim të përkohshëm janë akomoduar. Në komunën e Kamenicës janë marrë veprime të shpejta duke bërë strehimin e 4 familjeve ndërkaq në një rast ka skaduar afati i banimit me qira, kurse në një rast tjetër vullnetarisht e ka liruar banesën. Sa i përket komunës së Ferizajt janë ndërmarrë të gjitha veprimet për riadhesim, komuna e Kaçanikut nuk ka ofruar të dhëna lidhur me këtë fushë, ndërkaq në komunën e Istogut të gjithë të kthyerit që plotësojnë kriteret ligjore, realizojnë të drejtën e tyre në të gjitha shërbimet publike. Në komunën e Ranillugut nuk është ndërmarrë ndonjë aksion, në komunën e Hanit të Elezit kërkesa të tilla nuk ka pasur, përderisa në komunën e Dragashit kemi vetëm 1 veprim të ndërmarrë për të siguruar që të kthyerit të kenë qasje në banim të përkohshëm dhe në shërbimet e tjera publike, përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor. Komuna e Kllokotit ka ofruar ndihmën për personat e ri-integruar, në komunën e Klinës 3 persona janë trajnuar nga UNDP dhe Zyra për punësim janë 8 raste të strehuara me qera - Ministria, komuna e Fushë Kosovës, Decanit, Shtërpçës, Gracanicës, Mamushës, Skenderajt dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, në Deçan dhe Drenas nuk ka asnjë veprim, në komunën e Junikut është akomoduar 1 familje e riadhesuar dhe po ashtu u është ofruar shërbim parësor shëndetësor pa pagesë të gjithë personave të riadhesuar që janë në nevojë, në komunën e Mitrovicës nuk ka ndonjë kërkesë për ndihmë të kësaj natyre. Në fushën e veprimeve të ndërmarra për të siguruar që të kthyerit të kenë qasje të barabartë në komunën e Vitisë zyra për kthim dhe riadhesim bënë vizita në terren dhe verifikon gjendjen dhe kushtet e të kthyerve; në komunën e Shtimes të gjithë kanë qasje në shërbime publike dhe kujdesin shëndetësor kurse strehimi bëhet duke u paguar qiranë, në komunën e Vushtrrisë të riadhesuarit në QKMF vizitat mjekësore i kanë pa pagesë; në komunën e Podujevës janë ndihmuar 6 persona/familje, komuna e Obiliqit është përgjigjur se janë ndërmarrë 2 veprime, në komunën e Pejës sipas kërkesave në baze të rregullores në fuqi dhe në baze verifikimit në teren janë aprovuar kërkesat për akomodim si dhe nevojat e tjera, në komunën e Prishtinës udhëzimi i të ri-integruarve lidhur me të drejtat që kanë bazuar në rregulloren përkatëse, procedimin e kërkesave në kohë sa më të shpejtë në organet e MPB-së për qasje në banim të përkohshëm, kompletimin e dokumentacionit personal në Shërbimin e Ofiqarisë, shqyrtimin dhe adresimin e kërkesave që ndërlidhen me kujdesin parësor shëndetësor, në komunën e Novobërdës në qendrën e shërbimit të ofiqarisë është mundësuar

për 2 familje të marrin dokumentacionin. Në qendrën për punë sociale dhe shërbime të ndihmës sociale janë miratuar 3 kërkesa.

### **Hartimi i raportit mbi ri-integrimin e komunitetit RAE**

Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Ferizajt, Klinës, Istogut, Fushë Kosovës, Deçani, Graçanicës, Podujevës, Prishtinës, ZAMV-s dhe Mitrovicës hartojnë raporte të rregullta lidhur me integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, komuna e Kamenicës s'ka informacion lidhur me raportin e ri-integrimit të komunitetit RAE, kurse komuna e Kaçanikut, Ranillugut, Hanit të Elezit, Dragashit, Drenasit, Junikut, Pejës dhe Klllokotit janë përgjigjur se nuk kanë hartuar ndonjë raport mbi ri-integrimin e komunitetit RAE ngase nuk kanë komunitete pakicë. Tek hartimi i raportit mbi ri-integrimin e komunitetit RAE komuna e Shtimes harton raporte mujore, komuna e Vitisë, Mamushës, Obiliqit, Novobërdës, Shtërpçës, Rahovecit dhe Skenderajt nuk kanë ofruar të dhëna, në komunën e Vushtrrisë nuk ka raport gjenerale përveç raporteve 6 mujore dhe vjetore që përgatiten nga zyrtari për komunitet.

### **Themelimi i Komisionit Komunal për Ri-integrim**

Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Hani i Elezit, Mitrovicë, Dragashit, Klinës, Deçanit, Drenasit, Junikut, Fushë Kosovës, Shtërpçës, Graçanicës, Vitisë, Shtimes, Vushtrrisë, Podujevës, Obiliqit, Prishtinës dhe Novobërdës e kanë të themeluar Komisionin Komunal për Ri-integrim, kurse në komunën e Pejës KKR-ja ende nuk është themeluar. Komuna e Ranillugut, Klllokotit, Mamushës, Skenderajt, Rahovecit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje.

### **Numri i takimeve të mbajtura në komunë nga Komisioni Komunal për Ri-integrim gjatë periudhës raportuese**

Në komunën e Gjakovës, Komisioni Komunal për Ri-integrim gjatë vitit 2013 ka mbajtur gjithsejtë 5 takime, KKR-ja në komunën e Gjilanit ka mbajtur 9 takime, komuna e Malishevës ka mbajtur 3 takime, komuna e Lipjanit ka mbajtur 8 takime, komuna e Prizrenit ka mbajtur 12 takime, në komunën e Kamenicës dhe Kaçanikut janë mbajtur nga 6 takime, kurse komuna e Ferizajt ka mbajtur 22 takime. Komuna e Istogut ka mbajtur 15 mbledhje gjatë vitit 2013, kurse komuna e Ranillugut nuk ka ofruar përgjigje. Në komunën e Hanit të Elezit janë mbajtur 2 takime, në komunën e Dragashit numri i takimeve të mbajtura nga Komisioni Komunal për Ri-integrim gjatë periudhës raportuese është 8, ndërsa komuna e Klllokotit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke theksuar se ka mbajtur takime të shpeshta bashkëpunimi. Në komunën e Klinës, komisioni Komunal për Ri-integrim ka mbajtur 7 takime, në komunën e Fushë Kosovës janë mbajtur 9 takime deri me tani, Deçani 6 takime, 8 takime në Drenas, komuna e Shtërpçës 4 takime, komuna e Junikut 3 takime dhe vizita të vazhdueshme në terren të familjet dhe personat e riatdhesuar, në Mitrovicë komisioni komunal për ri-integrim deri më tani (në periudhën raportuese) ka mbajtur gjithsej 15 takime. Në Graçanicë është mbajtur 1 takim, kurse komuna e Vitisë, Mamushës, Skenderajt dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Shtimes janë mbajtur 2 takime, në komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 9 takime të KKR, komuna e Podujevës ka realizuar 8 takime, në komunën e Obiliqit janë mbajtur 12 takime, në komunën e Pejës gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 6 takime, në komunën e Prishtinës gjatë periudhës

raportuese janar-dhjetor janë mbajtur 10 takime të KKR-së, duke përfshirë 4 takime të natyrës teknike-organizative. Takimet mbahen varësisht prej volumit të kërkesave dhe rasteve emergjente. Çdo takim është i përcjellë edhe me procesverbalin e takimit përkatës; në komunën e Novobërdës janë mbajtur 2 takime.

### **Numri i takimeve të rregullta për ri-integrim mes komunave dhe nivelit qendror gjatë periudhës raportuese**

Komuna e Gjakovës për vitin 2013 ka mbajtur 2 takime regjionale dhe 3 takime të tjera lidhur me programin e ri-integrimit, komuna e Gjilanit, Malishevës dhe Dragashit kanë mbajtur nga 2 takime në nivelin rajonal, komuna e Lipjanit ka mbajtur 5 takime, komuna e Prizrenit ka mbajtur 3 takime me nivelin qendror, në komunën e Kamenicës dhe Hanit të Elezit janë mbajtur nga 4 takime me nivelin qendror, kurse komuna e Ferizajt nuk ka pasur asnjë takim me nivelin qendror. Komuna e Kaçanikut është përgjegjës se takimet janë mbajtur ad hoc, ndërkaq në komunën e Istogut janë mbajtur 7 takime, komunën e Ranillugut 5 takime. Komuna e Kllokotit Klinës, Fushë Kosovës, Rahovecit, Skenderajt dhe ZAMV nuk kanë ofruar informacione për këtë fushë. Në komunën e Deçanit ka pasur disa takime, mirëpo si takim i rregullt ka qenë takimi i dytë regional koordinues i mbajtur në fillim të qershorit me MPB, MAPL dhe MKK, 10 takime në Drenas, komuna e Shtërpçës 4 takime, komuna e Junikut 6 takime, në komunën e Mitrovicës janë mbajtur 6 takime. Në Graçanicë janë mbajtur 2 takime me nivelin qendror. Në komunën e Vitisë janë mbajtur 3 takime të këshillit për riatdhesim në vitin 2013, në komunën e Shtimes janë mbajtur 2 takime me MPB-në, në komunën e Mamushës është përmirësuar bashkëpunimi në mes nivelit qendror dhe atij lokal, në komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 4 takime të rregullta rajonale, në komunën e Podujevës janë mbajtur 7 takime, në komunën e Obiliqit janë mbajtur 2 takime (nga ZKKK kërkohet takime më të shpeshta), në komunën e Pejës më nivelin qendror ka realizuar 3 takime, në komunën e Prishtinës është mbajtur 1 takim koordinues në mes komunave dhe nivelit qendror: takimi i parë (dhe i pari për këtë vit) është mbajtur më 19.06.2013, ku ndër pikat kryesore ishte bashkëpunimi midis nivelit lokal dhe qendror, në komunën e Novobërdës janë mbajtur 10 takime.

### **Numri i takimeve të rregullta të komunave me shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe atashetë e migracionit**

Komuna Gjakovës ka mbajtur më shumë se 100 takime me organizata të shoqërisë civile të huaja dhe lokale, po ashtu rreth 7 takime me atashetë e migracionit të Zvicrës dhe Gjermanisë, komuna e Gjilanit ka mbajtur 7 takime, komuna e Malishevës ka mbajtur 1 takim me shoqërinë civile dhe 1 me KFOR-in, komuna e Lipjanit ka mbajtur rreth 21 takime, komuna e Prizrenit dhe Ferizajt janë përgjegjës se nuk kanë mbajtur takime, ndërsa në komunën e Kamenicës dhe Hanit të Elezit janë mbajtur nga 2 takime me organizatat ndërkombëtare, ndërsa me OJQ-të nuk ka pasur. Komuna e Kaçanikut është përgjegjës se takimet janë mbajtur ad hoc, kurse në komunën e Istogut nuk ka patur takime të rregullta por ka patur bashkëpunime të ngushta me shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare si: OSBE, EULEX, UNMIK, etj. Komuna e Ranillugut ka mbajtur 1 takim, komuna e Dragashit, Kllokotit, Shtërpçës, Mamushës, Skenderajt dhe Rahovecit nuk kanë ofruar informacione lidhur me këtë fushë. Në komunën e Klinës janë mbajtur gjithsej 3 takime me Ambasadën Amerikane, 1 UNDP dhe 1 me OSBE, në Deçan ka

patur më shumë se 20 takime me organizata lokale dhe ndërkombëtare siç janë OSBE, UNMIK, UNHCR, KAAD, URA2, në Drenas 10 takime më KFOR OSBE MPB. Në komunën e Junikut 5 takime, në komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Vitisë nuk ka pasur takime të veçanta. Në Graçanicë është mbajtur 1 takim me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, ZAMV takimet e zyrtarëve të MPB-së dhe zyrtarëve të Zyrës për riintegrim të ZAMV janë të rregullta dhe rregullisht mbahen trajnimet e ndryshme për përdorimin e programit qendror të personave të riadhesuar, si dhe trajnimi për zbatimin më të mirë të Rregullores. Në Fushë Kosovë janë mbajtur 9 takime deri me tani. Në komunën e Shtimes janë mbajtur 3 takime (2 me OSBE-në, dhe 1 me UNHCR-në), komuna e Podujevës vazhdimisht ka mbajtur takime, në komunën e Obiliqit janë mbajtur 10 takime, komuna e Pejës ka mbajtur 3 takime me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, në komunën e Prishtinës me shoqërinë civile janë mbajtur 5 takime, me organizatat ndërkombëtare 15 takime, në komunën e Novobërdës janë mbajtur takime të rregullta nga 2 herë në vit.

## 4. BUJQËSIA

*Hartimi i politikave, planeve dhe programeve zhvillimore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural*

### **HARTIMI I PROGRAMEVE ZHVILLIMORE NGA KOMUNA JUAJ NË SEKTORIN E BUJQËSISË**

**Hartimi i Programit Zhvillimor në përputhje me Master planin mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë 2010-2013 dhe Strategjinë komunale për zhvillim**

Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Fushë Kosovës, Deçan Lipjanit, Drenas, Shtërpçë, Junikut, Prizrenit, Kamenicës, Kaçanikut, Istogut, Ranillugut, Hanit të Elezit, Vitisë, Shtimes, Mamushës, Novobërdës, Skenderajt, Obiliqit, Pejës, Podujevës, Prishtinës dhe Dragashit e posedojnë master planin mbi zhvillimin e bujqësisë, në komunën e Ferizajt, Klinës, Kllokotit ende nuk është hartuar programi zhvillimor për sektorin e bujqësisë. Në komunën e Rahovecit në kuadër të programit zhvillimor të Bujqësisë, është hartuar programi në mbështetjen e fermerëve me ndarjen e subvencioneve dhe granteve për sektorët e lavëtarisë dhe të perimekulture. Në kuadër të departamentit ekziston strategjia zhvillimore prej 2012 deri më 2016. Në komunën e Shtërpçës programet të cilat janë planifikuar në strategji zbatohen në buxhetin e Komunës. Në komunën e Mitrovicës programet zhvillimore, janë harmonizuar me Master planin mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë dhe Strategjinë komunale për zhvillim. Departamenti i Bujqësisë të komunës së Graçanicës punon në përputhje me planin zhvillimor të MBPZHR, si dhe me planin vjetor të Departamentit për Bujqësi të Komunës së Graçanicës, ZAMV nuk ka ofruar përgjigje. Komuna e Vushtrrisë është përgjigjur se është në përputhje me planin vjetor të punës, raportin vjetor të punës, planin afatmesëm buxhetor dhe strategjia e zhvillimit ekonomik e komunës;

## ZBATIMI I PROGRAMEVE

### Sipërfaqja e tokës e konsoliduar (në ha)

Komuna e Gjakovës posedon sipërfaqe të tokës të konsoliduar në 55.684 ha, prej tyre 26624 me pyje, komuna e Malishevës ka një sipërfaqe të tokës punuese 11.600 ha dhe mbillet 80%, komuna e Lipjanit është përgjigjur se PZHK është në fazën e shqyrtimit publik sipas të cilit do të definohen kushtet për zhvillim të përgjithshëm në fushën bujqësisë. Në komunën e Prizrenit sipërfaqja e tokës është e konsoliduar në 500 ha, kurse komuna e Kamenicës, Prizrenit, Hanit të Elezit, Dragashit, Deçanit, Mamushës, Obiliqit, Prishtinës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Kaçanikut nuk ka sipërfaqe të tokës së konsoliduar. Në komunën e Istogut sipërfaqja e tokës së konsoliduar (tokë rezidente) është 45.389 ha dhe 19.220 ha pyje, në komunën e Ranillugut 3.885 ha, kurse në komunën e Klllokotit përafërsisht janë konsoliduar rreth 1500 ha tokë. Në komunën e Gjilanit sipërfaqe të konsoliduar janë 10.500 ha. Në komunën e Klinës nuk është kryer konsolidimi i sipërfaqeve të tokës, në Komunën e Fushë Kosovës 4511 ha tokë bujqësore, në Drenas sipërfaqja e tokës e konsoliduar (4900 ha), sipërfaqja 13,69 ha, komuna e Junikut ka një sipërfaqe bujqësore prej 4,840 hektarësh, në komunën e Rahovecit sipërfaqe e konsoliduar e tokës bujqësore është rreth 43.00ha, në komunën e Shtërpcës sipërfaqja është 13,69ha, në Mitrovicë 800 ha nën sistem të ujitjes në fshatrat: Frashër, Kqiq, Koshtovë dhe Vinarc sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, në komunën e Graçanicës është 9847.3 ha. Në komunën e Vitisë 300 ha sipërfaqe e tokës është e konsoliduar, në komunën e Shtimes 2500 ha e tokës është e konsoliduar, në komunën e Vushtrrisë sipërfaqja tokësore në masën e konsoliduar është 7500 ha, kurse në sistem të ujitjes 6810 ha, në komunën e Skenderajt tokë të konsoliduar nuk ka, në Komunën e Podujevës janë gjithsej 33.000 ha ndërsa vetëm 18.600 ha punohen, në komunën e Pejës nuk ka konsolidim të sipërfaqeve bujqësore, në komunën e Novobërdës sipërfaqja e konsoliduar në (ha) është 204 km<sup>2</sup>, kurse sipërfaqja e konsoliduar (në ha) është 10500 h pyllëzim të tjerat tokë bujqësorë.

### Grupi i Veprimit Lokal (GVL) i themeluar dhe funksional

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Ranillugut, Hanit të Elezit, Dragashit, Klinës, Drenasit, Shtërpcës, Deçanit, Mitrovicës, Rahovecit, Fushë Kosovës, Vitisë, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës, Novobërdës dhe Junikut është i themeluar dhe funksionon GLV-ja, në komunën e Kamenicës dhe Klllokotit GLV ende nuk është themeluar, në komunën e Mamushës GVL është themeluar por nuk është funksionale, ndërsa komuna e Graçanicës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje.

## MODERNIZIMI I FERMAVE BUJQËSORE DHE I NDËRMARRJEVE AGRO-PËRPUNUESE PËRMES SKEMËS SË GRANTEVE SI DHE PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE PËR MARKETING

*Mbështetja e ofruar nga komuna në modernizimin e sektorit privat të bujqësisë*

### **Numri dhe vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve**

Në komunën e Gjakovës janë miratuar 17 grande për fermerët në vlerë totale prej 416.463 €, në komunën Malishevës vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve janë: lopë 63.100€, dele dhe dhi 42.500€, bletari 11.500€, komuna e Lipjanit është përgjigjur se nga buxheti i komunës nuk ka pas ndonjë subvencion për bujqit por vetëm nga Ministria e Bujqësisë. Në komunën e Prizrenit numri dhe vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve është 972.366.00€. Në komunën e Kamenicës në fushën e bletarisë janë ndarë 11.000 euro, 200 koshere(LR) & 500 kg fleta dylli, në komunën e Ferizajt për këtë periudhë kohore është bërë subvencionimi i fermerëve komercial me preparate(herbicide) ndërtimi i serave familjare, furnizimi me fidanë të pemëve (mollë) furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve, subvencionimi i fermerëve me sistemin ujitjes pik-pik. Në komunën e Kaçanikut gjatë viti 2013 është bërë subvencionimi i fermerëve për lopë qumështore dhe kafshë të imëta( dele, dhive) nga ana e Ministrisë se bujqësisë, kurse në muajin prill fermerët janë subvencionuar me farë misri dhe pleh mineral. Vlera e projektit të realizuar kap shumën e 9.480 €, ku nga kjo kanë përfituar 158 fermerë. Në komunën e Istogut vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve është 379.490,00 €, ndërkaq në komunën e Ranillugut janë ndarë 19 grante. Në komunën e Hanit të Elezit janë shpërndarë 20 multikultivator mbi 50.00 euro, 13 serra nga 2.5000 euro (cartias Luxembourg) si dhe MAPL- ja dhe komuna me nga 3.950 euro, komuna e Dragashit nuk ka dhënë informacione, ndërkaq komuna e Klllokotit është përgjigjur se MBPZHR nuk jep informacione (shifra) rreth granteve që u epen fermerëve. Komuna e Gjilanit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke theksuar se komuna ofron trajnime profesionale, asistencë në formulimin e granteve, informim për llojet e granteve. Komuna e Klinës ka mbështetur fermerët me subvencione si në vijim: 760 për grurë -125 euro/h, 173 për misër 100/h, 60 për stalla, sera, pemë, 194 për lopë qumështore 50 euro/ krerë, 47 për dele, dhi, bletë, 10 euro/krerë, dy fermer me fidanishte 0,20euro/copë, dy fermer pula vjose-0,50/copë, në Komunën e Fushë Kosovës janë realizuar me të gjitha grandet dhe donacionet vlera prej 396.800€, në Deçan nuk ka grante dhe subvencione të dhëna fermerëve, në Drenas, vlera totale e granteve dhe subvencioneve dhënë fermerëve është 1.488.750.0, në Shtërpcë këtë vit janë ndarë 20 moto kultivator në vlerë prej 34 .000. Nga buxheti i komunës së Junikut nuk ka ndonjë subvencion i cili është ndarë për fermerët gjatë kësaj periudhe, vetëm subvencionet nga ana e MBPZHR. Në komunën e Rahovecit numri total i granteve dhe subvencioneve të dhënë fermerëve për vitin 2013 është 200euro, vlera totale për subvencione është 30.000.00€, kurse vlera për grande është 40.800.00€. Këtë vit janë ndarë 20 motokultivator në vlerë prej 34 .000 € në komunën e Shtërpcës, vlera totale e subvencioneve është: 158.816.82 €, vlera totale e granteve është: 766.100 €. Në komunën e Graçanicës numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të granteve dhe subvencioneve për bujqësi është 472, ndërsa mjetet e përgjithshme për grantet dhe subvencionet janë 145,891 euro. ZAMV nuk ka ofruar përgjigje. Komuna e Vitisë është përgjigjur se subvencionet nga komuna për fermerët në vitin 2013 ka planifikuar 35.000 nga të

hyrat vetanake ndërsa 70.000 euro subvencione nga grantet. Por në fund të vitit shpenzime nga buxheti kanë qenë 7.000 euro (nuk janë realizuar sipas planifikimeve). Drejtoria e Bujqësisë është duke vazhduar subvencionimin e fermerëve dhe bujqve; Në komunën e Shtimes ende nuk dihet vlera e granteve dhe numri pasi që aplikuesit janë në fazën e përzgjedhjes në MBPZHR, në komunën e Mamushes, gjithsejtë 93 fermer përfitues grande + subvencione, në komunën e Vushtrrisë janë mbështetur 1180 fermerë, në vlerë 2,063,563.80 euro; në komunën e Skenderaj dhënia e grandeve në sektorin e perime kulturë dhe ofrimi i trajnimeve në sektorët e ndryshme të bujqësisë, në komunën e Podujevës vlera totale e granteve ka qenë 225.000 €, në komunën e Obiliqit janë dhënë këto grante: 64 të subvencionuar MAPL-50%, komuna e F. Kosovës 25%, komuna e Obiliqit - vlera e për afërt 73.000.00, 16 motokultivator, 16 rimorkio, 16 freza dhe 16 pompa spërkatëse; në komunën e Pejës vlera totale e granteve dhe subvencioneve të dhëna për fermerët gjatë këtij viti është 613,813.16 €, në komunën e Prishtinës numri i fermerëve të përkrahur me subvencione është gjithsej 880 në një vlerë prej 438.233,00€, në komunën e Novobërdës edhe në periudhën Janar-Dhjetor ka ndarë Grante dhe subvencione për fermerë subvencione në vlerë 47.000€ për mekanizëm Bujqësorë, kurse përfitues janë 108 fermerë.

### **Sasia apo vlera e teknologjisë së re të blerë nga këto grante/subvencione**

Komuna e Gjakovës është përgjigjur se me grantet e përfituara është rrit efikasiteti, zbatimi teknologjisë bashkëkohore, në komunën e Malishevës janë ndarë subvencione në grurë në vlerë prej 249.100€ për 2491 ha dhe 255.000€ grante të tjera, komuna e Lipjanit është përgjigjur se jemi partner me komunën e Graçanicës për projektin e Koperativës Bujqësore në shumë prej 10.000 € ku brenda projektit do të ketë edhe subvencione për bujqit. Po ashtu, komuna e Lipjanit është partnere me komunën e Shtimes për projektin e pikës grumbulluese për pemë dhe perime, ku përfitues do të jenë edhe bujqit e komunës. Komuna e Prizrenit, Ranillugut, Dragashit, Klinës, Junikut, Shtërpçës, Rahovecit, Deçanit, Mitrovicës, Graçanicës, Vitisë, Skenderajt, Mamushës, Prishtinës dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Kamenicës janë blerë makina mjelëse 15 kultivator me vlerë 45000 euro, 286 memtarë kanë aplikuar përmes zyrës komunale, për grantet nga ministria kanë aplikuar 61 fermer. Nga grantet e ministrisë janë subvencionuar këto lëmi: blegtori(stalla), perimtar(sera) nga numri i lartshënuar 5 janë femra. Tek komuna e Ferizajt vlerë e teknologjisë së re janë subvencionimi me makina mjelëse për lopët qumështore, kurse në komunën e Kaçanikut janë subvencionuar me makina mjelëse, ku 27 fermerë kanë përfituar, si dhe vlera e projektit të realizuar është 7911€. Po ashtu, komuna në bashkëpunim me OJQ-në Caritasi i Luksemburgut dhe participimin e bletarëve, kanë realizuar projektin në bletari, ku përfitues janë 16 bletar me nga 10 zgjoje bletësh dhe pajisje për bletë. Vlera e këtij projektit kap shumën e 20.000€. Subvencionimi i fermerëve për kultivimin e grurit arrin vlerën e projektit në shumën totale 9815€ dhe 130 fermerë përfitues, mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 70m<sup>2</sup> përfitues janë 36 fermerë, vlera e projektit 34.200€. Subvencionimi me fidanë të pemëve, përfitues 9 fermerë, kurse vlera e projektit 7.155 €. Nga projektet e zhvillimit rural të Ministrisë së Bujqësisë kanë përfituar 5 fermerë: 1 në bletari, (11.700€), 1 mekanizëm bujqësor(47,250€), 1 pajisje për ruajtjen dhe tharjen e frutave malore(12,500€) dhe 2 përfitues për ngritje të stallës moderne (76,248€). Në komunën e Istogut gjatë periudhës janar-dhjetor 2013 janë pranuar 1258 kërkesa nga lëmi i Hidroekonomisë, Pylltarisë dhe Bujqësisë, 910 prej tyre janë miratuar, të refuzuara 89, ndërsa 257 janë në proces dhe 2 të refuzuara. Gjate kësaj periudhe nga ana e Drejtoratit janë kryer këto projekte: Pastrimi i Kanaleve për ujitje vlera e projektit

20.000€ hapja e rrugës malore Kaliqan-Lugu i Mëhallës 30.000€, mirëmbajtja e rrugëve malore vlera e projektit 30.000 €, ngritja e mini-serrave ( 20x5 m )me participim 73.000€, vaksinimi i qenve kundër tërbimit 3.900€, shpërblimet për fermerët fitues ne panair te gjedhit 640€, furnizimi i bletareve me bletë, koshere dhe pajisje bletare 65.900 €, përkrahja e pemëtarëve me fidanë te mollës dhe kumbullave 60.000 €, përkrahja e blegtoveve me makina mjelëse 25.000€, rregullimi i përroit vërshues në Cerce 50.000 €, rregullimi i kanalit ujitës“Jaruga”në Istog 12.000 €, kompensimi i dëmeve për blegtoret të shkaktuara nga ariu 9.050 €, në komunën e Hanit të Elezit sasia apo vlera e teknologjisë se re të blerë nga këto grante/subvencione janë 20 multi-kultivator, 13 serra me Cartias Luxembourg, 41 nga MAPL dhe participim nga fermerët, si dhe komuna e Kllkotit ka bërë subvencione për grurë, misër dhe pagesa direkte. Në komunën e Gjilanit grante kanë përfituar 6 fermerë kurse subvencione 1479 fermerë. Në komunën e Fushë Kosovës janë financuar teknologjia prodhuese dhe teknologjia përpunuese dhe shërbyese tek fermerët e komunës dhe është bërë pastrimi sanitar të rrugëve varrezave shkollave etj, në komunën e Drenasit blerja e koshereve 4000, sera 45000€, pylltari blerja e moto çikletave 6000€. Sasia apo vlera e teknologjisë së re të blerë është: komuna e Shtimës është përgjigjur se është në proces, në komunën e Mamushës vlera totale: grande 354.000 euro, subvencione 36.000 euro, në komunën e Vushtrrisë sasia dhe vlera e teknologjisë së blerë është 668,000.00 euro, komuna e Podujevës nuk ka dhënë përgjigje, në komunën e Pejës vlera totale e teknologjisë së re të blerë nga këto subvencione është 244,220.00€, në komunën e Novobërdës gjatë kësaj periudhe komuna në bashkëfinancim me MAPL-ën dhe bashkëfinancim me fermerë janë ndarë 11 Kultivatorë, ku MAPL-ja ka ndarë grandin në 45%, komuna 30% dhe fermerët 25%. Drejtoria për Bujqësi ka financuar projektin për vaksinimin e kafshëve, deleve, dhive, qenve dhe serrave vlera e këtij projekti është 6.500€

### **Vlera e granteve/subvencioneve e investuar në marketing**

Në komunën e Gjakovës janë shpërnda 850 broshura nga MBPZHR për lëmit e lavërtarisë, pemëtarisë, blegtorisë. Në komunën e Malishevës është i kënaqshëm investimi në marketing deri në 30%, komuna e Lipjanit, Kaçanikut, Dragashit, Klinës, Drenasit, Rahovecit, Shtërpçës, Mitrovicës, Fushë Kosovës, Graçanicës, Vitisë, Skenderajt, Mamushës, Novobërdës, Prishtinës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar të dhëna, në komunën e Prizrenit vlera e granteve/subvencioneve që është investuar në marketing është 10.000€. Në komunën e Kamenicës janë publikuar 12 lloje të ndryshme të fletushkave dhe broshurave etj. Ndërkaq, komuna e Ferizajt është përgjigjur se nuk ka pasur vlerë të grandeve në marketing, kurse komuna e Istogut ka investuar në marketing në vlerë prej 400€. Komuna e Ranillugut ka investuar 15% të vlerës së granteve në marketing, komuna e Hanit të Elezit nuk ka pasur mjete të dedikuara për këtë kategori, ndërkaq në komunën e Kllkotit dhe Junikut nuk ka pasur investim nga MBPZHR. Komuna e Gjilanit ka deklaruar se sa i përket vlerë së granteve ende nuk kanë të dhëna zyrtare nga MBPZHR meqë janë në proces të investimeve, ndërsa në Deçan në marketing është shpenzuar 87.50 €. Komuna e nuk ka ofruar përgjigje, në komunën e Shtimes marketingu është realizuar përmes MBPZHR, në komunën e Vushtrrisë është investuar 37, 000.00 euro, në komunën e Podujevës vlera e teknologjisë se re të blerë nga grantet ka qenë 800 €, në komunën e Pejës nuk ka pasur investime/grante për marketing, investimet kapitale janë orientuar në ngritjen e digave si dhe rregullimin dhe hapjen e kanaleve për ujtitje, vlera totale e këtyre investimeve është 200,000.00 €.



## **NDIKIMI I GRANTEVE/SUBVENCIONEVE TË KOMUNËS NË PUNËSIM PËR PËRMIRËSIM TË EFIKASITETIT NË PRODHIM**

### **Niveli i përmirësimit të efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese**

Në komunën e Gjakovës ka pasur efikasitet në përmirësimin e teknologjisë në dy ndërmarrjet: thertorja e kafshëve "Geberland" dhe qumështoren "Golaj". Komuna e Malishevës nuk ka ofruar të dhëna, komuna e Lipjanit është përfitues i një projektit nga MAPL-ja për laboratorët e shkollës së mesme, mirëpo nga ky projekt në mënyrë indirekte do të përfitojnë edhe fermerët pasi që aty do të mund t'i bëjnë disa analiza të qumështit psh. analizën e cilësisë së tokës, analizë e cila do të ndikoj pozitivisht në cilësinë dhe ngritjen e prodhimit të produkteve adekuate sipas cilësisë së tokës për prodhimtarin e bujqësisë. Në komunën e Prizrenit dhe Istogut përmirësimi i efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese është në nivel të lartë. Komuna e Kamenicës nuk ka ofruar përgjigje, kurse komuna e Ferizajt është përgjigjur se është duke u përmirësuar niveli i efikasitetit të ndërmarrjeve agro-përpunuese. Sa i përket komunës së Kaçanikut, kjo komunë nuk ka ndërmarrje agro përpunuese, Komuna e Ranillugut ka investuar 15% të vlerës së granteve në marketing, në komunën e Hanit të Elezit pas ndryshimeve në teknologji dhe dhe përshtatja me ISO standardet e parapara nga BE-ja (konkretisht bëhet fjale me UKA SARAJ rreth granteve nga BE-ja për shtimin dhe përmirësimin e cilësisë së mishit dhe produkteve të mishit, komuna e Ranillugut, Dragashit Deçanit, Shtërpçës, Graçanicës, Klinë, Mamushës, Obiliqit, Skenderajt dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, kurse komuna e Kllokotit dhe Visitës nuk kanë ndonjë ndërmarrje të tillë. Në komunën e Gjilanit ndërmarrjet agro përpunuese kohëve të fundit kanë përmirësuar teknologjinë e punës përmes granteve që kanë përftuar nga MBPZHR dhe KE-së. Po ashtu janë përmirësuar edhe kushtet e prodhimit. Në komunën e Fushë Kosovës është rritur efikasiteti si në aspektin e përpunimit të qumështit si dhe në perimekulturë. Në komunën e Drenasit grandet kanë ndikuar pozitivisht si në punësimin po ashtu edhe në shtimin e prodhimit, ndërsa nuk ka ndonjë ndërmarrje agro përpunuese në komunën e Junikut, në komunën e Rahovecit për përmirësimin e efikasitetit të ndërmarrjeve përpunuese është 5.000.00€. Në Mitrovicë po ashtu ndikimi i granteve vërehet dukshëm pasi që çdo vit subvencionojmë sektorët e ndryshëm të Bujqësisë si: pemëtarinë, bletarinë pastaj sektorin e qumështit etj. Në komunën e Shtimes, sektori i Bujqësisë është në angazhim permanent për përmirësimin e efikasitetit në ndërmarrjet agro-përpunuese, komuna e Vushtrrisë është përgjigjur se është i kënaqshëm, në komunën e Podujevës është i shkëlqyer, në komunën e Pejës janë përkrahur fermerët përmes shoqatave të fermerëve. Këto investime kanë ndikuar mjaft në përmirësimin e kushteve për punë dhe ngritjen e rendimentit; në komunën e Prishtinës sa u përket ndërmarrjeve agro-përpunuese efikasiteti i përmirësimit është mesatar, në komunën e Novobërdës grantet për subvencion për fermerë ka përmirësuar dukshëm efikasitetin e ndërmarrjeve agro-përpunuese duke e pas parasysh sa vështirësi kanë pasur këto ndërmarrje me dhënien e këtyre subvencioneve kanë lehtësira në punën e tyre.

## PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË ZONAT RURALE

### *Investimi i komunave në infrastrukturën rurale*

#### **Rrugët, rrjeti elektrik, furnizimi me ujë dhe transporti në zonat rurale i përmirësuar (numri i fshatrave të përfshira, lloji i infrastrukturës së rregulluar, gjatësia në metra apo km etj)**

Në komunën e Gjakovës rrugët janë të asfaltuara në mbi 93%, derisa 70% janë me ndriçim publik. Transporti publik është i organizuar në të gjitha fshatrat në gjithsej 218 km. Komuna e Malishevës i ka 44 fshatra dhe 150 km rrugë të asfaltuara, në komunën e Lipjanit janë hartuar projektet kryesore - infrastrukturë në zonat rurale 14 projekte, 10 kanalizime dhe 4 rrugë (14 fshatra). Në komunën e Prizrenit janë shtruar 8 km rrugë fushore në 4 fshatra, 150m kanal për ujitje të tokave bujqësore në fshatin Smaq, në shtruarjen e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve dhe ujësjellësit nga DSHP-ja, janë investuar në vlerat si në vijim: 10.766,193.75€, rrugët e asfaltuara 12.564 km, rrugët e shtruara me kupëza 85.10 km, kanalizim dhe ujësjellës 18.80 km. Në komunën e Kamenicës, ndriçimi publik është bërë në shumë lokalitete, trotuare dhe asfaltim. Kurse në komuna e Ferizajt në infrastrukturën rurale ka investuar me sa vijon: rrugë të asfaltuara në gjatësi 39141,02 metra, shtruarja në kupëza në gjatësi 1658,40 metra, rrjeti i ujësjellësit i shpërndarë në 45300,00 metra, ndërkaq transporti publik zhvillohet në 42 fshatra ose 93.33%. Në vitin 2013, komuna e Kaçanikut ka investuar në rrugë rurale në 10 fshatra në vlerë prej 576.945,69 €, ujësjellës në 2 fshatra dhe ujësjellësin kryesor në vlerë prej 39.22,31€, trotuare në dy fshatra në vlerë prej 40.457,42€, kanalizime në tri fshatra në vlerë prej 39.99,93€. Në komunën e Istogut hapja e rrugëve malore, në gjatësi prej 10 km, në vlerë prej 40.000 €, mirëmbajtja e rrugëve në gjatësi prej 40 km, në vlerë prej 20.000 €, në komunën e Ranillugut janë shtruar 3 km rrugë. Në komunën e Hanit të Elezit shtrimi i rrugëve me asfalt si dhe kubizmi i lagjeve ka ndikuar që t'i inkurajon fermerët t'i kyçen seriozisht sektorit të bujqësisë me rritjen e gjedheve si dhe mbjelljen vjeshtore, gjithashtu infrastruktura rrugore si dhe rrjeti elektrik në komunën e Hanit të Elezit është e mbuluar në tërësi, kurse furnizimi me ujë ndahet në dy pjesë: njëra pjesë furnizohet me ujësjellësin e Dincës kurse pjesa tjetër furnizohet me ujësjellësin e Glloboqicës, transporti në zonat rurale behët nga një kompani e kontraktuar e cila ka për detyrë që ti bart nxënësit për në shkollë. Gjatësia totale e rrugëve komunale të asfaltuara është 49 km zona rurale dhe urbane, në komunën e Dragashit infrastruktura e rregulluar është 58 km, ndërkaq në komunën e Kllokotit nuk ka investime të tilla. Në komunën e Gjilanit janë bërë investime në: rrugët urbane 158.7km, rrugët rurale 193.9 km, rrugët lokale komunale 222.45 km të asfaltuara, 129.85 km të pas asfaltuara, kura në total për vitin 2013 janë asfaltuar 7.91 km infrastrukture komunale, ndriçimi publikë qytet 59 km, ndriçimi publik në fshatra 71 km, totali për vitin 2013 30km. Komuna e Klinës ka bërë Rehabilitimi i digës në Grabanicë, ndërtimi i shtyllave bregore të urës Krushevë e Madhe, Rrugë e përfunduar Klinë -Shtupel 5800 m, Leskoc 2700 m, Qabiq-Ujmir 2250 m Jashanicë-Lagja e Hotve 1000 m, Jashanicë-Lagja e Prekadinëve 900 m, Ujmir-Shtaricë-Siqevë 1560 m, Gllarevë-Rixhevë 10 km dhe ka përfunduar , rruga në Bokshiq, Deiq-Polce, Dugajevë, Poterq, Dreno. Në Komunën e Fushë Kosovës 208 trupa të energjisë solare janë vendosur në Qytet dhe Fshatrat të financuara nga Komuna, në Deçan nuk ka investime, në Drenas Rrugë të asfaltuara 20.5 km, ndërsa me zhavor janë shtruar 3 km. Janë të përfshira 27 fshatra Kanalizim-20.4 km, ujësjellës-3,5 km, komuna e Junikut dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje, komuna e Rahovecit vazhdon të investoj në përmirësimin e

infrastrukturës së zonave rurale duke rregulluar infrastrukturën rrugore në vlerë prej 216.825.00 Euro për vitin 2013. Komuna e Shtërpçës ka investuar, në sistemin pikë për pikë për ujë. Në Mitrovicë transporti ndërrurban funksionon shumë mirë. Ndërtimi i rr.Migjeni dhe rr.Mehmet Aqif Ersoy me kubëza betoni në Mitrovicë. Ndërtimi i rr.Bilall Xhaferi me kubëza betoni në Mitrovicë. Degëzimi i rr.në Magjistralen, Mitrovicë-Prishtinë në fsh.Shupkoc me kubëza në fsh.Koshtovë me kubëza betoni. Ndërtimi i rrugës me zhavorr në fsh.Vllahi kubëza betoni degëzimi i rr.në Magjistralen Mitrovicë Prishtinë në fsh.Shupkoc me kubëza betoni..Ndërtimi i rr.në lagjen e muhagjerëve me kubëza betoni në fsh.Shipol..Ndërtimi i rr.Hasan Budakova me kubëza betoni në Mitrovicë. Ndërtimi i trotuarit në fsh.Koshtovë me kubëza betoni. Ndërsa në komunën e Graçanicës të gjitha fshatrat ekzistojnë infrastruktura rrugore dhe elektrike dhe është në gjendje të mirë, por disa fshatra nuk e kanë sistemin e ujësjellësit dhe transportin publik. Sistemi i ujitjes në territorin e komunës së Graçanicës është i tipit individual me shfrytëzimin e ujërave nëntokësore (bunarë, puse). Sipërfaqja e cila ujitet është 350 ha. Në komunën e Drenasit rrugë të asfaltuara 20.5 km, ndërsa me zhavorr janë shtruar 3 km. Janë të përfshira 27 fshatra Kanalizim-20.4 km,Ujësjellës-3,5 km. Në fushën e investimeve që komunat kanë bërë për infrastrukturën rurale janë: Në komunën e Vitisë rreth 20 km rrugë të shtruara rrugë të arave), 5-6 km në zonat rurale për vitin 2013, janë të përfshira 7 fshatra, 1 rrjet elektrik me 1 km me rreth 2000 euro vlerë. Rruga Viti-Pozheran rreth 4 km e asfaltuar, ka krijuar qasje më të shpejtë dhe më të lehtë për udhëtim dhe qasje në tokat bujqësore rreth lumit Morava; në komunën e Shtërmës janë ndërtuar-riparuar rrugët rurale në fshatin Carralëvë 1.7 km. Kanë filluar punimet për asfaltimin e rrugëve të fshatrave malore Dugë-Karaçicë, Topillë, Llanisht dhe Rancë-gjithsej 40 km; në komunën e Mamushë, janë bërë këto investime: Rrugë kubëza-5500 m<sup>2</sup>, furnizimi me 2 trafostacion, ndriçim publik 1500, furnizime me kontenerë për mbeturina. Në komunën e Vushtrrisë janë asfaltuar 37 km rrugë në viset rurale, rrjeti elektrik - është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e banuara të komunës, ndërsa në periudhën raportuese nuk ka pasur investime në këtë lëmi. Transporti në zonat rurale - brenda kësaj periudhe raportuese pra 2013 është organizuar sikurse në periudhën raportuese janar - qershor ku prej 67 vendbanimeve sa ka komuna, në 59 prej tyre ekzistojnë shërbimi i transportit të udhëtarëve. Furnizimi me ujë - brenda vitit 2013 ka pasur investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në pjesën përfundimtare të komunës por vetëm në gypin magjistrallë kështu që ende mund të themi se prej 67 vendbanimeve vetëm në 29 vendbanime ekzistojnë rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm; në komunën e Skenderaj, në zonat rurale janë investuar projektet kryesisht në rrugë, ku rreth 75% e rrugëve primare janë asfaltuar, përmirësimi i sistemit të elektrifikimit, trajtimi i ujërave fekale dhe ujësjellësit rreth 10%. Janë përfshirë 48 fshatra, kryesisht 54 vendbanime. Në infrastrukturën rrugore në zonat rurale është investuar rreth 28 mil.euro dhe investime të tjera nga donatorët në infrastrukturë të ndryshme; në Komunën e Podujevës në shumë fshatra të komunës është përmirësuar dukshëm; në komunën e Obiliqit janë bërë investimet në vijim, ndriçimi publik Obiliq 4km gjatësi, 3.5 km, kurse Obiliq asfalt në fillimin e punëve; në Komunën e Pejës investimet kapitale që i ka bërë janë këto projekte: rregullimi i kanalit të ujitjes në fshatin Nabergjan me vlerë 60,000.00 €, rregullimi i kanali të ujitjes në fshatin Katundi i Ri me vlerë 50,000.00 €, rregullimi i kanalit të ujitjes në fshatin Radac-Novoselë në vlerë 35,000.00 €, rregullimi i digës në fshatin Buqan, vlera e projektit 45,000.00 €, rregullimi i digës në fshatin Kërstovc në vlerë prej 10,000.00 €; në komunën e Prishtinës janë bërë këto investime: rrugë me asfalt 22.5 km, rrug me zhavorr 26.8km, rrug me kubëza 6.7km, trotuare me kubëza 6.7km, kanalizim fekal dhe atmosferik

10.26km; Investimet në vitin 2013 janë bërë në këto fshatra; Prapashticë, Gllogovicë, Nishevc, Keqekollë, Koliq, Grashticë, Mramur, Busi, Sutesk, Makovc, Llukar, Bardhosh, Prugovc, Lebanë, Rimanishtë, Hajvali, Marevc. Vlera e investimeve: 2.840.488,16€; në komunën e Novobërdës sa i përket transportit publik komuna ka punuar në ndërtimin e kabinave pritjes të autobusëve dhe po ashtu është duke punuar në gjendjen e një modaliteti për sigurimin e një transporti publik për brenda komunës.

### **Sistemi i ujitjes i rehabilituar (pendët e rregulluara, kanalet e ujitjes të rregulluara, sipërfaqja e ujitur në ha)**

Në komunën e Gjakovës, sistemi i ujitjes është i rehabilituar dhe janë në proces dy penda, derisa janë ndërtuar afro 6000 m. Komuna e Malishevës nuk ka sistem të ujitjes së tokave bujqësore, komuna e Lipjanit, Ranillugut, Hanit të Elezit, Dragashit, Rahovecit, Shtërpçës, Mamushës, Obiliqit, Vitisë dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar të dhëna, në komunën e Prizrenit sistemi i ujitjes është i rehabilituar, në komunën e Kamenicës sistemi i ujitjes në shumë lokalitete është në proces të rehabilitimit, kurse në komunën e Ferizajt rehabilitimi i kanalit të ujitjes prej Neredimes së ultë deri në fshatin Balaj për ujitjen e tokave bujqësore. Komuna e Kaçanikut ka bërë rregullimin e kanalit të ujitjes 1200m gjatësi, kurse vlera e projektit është 36.073,95 €, komuna e Istogut ka një sistem të rehabilituar të ujitjes, gjithashtu komuna ka pastruar kanalet e ujitjes në gjatësi prej 25 km, në vlerë prej 20.000 € ku rreth 3.500 ha kanë kushte për ujitje, ndërsa komuna e Klokotit nuk ka sistem të ujitjes (penda-kanale). Komuna e Gjilanit ka 42 fshatra së bashku me qytetin, furnizim me ujë kemi në 14 fshatra me qytetin, kurse për vitin 2013 është investuar në 5 fshatra. Komuna e Klinës ka rehabilituar urën në Rudicë, rruga në Volljak, Jagodë, Ujësjiellësi në Carovik, Kanalizimi në Stupë, Kanalizimi në Poterq, Zllakuqan, Ujmir, Pogragjë, Rehabilitimi i rrjetit elektrik Lagja te Albi, Janë hapur 3 puse gjatë këtij viti në fshatin Grabovc dhe në lagjen 07 të komunitetit REA dhe në rrugën "Daut Bogujevci" në Fushë- Kosovë në Qytet, në Deçan nuk ka investime, në Drenas është bërë rehabilitimi i kanaleve të hapura dhe i stacioneve pompikë në sipërfaqe prej 3004m, kurse janë ujitur 373 ha. Në komunën e Shtërpçës realizimi i subvencioneve për bujqësi me anë të sistemit të ujitjes pikë për pikë për sipërfaqen prej 5 ha. Në komunën e Junikut gjatë vitit të kaluar është ndërtuar një pendë e ujitjes "te prita e katundit" nga MBPZHR me participim të Komunës së Junikut si dhe është rregulluar sistemi i ujitjes në pronën e Florim Shalës nga MBPZHR me participim të Komunës së Junikut dhe përfituesit si dhe është subvencionuar një fermer në ngritjen e 5 hektarëve me pemishte. Në Mitrovicë prej muajit prill ka filluar edhe ndërtimi i rrjetit të ujësjiellësit edhe nëpër lagjet e qytetit, si dhe është duke u realizuar projekt "Ndërtimi i rrjetit të Hidrantëve në Mitrovicë"- Faza e dytë. Në Komunën e Gracanicës sipërfaqja e cila ujitet është 350 ha. Në komunën e Shtimes nga 22 fshatra 19 kanë rrugën e asfaltuar, kanë ujësjiellës dhe kanalizim, në komunën e Vushtrrisë është përgjigjur se nuk ka, në komunën e Skenderaj gjatë 2013 janë realizuar 19.50 km rrugë të asfaltuara, furnizim me ujë 21 vendbanime dhe ndriçim publik rreth 4.66 km; komuna e Podujevës është duke punuar në këtë drejtim, në komunën e Pejës janë investuar gjithsej 200,000.00 €, në komunën e Prishtinës sistemi i ujitjes Ibër-Lepenc është funksional por nuk shfrytëzohet me kapacitet të plotë sipërfaqet e ujitura në komunën e Prishtinës janë diku gjithsej 250ha, komuna e Novobërdës në muajt janar-dhjetor ka arritur të përmirësojë jetën në vendbanimeve rurale në rrjetin e ujësjiellësit në Makreshë i Epërm dhe në vendbanimin Hagaj. Furnizimi me ujë është duke ndodhur në zonën e vendbanimit Bostan projekt i financuar nga

IOM dhe Zyra e kryeministrit ku është duke u lidhur ky vendbanim në rrjetin e ujësjellësit Qylkocv Tullar dhe është duke u punuar faza e parë e këtij ujësjellësi ,ndërsa tash janë në bisedime edhe për fazën e dytë të këtij sistemi ku parashihet kycja e familjeve në sistem.

### **Lloji i projekteve të realizuara në zonat rurale përmes Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) me ndikim në zonat rurale**

Komuna e Gjakovës ka përfituar një grand për rrethojën e shkollës në fshatin Smolicë, në komunën e Malishevës janë realizuar 2 projekte nga GLV-ja, gjelbërim me vlerë 20.000€,parku në Golesh dhe oborri i shkollës fillore në Bellanic, komuna e Lipjanit dhe Prizrenit nuk kanë ofruar të dhëna, në komunën e Kamenicës nuk është i themeluar GVL-ja, kurse në komunën e Ferizajt Grupi Lokal i Veprimit nuk ka realizuar asnjë projekt në zonat rurale, komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me OJQ-në Haifer-Kosova, nga projekti i mëshqerrave kanë përfituar 22 fermerë nga 1 mëshqerrë barse, kurse nga pasimet kanë përfituar 15 fermerë. Vlera e projektit është 55.500€. Po ashtu, komuna ka mbështetur GLV-në për projektin në shumë totale 15.500€. Përmes Grupit Lokal të Veprimit dhe në bashkëpunim me OJQ-në KS - Kosova është organizuar panairi i gjedhit Kaçaniku 2013. Vlera e projektit të realizuar ka totalin e 2470 €. Nga ky panair kanë përfituar shpërblime 12 fermerë në vlerë prej 100 - 250€. Në komunën e Istogut është bërë ndërtimi i mini pendës mbi lumin Shushicë në vlerë prej 10.000 € si dhe rehabilitimi i kanalit vërshues në fshatin Cerrcë, vlera e projektit 50.000 €. Komuna e Ranillugut, Hanit të Elezit, Rahovecit, Shtërpçës, Mitrovicës, Graçanicës, Prishtinës dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Dragashit lloji i projekteve të realizuara në zonat rurale përmes Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) me ndikim në zonat rurale janë 3 projekte në infrastrukturë, ndërkaq komuna e Klokotit është përgjigjur se nuk e ka të themeluar GVL-në për zonat rurale. Në komunën e Gjilanit prej 42 fshatrave që janë, në 34 fshatra janë të pajisur me transport urbano periferik. Komuna e Klinës ka realizuar projektet Fabrika e përpunimit të djathit "Italkos" në Zajm, Projekti "Diversifikimi i resurseve ekonomike për turizëm 'si dhe rregullimi i një parku në qytet, ndërsa në komunën e Fushë Kosovës mjetet financiare në shumë prej 120€ të planifikuara me buxheti e Komunës për ujësjellës -sistem të ujitjes dhe ndërtim të rezervarëve- puseve janë realizuar në tersi, gjithashtu janë realizuar mjetet e planifikuara për asfaltimin e rrugëve, ku për momenti është duke u ndërtuar rruga Pomozotin - Kuzmin - Fushë-Kosovë. Në komunën e Deçanit nuk ka projekte të realizuara, ndërsa në komunën e Drenasit, GLV i ka realizuar dy projekte në zonat Rurale 1 për rregullimin e varrezave në F. Negroc dhe 2 për rregullimin e oborrit të shkollës Fillore në F. Gradicë. Në komunën e Junikut në bashkëpunim me Shoqatën e fermerëve "Kallavaji" është aplikuar në MBPZHR për ndërtimin e pendës për ujitjen e tokës bujqësore projekt i cili është në proces të përfundimit. Në komunën e Vitisë GLV ka realizuar 4 projekte (2 rrethoja për shkollën, 1 serra për fermentet -30 serra), fushë sportive në vitin 2013 në fshatin Smire: kataloge - udhëtimi me foto (turistik) - Regjioni lindje Katalogu historik dhe kulturor (regjioni lindje), komuna e Shtimes është përgjigjur se transporti në zonat rurale është rregulluar plotësisht, në komunën e Mamushës GLV-të nuk kanë realizuar, në komunën e Vushtrrisë është përgjigjur se nuk ka, komuna e Skenderaj në asfaltimin e rrugëve janë realizuar rreth 175 km, kanalizimit 63 km kanalizim, ujësjellës 57km si dhe elektrifikimi rreth 70% e fshatrave, në komunën e Podujevës është bërë rregullimi i ambientit në disa shkolla dhe në disa hapësira tjera gjelbëruese; në

komunën e Obiliqit, në fshatin Shipitull, Grabovc, në komunën e Pejës projekti për rregullimin dhe hapjen e rrugës 3,5 km., në komunën e Novobërdës GLV-ja Kalaja, kohën e fundit ka punuar në disa iniciativa si në realizimin e disa projekteve të vogla me karakter kulturor dhe në sektorin e grumbullimit të informatave për sektorin e pyjeve, po ashtu kohën e fundit është duke u punuar ngushtë edhe me një numër të madh të organizatave në gjetjen e donatorëve për realizimin e projekteve për bizneset komunale dhe fermerët e komunës sonë. GLV-Kalaja është duke punuar edhe me projektin e Komisionit Evropian Rural+ projekt i cili financohet nga komisioni evropian përmes GLV në Gjilan ku janë të përfshira të gjitha GLV-të e regjionit të Gjilanit dhe projekti ka të bëjë me krijimin e një qendre të marketingut për këtë regjion.

## **SHFRYTËZIMI DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I PYJEVE**

*Ndërmarrja e veprimeve nga komuna në mbrojtjen e pyjeve*

### **Sipërfaqet e pyllëzuara në ha**

Në komunën e Gjakovës, agjencioni i pyjeve ka bërë pyllëzimin për 25 ha, në komunën e Malishevës janë pyllëzuar 30 ha, në komunën e Gjilanit janë pyllëzuar 20 ha, në komunën e Lipjanit janë pyllëzuar 20 ha, në komunën e Prizrenit janë pyllëzuar gjithsejtë 15 ha, në komunën e Kamenicës janë pyllëzuar 15 ha, kurse në komunën e Ferizajt janë pyllëzuar gjithsejtë 6 hektar me dru halor. Në komunën e Kaçanikut janë pyllëzuar 10 hektar sipërfaqe, ndërsa në komunën e Istogut për vitin 2013 nuk ka patur sipërfaqe që janë pyllëzuar, kurse në komunën e Ranillugut janë pyllëzuar 3106 ha, në komunën e Hanit të Elezit sipërfaqe të pyllëzuar janë 7 ha, në komunën e Dragashit 15 ha, në komunën e Klllokotit 347 ha pyje. Komuna e Klinës këtë vit ka vazhduar mirëmbajtja e sipërfaqeve të pyllëzuara, si dhe ruajtja nga dëmtimi, në tetor të vitit 2013 janë pyllëzuar 6 ha (në Volljak) në Komunën e Fushë Kosovës 1619 ha, në komunën e Deçanit nuk ka aktivitet në pyllëzim, në komunën e Drenasit 10 h, ndërsa komuna e Junikut ka pyllëzuar një sipërfaqe prej 7 hektarëve me gjithsejtë 17,500 fidane të llojit pishë e zezë dhe poje. Në komunën e Rahovecit sipërfaqe të pyllëzuara 30.ha. Komuna e Shtërpçës, Skenderajt, dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në Komunën e Mitrovicës 10170 ha, janë sipërfaqe të pyllëzuara, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme pyjore në territorin e komunës së Graçanicës është 389.79 ha. Në komunën e Vitisë janë 15 ha të pyllëzuara, në komunën e Shtimes janë pyllëzuar 10 ha në fshatin Mollopolc, në komunën e Mamushes nuk ka sektorë të pylltarisë, në komunën e Vushtrrisë janë 39.00 ha, në komunën e Podujevës gjatë vitit 2013 janë pyllëzuar 70 ha pisha dhe fidane të ndryshme, në komunën e Obiliqit pyje në të gjithë komunën ka 1150 hektar, 676 hektar shoqërore, 474 hektar private, në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 nuk ka pasur ri-pyllëzim, në komunën e Prishtinës sipërfaqet e pyllëzuara janë gjithsej 15 ha, pastrimi fito sanitar gjithsej 105h, në komunën e Novobërdës gjatë periudhës janar-dhjetorë në vendin e quajtur "Mendellakë" janë pyllëzuar me llojin e pishës së zezë (Pinus Nigra) 25000copa fidanë me sipërfaqe 10 ha kanë punuara.

## **Numri i fletëparaqitjeve të ushtruara**

Në komunën e Gjakovës janë ushtruar 247 fletëparaqitje, në komunën e Gjilanit 404, në komunën e Malishevës 209 fletëparaqitje, në komunën e Lipjanit 312 fletëparaqitje, në komunën e Prizrenit janë paraqitur 241 fletëparaqitje, në komunën e Kamenicës janë paraqitur 73 fletëparaqitje, ndërkaq në komunën e Ferizajt janë ushtruar 730 fletëparaqitje, në komunën e Kaçanikut janë ushtruar 575 fletëparaqitje për vitin 2013, në komunën e Istogut 132 fletëparaqitje, në atë të Ranillugut 8, në komunën e Hanit të Elezit numri i fletëparaqitjeve është 169, në komunën e Dragashit 49, kurse në atë të Kllokotit nuk ka shifër të saktë ngase me këtë fushë menaxhon komuna e Vitisë. Në komunën e Klinës janë ushtruar 128 fletëparaqitje në këtë vit, për 284 m<sup>3</sup> dru me vlerë 36,499.00€, në komunën e Fushë Kosovës 57 fletëparaqitje të ushtruara prej të cilave 3 janë në prokurori, 25 në Deçan, në Drenas 46 fletëparaqitje, numri i fletëparaqitjeve në komunën e Junikut për vitin 2013 është 19, 18 janë për kundërvajtje kurse 1 është për vepër penale, masa totale 17.56 m<sup>3</sup> dhe në vlerë monetare prej 2,634.00€ që dallon nga viti i kaluar pasi që kompetencat për ruajtjen e pyjeve kanë kaluar në Drejtorinë e parkut kombëtar “ Bjeshkët e Nemuna”. Në komunën e Rahovecit numri i flet paraqitjeve është 81. Komuna e Shtërpçës, Graçanicës, Mamushës, Skenderaj dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në Mitrovicë numri i fletëparaqitjeve ka qenë 24 për tremujorin e tretë. Tek numri i fletëparaqitjeve në komunën e Vitisë janë gjithsejtë 476 flet paraqitje të ushtruara, në komunën e Shtërmës janë gjithsejtë 114 flet paraqitje të ushtruara, në komunën e Vushtrrisë janë gjithsejtë 126 flet paraqitje të ushtruara; në komunën e Podujevës gjithsejtë janë 561 fletë paraqitje të ushtruara, në komunën e Obiliqit gjithsejtë janë 2 fletë paraqitje, në komunën e Pejës janë gjithsejtë 150 fletëparaqitje, nga ky numër 86 për kundërvajtje dhe 64 paraqitje për vepra penale të ushtruara, në komunën e Prishtinës janë ushtruar gjithsej 57 fletëparaqitje, në komunën e Novobërdës janë ngritur 56 fletëparaqitje prej të cilave 41 copë janë dërguar në gjykatën për kundërvajtje me vëllim 126.92<sup>3</sup> 7 fletëparaqitje penale më vëllim 42.55 m<sup>3</sup> janë dorëzuar në gjykatën themelore Gjilan 6 fletëparaqitje transporte ilegale më vëllim prej 28.50 m<sup>3</sup> dhe 1 fletëparaqitje të prerjeve në pyje private me vëllim 34.10 m<sup>3</sup> në gjykatën komunale, përfaqësuar si raste.

## **Numri i inspektimeve**

Në komunën e Gjakovës janë bërë 320 inspektime, në komunën e Gjilanit 420, në komunën e Malishevës janë inspektuar 56 raste, në komunën e Lipjanit janë bërë 96 inspektime, në komunën e Prizrenit janë bërë 400 inspektime, komuna e Kamenicës, Rahovecit, Graçanicës, ZAMV, Mamushës, Skenderajt, Obiliqit, Pejës, Novobërdës, Prishtinë dhe Shtërpçës nuk kanë ofruar të dhëna, kurse në komunën e Ferizajt janë inspektuar 160 raste. Komuna e Kaçanikut dhe Istogut kanë ofruar përgjigje të njëjtë dhe të përgjithësuar duke thënë se bëhen inspektime të vazhdueshme, në komunën Ranillugut janë bërë 4 inspektime, në komunën e Hanit të Elezit janë bërë 100 inspektime nga rojet e pyjeve dhe nga koordinatori i APK-së, në komunën e Dragashit numri i inspektimeve është 49, kurse në komunën e Kllokotit nuk ka inspektor për pyje. Në komunën e Klinës, inspektimet kryhen nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës në bashkëpunim me stafin lokal. Regjistrimi i gjendjes bëhet 2 herë në vit, në komunën e Fushë Kosovës 57 fletëparaqitje të ushtruara prej të cilave 3 janë në prokuror, 15 Deçan. Gjatë kësaj periudhe në komunën e Junikut janë bërë 9 inspektime nga APK – Pejë Inspektorati i pyjeve

dhe Drejtoria Komunale. Në Drenas 60 inspektime, ndërsa në komunën e Mitrovicës numri i inspektimeve 30. Tek numri i inspektimeve në komunën e Shtimes gjithsej janë 52, komuna e Vitisë është përgjegjur se numri i inspektimeve është i vazhdueshëm, në komunën e Vushtrrisë numri i inspektimeve është 130, në komunën e Podujevës numri i inspektimeve është 75.

### **Numri i dënimeve për kundërvajtje dhe veprat penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve**

Në e komunën e Gjakovës janë dhënë 300 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe vepra penale të cilat janë në proces, në komunën e Gjilanit numri i dënimeve për kundërvajtje dhe vepra penale është 62. Komuna e Malishevës dhe Klllokotit nuk kanë ofruar përgjigje për këtë fushë, komuna e Lipjanit është përgjegjur se janë shqiptuar 275 dënime për kundërvajtje dhe 37 vepra penale, në komunën e Prizrenit janë shqiptuar 250 dënime për kundërvajtje dhe veprat penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve, në komunën e Kamenicës janë shqiptuar 48 dënime për kundërvajtje dhe 25 dënime për vepra penale, ndërkaq në komunën e Ferizajt për kundërvajtje janë shqiptuar 177 dënime dhe për vepra penale 63 dënime. Gjithashtu edhe në komunën e Kaçanikut janë shqiptuar 77 dënime për kundërvajtje dhe vepra penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve, kurse në komunën e Istogut janë shqiptuar 74 vepra penale dhe 58 dënime për kundërvajtje, komuna e Ranillugut, Klinës, Fushë Kosovës, Junikut, Rahovecit, Mamushës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës, Skenderajt dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Hanit të Elezit, numri i dënimeve për kundërvajtje është 158 dhe 11 vepra penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve, në komunën e Dragashit numri i dënimeve është 49, në Deçan nuk ka të raportuar për ndonjë rast, në Drenas 29 kundërvajtje dhe 17 penale. Në Shtërpçë kallëzime penale të zgjedhura janë 18 dhe kundërvajtje 53. Në Mitrovicë kundërvajtje janë 21 dhe penale 3, në Graçanicë numri i kundërvajtjeve në vitin 2013 është 0. Në komunën e Vitisë numri i dënimeve të shkaktuara nga shfrytëzuesit ilegal të pyjeve është 199.268 euro, në komunën e Shtimës numri i dënimeve të shkaktuara nga shfrytëzuesit ilegal të pyjeve është 107 për kundërvajtje dhe 7 penale, në komunën e Vushtrrisë është 25, në komunën e Podujevës 279 dënime, në komunën e Novobërdës në gjykatën Kundërvajtje në Gjilan-Novobërdë janë 36 aktvendime me vepra kundërvajtje me dënim me të holla në verë 2054.93€1 vepër penale, 10 copë fletëparaqitje të pezulluara: janë 7 raste të konfiskimit me vëllim drusor 28.00 m<sup>3</sup> dhe ndaj të gjitha rasteve janë ngritur fletëparaqitje në Gjykatën Themelore në Gjilan dega Novobërdë.

### **Niveli i dënimeve të shkaktuara nga prerjet ilegale**

Në komunën e Gjakovës niveli i dënimeve nga prerjet ilegale është 5%, në komunën e Gjilanit dëmi i shkaktuar nga prerjet ilegale arrinë në 68.983€, në komunën e Malishevës nga prerjet ilegale janë dëmtuar 411 m<sup>3</sup> dru, në komunën e Lipjanit nga gjykata janë pranuar 218 aktvendime pozitive me vëllim 306.12m<sup>3</sup> kurse numri i dënimeve në m<sup>3</sup> është gjithsej 398.71m<sup>3</sup>. Komuna e Prizrenit është përgjegjur se niveli i dënimeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është i ulët. Në komunën e Kamenicës dëmi i shkaktuar nga prerjet ilegale është 275 m cub në vlerë prej 17.739 euro. Po ashtu, në komunën e Ferizajt niveli i dënimeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është i lartë, dëmet e shkaktuara gjithsejtë janë 1945 m<sup>3</sup>. Në komunën e Kaçanikut niveli i dënimeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është 880.40m<sup>3</sup>, ndërkaq në komunën e Istogut janë dëmtuar 699.50 m<sup>3</sup> masë drunore. Në komunën e Ranillugut dhe Hanit të Elezit niveli i dënimeve



të shkaktuara nga prerjet ilegale është i ulët në komunën e Dragashit niveli i dëmeve është 21.35 m<sup>3</sup>, ndërkaq komuna e Kllokotit nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e dënimeve ngase me këtë fushë menaxhon komuna e Vitisë. Në komunën e Klinës niveli i dëmeve në pyje është në rënie e sipër, në komunën e Fushë Kosovës nuk ka të raportuar për ndonjë prerje ilegale, në Deçan, Drenas dhe Mitrovicë niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerja ilegale është e ulët, komuna e Junikut, Rahovecit dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në Shtërpcë prerja ilegale 536,99m<sup>2</sup>, në komunën e Graçanicës niveli i dëmtimit në vitin 2013 është 0. Në komunën e Vitisë niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është 199.268 euro, në komunën e Shtimës niveli i dëmeve nuk është i madh, komuna e Mamushës, Skenderaj nuk kanë dhënë përgjigje; në komunën e Vushtrrisë është 242.33 m<sup>3</sup>; në komunën e Podujevës rreth 1400 kubik; në komunën e Obiliqit dëmi është shumë i vogël, në komunën e Pejës niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është 737m<sup>3</sup>, në komunën e Prishtinës niveli i dëmeve të shkaktuara nga prerjet ilegale është 283.76 m<sup>3</sup> e që janë iniciuar në gjykata, në komunën e Novobërdës pyjet private janë pranuar 177 kërkesa për prerjen në pyje private të shqyrtuara janë 112 kërkesa gjithsej leje për prerjen trungjeve janë 3251.20 m<sup>3</sup>, fletë përcjelljet e lëshuara 425copë vështrime profesionale janë 25 raste.

### **Niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarret**

Për vitin 2013 në komunën e Gjakovës nuk ka pasur ndonjë dëm nga zjarri, në atë të Gjilanit niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarret është 304 ha, në komunën e Malishevës dëmi i shkaktuar nga zjarret kap vlerën e 56.000,00€, në komunën e Lipjanit niveli i dëmeve nga zjarri është 85 ha, në komunën e Prizrenit zjarret kanë dëmtuar 176 ha, në komunën e Kamenicës dëmet nga zjarri konsiderohen të jenë 2 ha pyje publike, kurse në komunën e Ferizajt dëmet e shkaktuara nga zjarri janë 20.3 hektar në sektorin shtetëror dhe 8.8 hektar në atë privat. Po ashtu, edhe në komunën e Kaçanikut ka pasur dëme të shkaktuara nga zjarri, niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarret në pyje është 1,75 ha. Për fat të mirë në komunën e Istogut nuk ka patur dëme nga zjarri, kurse komuna e Ranillugut, Klinës, Rahovecit, Mitrovicës, Mamushës, Skenderajt, Podujevës, Prishtinës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Hani të Elezit niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarret është i ulët, në atë të Dragashit niveli i dëmeve nga zjarri është 2776,00 €, kurse në komunën e Kllokotit pylli nuk është i dëmtuar për shkak se pyjet janë në nivel të ulët, në komunën e Fushë Kosovës, zjarret fushore dhe malore 80 raste, në Deçan nuk ka ndonjë rast, në Drenas nuk ka pasur këtë vit prerje ilegale, gjatë vitit 2013 në komunën e Junikut ka pasur gjithsejtë 3 zjarre në lokacione të ndryshme me përmasa jo te mëdha të cilat kanë përfshirë një sipërfaqe prej afro 7 hektarësh kryesisht kullosa në pjesën e Bjeshkës së Junikut. Në Shtërpcë dëmet nga zjarri ishin në sipërfaqe prej 40 h, në Graçanicë niveli i dëmit nga zjarri 2013-0, 2012- 30 ha. Tek niveli i dëmeve të shkaktuara ng zjarret të dhënat për komunat janë: Në komunën e Vitisë niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarret është 89.940 euro; Në komunën e Shtimës nuk ka pasur dëme nga zjarri, në komunën e Vushtrrisë është 147 ha, në komunën e Obiliqit dëmi është shumë i vogël, në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 nuk ka pasur dëme nga zjarret, në komunën e Novobërdës niveli i dëmeve të shkaktuara nga zjarri janë djegur toka pyjore, kultura me një sipërfaqe prej 37.60 ha, ku përpiluar raporti i vlerësimit të dëmeve nga komisioni dhe është dorëzuar nja kopje në APK. Nga stacioni policor, njësi i hetimeve janë 5 kërkesa për vlerësimin e dëmeve në pyjet.

## **NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR FUSHA TË NDRYSHME TË SEKTORIT TË BUJQËSISË DHE FUQIZIMI I MËTEJSHËM I SHËRBIMEVE KËSHILLIMORE BUJQËSORE DHE RURALE PËR FERMER, GRUPE TË FERMERËVE, OJQ**

*Ndërmarrja e veprimeve nga komuna në fuqizimin e shërbimeve këshillimore bujqësore për fermer dhe OJQ*

### **Qendrat për Këshilla Rurale dhe Këshilla për Biznese janë themeluar dhe janë funksionale (numri i qendrave funksionale, pajisja e tyre etj)**

Në komunën e Gjakovës janë në funksion 5 qendra për dhënie të këshillave, në komunën e Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Kamenicës, Dragashit janë themeluar dhe janë funksionale qendrat për këshilla rurale dhe këshilla për biznese, komuna e Prizrenit, Mamushës, Obiliqit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq në komunën e Ferizajt është bërë formimi i grupeve liderë të fermerëve për dhënie të këshillave dhe informata të ndryshme. Komuna e Kaçanikut e ka zyrën për trajnime e cila është e pajisur dhe funksionale, kurse komuna e Istogut ka vetëm 1 këshilltar për këshilla të fermerëve. Komuna e Ranillugut e ka qendrën për këshilla rurale plus edhe RDA-në, në komunën e Hanit të Elezit, Vitisë, Graçanicës, Klinës, Fushë Kosovës, Deçanit dhe Klllokotit nuk janë formuar ende qendrat këshillimore. Në Drenas, komuna ka zyrën dhe Qendra e Biznesit one stop shop që merret me këshilla për fermerët dhe bizneset dhe janë funksionale 1 në qendër dhe ka pajisjet e duhura. Në komunën e Junikut ekzistojnë qendrat për këshilla rurale dhe janë funksionale. Në komunën e Rahovecit në kuadër të Drejtorisë për BPZHR, kemi ekspertin për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve për fermer, program ky i mbështetur nga Departamenti i Zhvillimit Rural dhe shërbimeve këshillimore pranë MBPZHR. Ekzistojnë këshillëdhënësit në kuadër të departamentit për zhvillim rural në komunën e Shtërpçës. Në Mitrovicë kemi zyrtar të trajnuar për këtë çështje, të cilët me punën e tyre u ndihmojnë fermerëve dhe OJQ-ve, për të aplikuar në grante të ndryshme të MBPZHR-së dhe në grante të BE-së. Në komunën e Shtimes është themeluar një qendër është duke funksionuar, në komunën e Vushtrisë është caktuar zyrtari për shërbime këshillimore si dhe infrastrukturën e nevojshme për organizimin e tyre, komuna e Skenderajt është përgjigjur formimi i grupeve për sektorët e ndryshme të bujqësisë, në komunën e Podujevës janë themeluar dhe janë funksionale dhe janë organizuar trajnime të ndryshme, në komunën e Pejës në kuadër të drejtorisë për bujqësi ekziston shërbimi këshillimor i cili ofron këshilla për fermer, në komunën e Prishtinës qendrat për këshilla rurale nuk shquhen për një funksionalitet të mirë; komuna e Novobërdës ka një Qendër për Këshilla Rurale.

### **Këshillime profesionale të vazhdueshme për fermerët (numri i fermerëve, lloji i këshillimeve, numri i publikimeve, broshurave, fletëpalosjeve etj)**

Në komunën e Gjakovës janë mbajtur 20 këshillime për vreshtari, lavërtari, pemëtari dhe blegtori, në komunën e Gjilanit deri tani janë formuar 8-të grupe me gjithsejtë 45 përfaqësues. Të trajnuar janë 1790, fermerë nga ky shërbim, lloji i këshillimeve ishte: aplikimi i teknologjive të reja në të gjithë sektorët bujqësor, në kultivimin e drithërave perimeve pemëve, mbarëshkrimin

e të gjitha llojeve të kafshëve. Në komunën e Malishevës janë këshilluar 42 fermerë në fusha të ndryshme si: plehërimi i pemëve në fazën e frytë dhënies, kultivimi i grurit dimëror, qarkullimi bimor dhe rëndësia e tij, rëndësia e mikroelementeve, mbajtja e librit amzë në ferma, lëvrimi i tokave bujqësore në vjeshtë, ushqimi voluminoz i lopëve qumështore, sëmundjet dhe dëmtuesit në sera, ndërkaq broshurat shpërndahen nga niveli rajonal për bujqësi, në komunën e Lipjanit është bërë trajnimi i 120 fermerëve në fushën e blegtorisë, pemëtarisë, lavërtari dhe perimekulturë. Në komunën e Prizrenit janë mbajtur këshillime në ngritjen profesionale (pemëtari, vreshtari, blegtori, marketing etj) për 100 fermer, janë shpërndarë 100 broshura, 500 fletëpalosje dhe 100 katalogë. Në komunën e Kamenicës bëhen këshillime të vazhdueshme në ngritjen tekniko-profesionale të fermerëve në: blegtori, pemëtari, perimtari dhe bletari. Tek komuna e Ferizajt vazhdimisht ju jepen këshilla profesionale fermerëve duke organizuar trajnime në lëmi të bujqësisë (pemëtari, lavërtari përim-kulturë), ndërkaq në komunën e Kaçanikut fermerëve vazhdimisht i ofrohen këshilla në fushën e bujqësisë, me organizimin e trajnimeve në formë grupe dhe individuale si dhe ofrimi i broshurave për lëmit e bujqësisë. Këshillat profesionale jepen përmes zyrtarëve komunal të bujqësisë, si dhe trajnimet që organizohen mbahen nga këshilltarët e rrjetit të shërbimeve këshillimore. Në komunën e Istogut Këshillimet bëhen nga këshilltari komunal dhe ata të Departamentit të Këshillimores pranë Ministrisë së Bujqësisë. Në komunën e Ranillugut janë këshilluar 66 fermerë, në komunën e Hani të Elezit janë mbajtur 5 trajnime me fermerët nga ESG ku janë bërë vizita tek fermerët si dhe janë dhënë këshillime rreth mënyrës së mbjelljeve të tyre në sektorin e hortikulturës, në komuna e Dragashit janë mbajtur 5 këshillime për 520 fermerë, kurse komuna e Klllokotit ka ofruar këshillime për fermerët të organizuara nga MBPZHR-ja, si dhe nga organizatat e huaja për proshtime të perimeve, blegtori dhe pemëtari etj. Në komunën e Klinës janë organizuar këshillime për fermer për periudhën korrik-dhjetor me tema të veçanta të cilat mbahen në teren. Gjerë më tani janë mbajtur 6 këshillime, 65 fermer kanë kërkuar këshilla në Drejtori, Drejtoria për bujqësi në bashkëpunim me Ministrinë e linjës ka shpërndarë Broshura informuese me të cilat janë këshilluar fermerët mbi mbrojtjen e bimëve, në lavërtari, pemëtari, bletari, higjienën e kafshëve, në komunën e Fushë Kosovës bëhet nga profesionistët komunal dhe nga profesionistët nga Ministria e Bujqësisë dhe nga organizatat OJQ –“HAFER” dhe profesorët e fakultetit të Bujqësisë, ndërsa në komunën e Deçanit këshillimet profesionale janë në vazhdimësi. Këtë vit janë realizua 14 takime me fermer, 1 tubim informues me 174 fermer dhe 123 këshilla individuale. Këshillime me fermer 145, vizita ne 16 fshatra, trajnime 5. Ndërsa në Drenas trajnime dhe këshilla nga blegtoria, pemëtaria dhe lavërtaria, po ashtu janë mbajtur takime me fermerët më 39 grupe në nivel të çdo fshati që kanë edhe liderët që i mbrojnë interesat e tyre, ku janë njoftuar për hartimin e planit të bizneseve të lëmive të ndryshme, është bërë informimi edhe nëpërmjet mjeteve të informimit dhe radios mandej publikimeve si fletëpalosjeve, broshurave etj. Gjatë vitit 2013 në komunën e Junikut janë mbajtur gjithsej 4 këshillime ku kanë marrë pjesë rreth 52 fermer, temat e këshillimeve kanë qenë për ujitje, menaxhimi i fermave, ruajtja e pemëve dhe perimeve pas vjeljes, po ashtu janë përpiluar disa broshura nga MBPZHR. Komuna e Rahovecit dhe ZAMV nuk ka dhënë përgjigje. Në komunën e Shtërpcës fermerët kanë qasje në këshilltarë. Nëpërmjet tyre kanë mundësi informimi. Në Mitrovicë fermerët dhe OJQ-të çdo herë e më shumë, po përfitojnë grante të ndryshme për bujqësi dhe zhvillim rural. Në Graçanicë MBPZHR organizon një numër të madh të seminareve edukuese për rëndësinë e bujqësisë. Në komunën e Vitisë janë dhënë këshillime profesionale

për perim-kulturë, pemëtari, për fermer si dhe fermerët informohen po ashtu edhe në bazë të broshurave për të gjitha kategoritë e kulturave bujqësore blegtorale - të përgatitura nga MBZHR), në komunën e Shtimes këshillime profesionale janë mbajtur për 50 fermerë: pemëtari, blegtori dhe perimtari, në komunën e Mamushës 1 zyrtarë është caktuar nga ana e MBPZHR si këshill dhënës -150 fermer - praktike dhe teorike; në komunën e Vushtrrisë vepron në kuadër të MBPZHR, në komunën e Skenderaj janë ofruar shërbime këshilluese për fermer, në komunën e Podujevës janë realizuar 7 Këshillime si: analizat e tokës, silazhimi, Barnatoret bujqësore, Përdorimi, i kemikaleve, Bletari, Mëtimi i mollës, Gruri, Misri etj, në komunën e Obiliqit 50 fermer janë trajnuar në këto fusha: shpezëtar, pemëtar etj, ku 16 fermer janë ndihmuar me pajisje për Bujqësi (motokultivator dhe makina shpërndarëse); në komunën e Pejës numri i fermerëve që kanë marr këshilla është: për grante 489,për aplikim 249, informata për subvencione 264, këshilla teknike në teren 197, komuna e Prishtinës nuk ka dhënë përgjigje, komuna e Novobërdës ka dhënë këshilla dhe ka mbajtur trajnime me fermerë në ngritjen e kapaciteteve për bujqësi, blegtorët, aplikime për subvencione etj, numri i fermerëve në pjesëmarrje në këshillime ka qenë 8 dhe nga 10 pjesëmarrës në trajnim.

### **Fushatat vetëdijesimi të qytetarëve për rëndësinë e bujqësisë dhe shërbimet këshillimore për fermerë dhe OJQ (numri i takimeve, pjesëmarrësve, lloji i informimit-media të shkruara dhe elektronike etj)**

Në komunën e Gjakovës janë mbajtur 15 takime për vetëdijesimin e qytetarëve për rëndësinë e bujqësisë, në të cilat kanë marr pjesë afro 150 fermer. Në komunën e Gjilanit numri publikimeve është 20 broshura, 14 fletëpalosjeve, 4 fushatat vetëdijesimi të qytetarëve për rëndësinë bujqësisë dhe shërbimet këshillimore për fermerë dhe OJQ. Në komunën e Malishevës informimi kryesor bëhet përmes Radio Malishevës si i vetmi medium elektronik, si dhe kontakteve drejtpërdrejta me fermerët. Komuna e Lipjanit është përgjigjur se në kuadër të këshillimeve kemi bërë disa aktivitete, në komunën e Prizrenit janë mbajtur 15 takime me OJQ-të, komuna e Kamenicës, Klinës,Podujevës, Graçanicës, Deçanit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar të dhëna. Ndërkaq, në komunën e Ferizajt është bërë fushat e vetëdijesimit për rëndësinë e bujqësisë dhe shërbimet këshillimor të fermerëve përmes informimit dhe kontaktimit me qendrën për këshillime bujqësore. Komuna e Kaçanikut është përgjigjur se për të gjitha aktivitetet mbahen evidenca, statistika për mbjellje të kulturave bujqësore, si dhe për produktivitetin bujqësor mbahen rregullisht dhe raportohen në MPBZHR, kurse në komunën e Istogut fushatat e vetëdijesimit realizohen qoftë përmes takimeve me fermerë dhe biznesmenë por edhe përmes medieve, fletushkave dhe fletëpalosjeve-aktivitete që ndodhin në vazhdimësi. Komuna e Ranillugut ka mbajtur 8 takime me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për rëndësinë e bujqësisë, në komunën e Hanit të Elezit janë mbajtur 5 takime nga ESG- ja dhe 4 trajnime me projektin e BE-së, të implementuar nga Xhelal Luma dhe SHPK, "UKA - SARAJ". Fushata e vetëdijesimit është bërë kryesisht përmes këshillimeve me broshura, gjithashtu edhe në komunën e Dragashit janë organizuar fushata të vetëdijesimit përmes këshillimeve dhe broshurave të ofruara, ndërkaq komuna e Klllokotit fushatën e vetëdijesimit e ka bërë në bashkëpunim me organizatat e ndryshme ndërkombëtare, në komunën e Fushë Kosovës përmes broshurave të dhuruara nga Ministria e Bujqësisë janë shpërndarë 8 broshura janë publikuar, në Drenas janë bërë këshillime për sistemin e ujitjes "Ibër Lepenc"ku kanë qenë të ujitura më së 373 ha, po ashtu janë bërë këshillime për korrje shirjet dhe është bërë monitorimi i

tyre. Gjatë vitit 2013 është mbajtur 1 takim informues me fermerë dhe po ashtu shërbime këshillimore iu është ofruar sipas kërkesave së tyre ku në disa raste janë informuar përmes shpalljeve publike edhe përmes ueb faqes së komunës së Junikut. Në komunën e Rahovecit trajnimet organizohen 2 herë në javë për sektorët e caktuara të bujqësisë. Gjithashtu Drejtoria për BPZHR për vitin 2013 ka mbështetur 3 OJQ me programe "Për Zhvillim Rural". Në Shtërpçë ekzistojnë takime, seminare në bashkëpunim me Ministrinë e bujqësisë, departamentet komunal si dhe OJQ/së,. Në komunën e Mitrovicës sa i përket fushatës së vetëdijesimit për rëndësinë e bujqësisë, mbajnë trajnime dhe po ashtu shpërndajnë edhe fletëpalosje. Në komunën e Vitisë janë mbajtur rreth 25 trajnime për fermerët e të gjitha kategorive, drejtoria e bujqësisë është duke vazhduar trajnimet dhe fushatat vetëdijësuese për kulturat bujqësore; në komunën e Shtimes publikimet janë bërë nga MBPZHR, fushatat janë në vazhdimësi: praktikat e llogaritjes së kostos së prodhimeve bujqësore. Në komunën e Mamushës janë shpërndarë broshura nga MBPZHR, si dhe ka pasur takime me OJQ-të;, në komunën e Novobërdës përpos trajnimeve dhe këshillave dhe shpallje në ueb faqe të komunës si gjatë muajve të ardhshëm është duke u përgatitur një udhërrëfyes për fermerë, në komunën e Vushtrrisë janë themeluar 5 grupe nga 20 fermerë gjithsejtë 100 të cilët janë këshilluar në fushat: blegtori, perim kulturë, bletari, sektori i drithërave dhe pemëtari. Është bërë 1 publikim, 1 fletëpalosje, mbi 12 takime me rreth 150 fermer si dhe njoftim në tabelë të shpalljeve dhe radion lokale, në komunën e Skenderajt ofrimi informatave për grande, subvencione nga MBPZHR, në komunën e Obiliqit OJQ-të që veprojnë në territorin e Obiliqit janë: Agronet, Intersivo, Haifer; në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 janë shpërndarë 1,250 broshura me temat: teknika e menaxhimit të fermës, kultivim i grurit, diversifikim rural, menaxhim i drejtë i fermës së deleve, teknologjia e prodhimit të fidaneve të perimeve. Gjatë fushatës së vetëdijesimit të fermerëve janë mbajtur 16 takime këshillimore ku kanë marrë pjesë 263 fermer; në komunën e Prishtinës sa i përket sensibilizimit të qytetarëve rreth rëndësisë së bujqësisë organizohen takime të vazhdueshme me qytetar me që rast informohen rreth risive në lëmin e bujqësisë e të tilla takime janë me dhjetëra brenda vitit ,po ashtu edhe nëpërmes shpërndarjes së broshurave-fletëpalosjeve profesionale.

## **5. KONTROLI FINANCIAR**

*Zhvillimi i auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit (mfk) në sektorin publik në harmoni me standardet dhe praktikat ndërkombëtare*

### **ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

#### **Themelimi i Njesisë Komunale për Auditim të Brendshëm**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Ranillugut, Klinës, Deçanit, Drenas, Fushë Kosovës, Junikut, Shtërpçës, Rahovecit, Mitrovicës, Graçanicës, ZAMV, Vitisë, Shtimes, Mamushës, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës, Novobërdës dhe Dragashit NJKAB-i është themeluar dhe funksionon, kurse komuna e Hanit të Elezit dhe Klllokotit ende nuk e kanë të themeluar NJKAB-in.

## **Themelimi i Komitetit për Auditim të Brendshëm**

Në komunën e Gjakovës është në proces të themelimit Komiteti për Auditim të Brendshëm, në komunën e Malishevës KAB-i është i themeluar dhe në përbërjen e saj ka 3 anëtarë, në komunën e Lipjanit, Istogut, Hanit të Elezit, Klinës dhe Shtërpcës KAB-i ende nuk është themeluar, në komunën e Gjilanit, Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt, Kaçanikut, Ranillugut, Dragashit, Deçanit, Drenasit, Graçanicës, Junikut, Rahovecit, Mitrovicës, Vitisë, Shtimes, Vushtrrisë, Skenderajt, Podujevës, Pejës, Prishtinës, Nodobërdës dhe Fushë Kosovës është i themeluar KAB-i, kurse komuna e Kllokotit, Mamushës, Obiliqit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje.

## **Numri i takimeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm gjatë periudhës raportuese**

Komuna e Gjakovës, Deçanit, Junikut, Ranillugut, Graçanicës dhe Vitisë nuk kanë mbajtur asnjë takim të KAB-it, në komunën e Gjilanit 5 takime, në komunën e Lipjanit, Istogut, Klinës dhe Shtërpcës KAB-i ende nuk është themeluar, në komunën e Prizrenit, Kamenicës, Ferizajt dhe Dragashit janë mbajtur nga 3 takime, në komunën e Kaçanikut, Fushë Kosovës, Prishtinës, Shtimes janë mbajtur nga 2 takime, kurse komuna e Hanit të Elezit, Mamushës, Obiliqit, ZAMV-s dhe Kllokotit nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Drenasit, Vushtrrisë, Skenderajt, Pejës, Malishevës, Novobërdës dhe Rahovecit nga 4 takime. Në Mitrovicë për tre mujorin e tretë të vitit 2013 janë mbajtur 2 takime, ndërkaq me më së shumti takime të mbajtura prin komuna e Podujevës me gjithsejtë 6 takime të mbajtura.

## **Numri i Auditorëve të Brendshëm (të certifikuar dhe ata në proces të certifikimit)**

Në komunën e Gjakovës është 1 auditor i brendshëm i cili është në proces të certifikimit, në komunën e Gjilanit janë 4 auditor ku të gjithë janë në proces të certifikimit, në komunën e Lipjanit janë 3 auditor të brendshëm ku njëri nga ta është i licencuar nga CIPF-a, në komunën e Prizrenit, Istogut dhe Ranillugut është vetëm 1 auditor i brendshëm, në komunën e Kamenicës janë 2 auditor prej tyre 1 i certifikuar dhe 1 në proces të certifikimit, kurse në komunën e Ferizajt gjithsejtë janë 3 auditor të brendshëm, 2 nga ta janë në proces të certifikimit, kurse komuna e Hanit të Elezit dhe Mamushës nuk kanë ofruar përgjigje. Komuna e Klinës, Drenasit, Junikut, Shtimes, Shtërpcë, Malishevës, Kaçanikut, Dragashit, Obiliqit, Novobërdës dhe Skenderajt kanë nga 1 auditor të certifikuar, në Fushë Kosovë, Deçan, Vushtrri dhe Rahovec nga 2 auditor. Në Mitrovicë dhe ZAMV janë nga 3 auditor të licencuar. Në komunën e Graçanicës numri i auditorëve është 4, ndërsa në procesin e certifikimit është 1.

Në komunën e Vitisë 2 auditor, 1 i certifikuar dhe 1 në proces, në komunën e Podujevës gjithsej janë 6 auditor të certifikuar, komuna e Pejës dhe Prishtinës kanë nga 3 auditor të certifikuar.

## **Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e Auditorit të Brendshëm gjatë periudhës raportuese**

Në komunën e Gjakovës, gjatë periudhës raportuese për vitin 2013, nga raportet e Auditorit të Brendshëm janë dhënë 2 rekomandime, në atë të Gjilanit 41 rekomandime, në komunën e Malishevës janë dhënë 7 rekomandime, në komunën e Lipjanit janë dhënë 26 rekomandime, në komunën e Prizrenit janë dhënë 15 rekomandime, në komunën e Kamenicës janë dhënë 15 rekomandime, kurse në komunën e Ferizajt janë dhënë 27 rekomandime. Po ashtu, edhe në

komunën e Kaçanikut numri i rekomandimeve të dhëna arrin shifrën 33, ndërkaq në komunën e Istogut janë dhënë 16 rekomandime, komuna e Ranillugut ka dhënë 2 rekomandime, komuna e Hanit të Elezit është përgjigjur se ende nuk është themeluar NJKAB-i dhe KAB-i, në komunën e Dragashit janë dhënë 26 rekomandime, ndërkaq komuna e Klllokotit dhe Mamushës nuk kanë ofruar përgjigje. Në Komunën e Klinës dhe Fushë Kosovës, auditori ka dhënë gjithsej nga 20 rekomandime në vitin 2013, në Deçan 47 rekomandime, në Drenas 41 rekomandime, në Junik numri i rekomandimeve të dhëna 52 ku pritet implementimi i tyre. Në Rahovec numri i rekomandimeve gjatë periudhës raportuese janë 75 rekomandime, në Shtërpçë 20 rekomandime, numri i rekomandimeve të dhëna për periudhën janar-dhjetor 2013 në komunën e Mitrovicës është 39, në Graçanicë numri i rekomandimeve të dhëna në raporte është 15, kurse në ZAMV, dhe Viti janë dhënë nga 5 rekomandime, në komunën e Shtimës janë dhënë 3 rekomandime, në komunën e Vushtrrisë janë dhënë 13 rekomandime, në komunën e Skenderaj gjatë periudhës raportuese janë dhënë 29 rekomandime, në komunën e Podujevës gjithsej 12 rekomandime, komuna e Obiliqit ka marrë rekomandim nga auditori lidhur me rritjen e kapacitetit një zyrtar të brendshëm të auditimit, në komunën e Pejës janë dhënë 47rekomandime nga auditori i brendshëm, në komunën e Prishtinës janë gjithsej 10 rekomandime të dhëna në raportet e auditorit të brendshëm, në komunën e Novobërdës numri i auditimeve të planifikuara sipas planit vjetor është 5 kurse numri i auditimeve të kryera për të cilat janë përpiluar raportet finale janë 9

#### **Numri i rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara**

Për vitin 2013 në komunën e Gjakovës nuk ka asnjë rekomandim të pranuar dhe të zbatuar, në komunën e Gjilanit janë pranuar 41 rekomandime, kurse 18 janë zbatuar, në komunën e Malishevës dhe Hanit të Elezit janë pranuar dhe zbatuar nga 7 rekomandime, në komunën e Lipjanit 11 rekomandime janë zbatuar, komuna e Prizrenit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se janë pranuar rekomandimet, në komunën e Kamenicës janë zbatuar 9 rekomandime plotësisht, ndërkaq në komunën e Ferizajt janë 6 rekomandime të pranuar dhe të zbatuara. Komuna e Kaçanikut është përgjigjur se Plani i implementimit të rekomandimeve nuk është bërë nga menaxhmenti ngase është periudhë e shkurtër për zbatim. Në komunën e Istogut janë pranuar 6 rekomandime kurse vetëm 3 rekomandime janë zbatuar, në komunën e Ranillugut janë pranuar dhe zbatuar 3 rekomandime, ndërsa në komunën e Dragashit numri i rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara është 8. Sa i përket komunës së Klllokotit, Mamushës, Obiliqit dhe Junikut, këto komuna nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Klinës 2 rekomandime janë zbatuar tërësisht, në Fushë Kosovës 10 rekomandime janë zbatuar tërësisht, në komunën e Deçanit 11 rekomandimet të pranuar dhe të zbatuara, në Drenas 11 rekomandime janë në proces të implementimit, në Rahovec numri i rekomandimeve gjatë periudhës raportuese janë 75 rekomandime, ndërsa në Shtërpçë janë 7 rekomandime. Në Mitrovicë për periudhën janar-dhjetor janë 12 rekomandime, në ZAMV 3 janë zbatuar dhe 15 rekomandime në komunën e Graçanicës. Në komunën e Vitit janë pranuar 5 rekomandime pa vërejtje, në komunën e Shtimes 2 rekomandime janë zbatuar, në komunën e Vushtrrisë janë dhënë 6 rekomandime, në komunën e Skenderajt numri i rekomandimeve të pranuar dhe të realizuara është 9, në komunën e Podujevës numri i rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara është 10, në komunën e Pejës janë pranuar 47 rekomandime, kurse 20 janë zbatuar, në

komunën e Prishtinës janë 3 rekomandime të pranuar dhe zbatuara, në komunën e Novobërdës numri i rekomandimeve të zbatuara është 5.

### **Numri i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht**

Në komunën e Gjakovës 3 rekomandime janë në proces të zbatimit, në komunën e Gjilanit pjesërisht janë zbatuar 9 rekomandime, në komunën e Malishevës janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, në komunën e Lipjanit janë zbatuar pjesërisht 11 rekomandime, në komunën e Prizrenit pjesërisht janë zbatuar 5 rekomandime, në komunën e Kamenicës janë zbatuar 6 rekomandime pjesërisht, kurse në komunën e Ferizajt pjesërisht janë zbatuar 7 rekomandime, Komuna e Kaçanikut është përgjegjës se Plani i implementimit të rekomandimeve nuk është bërë nga menaxhmenti ngase është periudhë e shkurtër për zbatim. Në komunën e Istogut 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërkaq në komunën e Ranillugut nuk ka ndonjë rekomandim të zbatuar pjesërisht, në komunën e Hani të Elezit numri i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 4, në komunën e Dragashit numri i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 18, kurse komuna Kllkotit, Vitisë, Mamushës, Obiliqit dhe Junikut nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Klinës 18 rekomandime vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2014, në Fushë Kosovës 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, në Deçan 3 rekomandime të zbatuara pjesërisht, në Drenas 18 rekomandime janë në proces të implementimit, sipas planit të veprimit rekomandimet priten të zbatohen brenda vitit 2013, ndërsa disa të tjerë deri në fund të vitit 2014. Në komunën e Rahovecit janë 30 rekomandime të zbatuara pjesërisht dhe 1 rekomandim ishte në komunën e Shtërpçës. Në Komunën e Mitrovicës janë zbatuar 11 rekomandime, në Graçanicë numri i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 15, kurse në ZAMV janë zbatuar 2 rekomandime pjesërisht. Në komunën e Shtëmës 1 rekomandim, në komunën e Vushtrisë janë dhënë 4 rekomandime, në komunën e Skenderajt të realizuara pjesërisht 14 dhe rekomandime të cilat ju janë adresuar personave përgjegjës dhe pritet realizimi i tyre janë 5, në komunën e Podujevës nuk ka, në komunën e Pejës 10 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, në komunën e Prishtinës janë dhënë 4 rekomandime të zbatuara pjesërisht, kurse në komunën e Novobërdës numri i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 2.

### **Numri i rekomandimeve të pazbatuara dhe arsyet**

Në komunën e Gjakovës nuk ka ndonjë rekomandim të pazbatuar, në komunën e Gjilanit rekomandimet e pazbatuara janë 14, prej tyre 1 rekomandim për menaxhimin e rrezikut i është dhënë 6 drejtorive, 1 rekomandim për protokollin unik i është dhënë 4 drejtorive, 1 rekomandim, komuna e Malishevës, Hani të Elezit Klinës, Junikut, ZAMV dhe Kllkotit nuk kanë ofruar përgjigje për këtë fushë, në komunën e Lipjanit nuk janë zbatuar 4 rekomandime kurse arsyeja rreth mos zbatimit të tyre nuk është dhënë. Komuna e Prizrenit, Shtëmës, Mamushës, Obiliqit dhe Kamenicës nuk kanë ofruar përgjigje lidhur me këtë pyetje, kurse në komunën e Ferizajt kanë mbetur pa u zbatuar 7 rekomandime, ku këto rekomandime pritet të zbatohen në vitin 2014, Komuna e Kaçanikut është përgjegjës se Plani i implementimit të rekomandimeve nuk është bërë nga menaxhmenti ngase është periudhë e shkurtër për zbatim. Në komunën e Istogut, Ranillugut, Graçanicës dhe Dragashit 0, në Fushë Kosovës dhe Deçan 6 rekomandime nuk janë zbatuar, në Drenas 12 rekomandime nuk janë zbatuar për shkak të periudhës së shkurtër prej dhënies së rekomandimit deri kur po raportojmë, rekomandime të pazbatuara nuk ka në komunën e Rahovecit. Në komunën e Shtërpçës 12 rekomandime, në



Mitrovicë janë 16 rekomandime të pazbatuara dhe arsytet e mos zbatimit të tyre janë se disa kërkojnë kohë më tepër e disa nuk kanë vullnet për tu realizuar. Në komunën e Vitisë rekomandimet e auditorit të brendshëm për vitin 2013 nuk janë zbatuar, në komunën e Vushtrrisë janë dhënë 3 rekomandime – 2 rekomandime e pazbatuara janë nga raporti i fundit i cili është finalizuar me datë 30.12.2013, përcjellja për zbatim do të bëhet në TM/2014 kurse rekomandimi i mbetur i pazbatuar është për mos dorëzim të regjistrimit të automjeteve për furnizim me karburante – OE sipas kontratës së nënshkruar nga AK, në komunën e Skenderajt 1 është i pa realizuar, në komunën e Podujevës nuk ka, në komunën e Pejës 17 rekomandime të nuk janë implementuar, në komunën e Prishtinës janë dhënë 3 rekomandime të pazbatuara, në komunën e Novobërdës numri i rekomandimeve të pazbatuara është 2.

## **ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MFK**

### **Vetë-vlerësimi i Sistemit të MFK i finalizuar dhe dorëzuar në Njësine Qendrore të Harmonizimit**

Në komunën e Gjakovës është bërë vetëvlerësimi i sistemit të MFK-së, komuna e Gjilanit, Malishevës, Ferizajt Lipjanit, Hanit të Elezit, Dragashit, Klinës, Drenasit, Gracanicës, Rahovecit Skenderajt, Prishtinës, Novobërdës, Obiliqit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje për këtë fushë, komuna e Prizrenit është përgjigjur se korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare në fushën e MFK/së zbatohen sipas ligjeve dhe standardeve Evropiane. Në komunën e Kamenicës njësi i auditimit raporton në baza tremujore tek njësi qendror i harmonizimit të auditimit të brendshëm, kurse komuna e Kaçanikut është përgjigjur se jemi duke punuar rreth finalizimit të vetë vlerësimit të sistemit të MFK-së. Komuna e Istogut nuk e ka bërë vetë-vlerësimin e Sistemit të MFK-së/ Menaxhimi i Financave të Kosovës, komuna e Ranillugut ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se vetë vlerësimi i sistemit të MFK-së është në proces, ndërkaq në komunën e Klllokotit vetë vlerësimi i MFK-së është finalizuar dhe dorëzuar në MF, në Fushë Kosovës vet-vlerësimi dorëzohet në NJQH/ AB çdo 3 muaj, në Deçan është bërë vetëvlerësimi i sistemit të MFK, Komuna e Junikut ka bërë Raportime të rregullta me TM1, TM2 TM3 dhe TM4 në Njësine Qendrore për Harmonizim, komuna e Shtërpçës ka ofruar përgjigje pozitive. Në Mitrovicë zbatimi i kornizës ligjore dhe standardet ndërkombëtare në fushën e MFK nuk është në nivel të kënaqshëm dhe pas rekomandimeve të auditorit gjeneral tani janë në fazën e furnizimit të një softueri për menaxhimin e financave publike komunale që posedon një siguri të lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Në komunën e Vitisë vetëvlerësimi i sistemit të MFK-së është i finalizuar është dërguar në Njësine Qendrore të Harmonizimit dhe është kthyer i vlerësuar – viti 2013, kryetari i komunës ka pranuar rekomandimin e zyrës për integritet, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm, në komunën e Shtimes vetë vlerësimi bëhet në baza vjetore, në fund të vitit, komuna e Mamushës është përgjigjur plotësisht, në komunën e Vushtrrisë është bërë me datë 09.01.2014, në komunën e Podujevës është dorëzuar tek njësi qendrore e harmonizimit, Ministria e Financave, në komunën e Pejës raporti i vet-vlerësimit është dorëzuar në afatin e përcaktuar.

## **6.PUNËSIMI, POLITIKA SOCIALE DHE POLITIKA E SHËNDETIT PUBLIK**

*Adoptimi i politikave të përfshirjes sociale dhe anti-diskriminuese si dhe masave për përmirësimin e situatës së grupeve të cenuara*

**MASAT E NDËRMARRA NGA KOMUNA NË PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SOCIO-EKONOMIKE TË GRUPEVE TË CENUARA (KOMUNITET PAKICË, PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE, ETJ)**

### **Strategjia komunale ka të integruar politikat e punësimit dhe atyre sociale**

Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Hanit të Elezit dhe Dragashit e posedojnë strategjinë komunale për ri-integrim, komuna e Malishevës është përgjigjur se qendra për punësim në nivelin komunal është në kompetencën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, komuna e Lipjanit është përgjigjur se strategjia komunale i ka të integruar politikat e punësimit dhe ato sociale, komuna e Prizrenit ka ofruar përgjigje se komuna ende nuk i kanë të integruar politikat e punësimit dhe atyre sociale. Shërbimet sociale janë decentralizuar në vitin 2010, ndërsa ato të punësimit ende nuk janë decentralizuar. Ndërmjetësimi në punësim ende kryhet përmes Zyrës rajonale të punësimit si njësi e departamentit të punësimit të MPMS. Komuna e Kamenicës, Kaçanikut, Fushë e Kosovës, Prishtinës, ZAMV-s dhe Ranillugut nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq në komunën e Ferizajt përmes strategjisë komunale është bërë integrimi i politikës së punësimit dhe asaj sociale. Komuna e Istogut dhe Kllokotit një strategji të tillë nuk e posedojnë, por politika e punësimit është e inkuorporuar në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal e po ashtu edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore. Komuna e Klinës është përgjigjur se Strategjia është punuar nga Instituti i politikave Sociale(në kuadër të MPMS. Komuna e Deçanit ka Starategji për integrim, komuna e Drenasit i zbaton politikat e punësimit dhe atyre sociale gjithnjë në bazë të ligjit, programeve për punësim sezonal, konkurseve të rregullta, projekteve bashkëfinacuese me OJQ etj. Në komunën e Junikut politikat sociale dhe anti diskriminuese janë të adaptuara, të përfshira dhe të respektuara në përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Komuna e Rahovecit në bazë legjislacionit që rregullon fushën sociale është e obliguar që të ofrojë shërbime sociale të cilat janë minimum i standardeve të përcaktuara nga DMS/MPMS, në këtë drejtim Komuna është duke dhënë përkrahje QPS-së në zbatimin e këtyre standardeve. Sa i përket punësimit në komunën e Shtërpçës për periudhën raportuese kanë pasur projekte të punëve publike dhe projekte për persona të riatdhesuar dhe rikualifikime, ZKP gjatë kësaj periudhe përmes projekteve te UNDP - (trajnim në punë) ka punësuar persona të riatdhesuar. Në Komunën e Mitrovicës në kuadër të aktiviteteve në përfshirjen e ofrimit të shërbimeve sociale dhe konform mundësive ka filluar të bëhet mbyllja e një pjesë të Qendrave Kolektive (ku 18 familje janë vendosur nëpër banesa me nga afro 50 anëtarë). Në Graçanicë ka aktivitete të iniciuara në lidhje me mënyrën e qasjes në ndihmat sociale. Në komunën e Vitisë në një masë të caktuar politikat komunale janë të integruara në politikat e punësimit dhe atyre sociale, përmes punësimit në sektorin privat dhe publik si dhe ofrimit e shërbimeve sociale në të mirë të qytetarëve, komuna e Shtimës është përgjigjur se strategjia komunale ka të integruar politikat e punësimit dhe atyre sociale, në komunën e Mamushës nuk ka pasur asnjë rast të tillë, në komunën e Vushtrrisë Strategjia komunale e hartuar gjatë vitit

2013, brenda vetes ka integruar politikat e punësimit dhe atyre sociale, me qëllim të lehtësimit dhe arritjes së objektivave të politikës së komunës. Megjithatë, politikat e tilla nuk janë në nivelin e kënaqshëm dhe presim reflektim më serioz për procesin në vijim. Në komunën e Skenderajt gjatë kësaj periudhe janë mbështetur shumë familje si në sferën sociale ashtu edhe në atë shëndetësore. Mbështetja është realizuar me mjete financiare në fushën e mjekimit dhe strehimit si dhe në fushën e shërbimeve dhe asistencës sociale, në komunën e Podujevës ka strategji për të integruar politikat e punësimit si dhe atyre sociale, komuna e Obiliqit është përgjigjur me po, në komunën e Pejës ekziston “Strategjia komunale për të integruar politikat e punësimit dhe ato sociale”, në komunën e Novobërdës qendra për punë sociale ka plan vjetor që merret me punë kërkuese dhe persona të riatdhesuar, kërkon punëdhënës dhe i selekton nevojat për punë të punë kërkuesve dhe i punëson.

### **Numri i vizitave të QPS-ve grupeve të cenuara**

Në komunën e Gjakovës bëhen vizita të kohëpaskohshme dhe sipas nevojës tek grupet e cenuara, në komunën e Gjilanit gjatë vitit 2013, QPS ka realizuar mbi 600 vizita grupeve të cenuara duke përjashtuar edhe mbi 2400 vizita që i bëhen 1200 familjeve që marrin ndihma sociale, në komunën e Malishevës janë bërë 368 vizita në terren, në komunën e Lipjanit janë realizuar gjithsejtë 332 raste të grupeve të cenuara nga QPS. Komuna e Prizrenit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se QPS-ja bënë vizita gjatë tërë vitit dhe në bazë të kërkesave, shihet se një numër i madh kanë nevojë për kujdes social. Komuna e Kamenicës ka realizuar gjithsejtë 7 vizita, kurse komuna e Ferizajt ka realizuar 248 vizita të grupeve të cenuara. Një numër rekord të vizitave ka bërë komuna e Kaçanikut me gjithsejtë 1640 vizita, ndërsa komuna e Istogut ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se QPS në vazhdimësi bënë vizita, qoftë rastet që aplikojnë për asistencë apo edhe ato familje që konsiderohen në nevojë për ndihmë. Komuna e Ranillugut ka shënuar një numër rekord sa i përket vizitave të grupeve të cenuara me gjithsejtë 1270 vizita, komuna e Prishtinës, Skenderajt, Mamushës, Hanit të Elezit, Fushë Kosovës, Graçanicës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Dragashit numri i vizitave është 127, kurse në komuna e Klllokotit ka realizuar përafërsisht 70 vizita në të gjitha programet sociale. Në komunën e Klinës, QPS për grupet e cenuara fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nën kujdestari bënë vizitat 2 herë në vit dhe të moshuarit në Shtëpi të pleqve dhe të miturit e strehuar përkohësisht nga dhuna në familje 1 herë në vit, ndërsa në Deçan vizitat bëhen kohë pas kohe dhe sipas nevojës, në Drenas janë bërë 1462 vizita nga QPS- të rasteve që aplikojnë për asistencë sociale dhe ato familje që kanë nevojë për ndihmë. Në komunën e Junikut nuk ka grupe të cenuara. Në Rahovec QPS duke u bazuar në planin e punës dhe detyrat zyrtare gjatë periudhës raportuese, grupet e cenuara në Komunën e Rahovecit u ka bërë mbi 300 vizita (220 PAK, 12 VDHF, 90 KP etj.). Drejtoria e QPS-së në Shtërpçë përmes komisionit ka bërë 25 vizita këtyre grupeve. Në komunën e Vitisë QPS-ja gjatë vitit 2013, ka pas gjithsej 978 vizita grupeve të cenuara, në komunën e Shtimes janë bërë 3 vizita, në komunën e Vushtrrisë numri është i ndryshueshëm për vitin 2013 arrin 37.000 deri në 4.000 vizita, në komunën e Obiliqit janë bërë 20 vizita, në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 gjithsejtë janë realizuar 220 vizita: 197 vizita i takojnë të grupeve të cenuara, kurse 23 janë refuzuar për shkak të mos plotësimit të kriterëve, në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 gjithsejtë janë realizuar 220 vizita: 197 vizita i takojnë të grupeve të cenuara, kurse 23 janë refuzuar për shkak të mos plotësimit të kriterëve, në komunën e Novobërdës deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast të tillë.

## **Numri i personave/familjeve të identifikuar që kanë nevojë për kujdes social**

Në komunën e Gjakovës janë identifikuar 1232 familje me 5283 persona, në komunën e Gjilanit numri i familjeve dhe personave që kanë nevojë për kujdes social të vazhdueshëm është 58, në komunën e Malishevës janë evidentuar 830 familje me nevoja, komuna e Lipjanit ka ofruar përgjigje se janë 135 fëmijë me nevoja të veçanta nga mosha 1-18 vjet të cilëve u ofrohet përkrahje materiale, në vlerë prej 100€ në muaj. Kjo ndihmë materiale u jepet pa marrë parasysh gjendjen ekonomike të familjeve. Po ashtu, janë mbajtur aktivitete nga NJDNI si debate, tryeza të rrumbullakëta, trajnime e aktivitete me rastin e muajt tetor, muaj i personave me nevoja të veçanta për inkuadrim të barabartë pa diskriminim, ku dhe janë ofruar ndihmë për këtë kategori në vlerë prej 500€. Gjithashtu, edhe në këtë pyetje komuna e Prizrenit ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke thënë se janë identifikuar disa raste që u nevojitet kujdesi social. Këto raste janë kur familja përbëhet nga bashkëshort të moshuar për të cilët është i domosdoshëm kujdesi permanent nga personi i tretë. Në komunën e Kamenicës gjithsejtë janë identifikuar dhe ndihmuar për kujdes social 289 persona. Ndërkaq, në komunën e Ferizajt numri i personave që kanë nevojë për përkujdesje sociale është 956, në komunën e Kaçanikut kanë nevojë për kujdes social 79 persona. Në komunën e Istogut janë 687 familje me 2840 anëtarë që përfitojnë asistencë sociale, kurse në komunën e Ranillugut u është ofruar ndihmë grupeve të cenuara ku përfitues janë 769 persona dhe 249 familje. Në komunën e Hani të Elezit janë përfshirë rreth 315 familje që përfitojnë nga Asistenca Sociale, në komunën e Dragashit numri i personave/ familjeve të identifikuar që kanë nevojë për kujdes social është 167, në komunën e Klllokotit numri i familjeve të evidentuara janë 88 familje me gjithsejtë 390 anëtar të familjes. Në komunën e Klinës 1054 është numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale në fund të vitit 2013, Fushë e Kosovës, Mitrovica, Graçanica, Junikut, Mamushës dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në Drenas numri i personave 6811/kurse i familjeve 1491 që përfitojnë asistencë sociale. Në Rahovec në SNS janë rreth 700 familje me mbi 2800 persona që janë trajtuar nga SNS/QPS. Në Shtërpçë, 12 familje janë identifikuar në këtë kategori dhe janë në asistencë të këtij lloji, kurse në Mitrovicë janë 2075. Në komunën e Vitisë 978 familje dhe 2827 persona janë identifikuar që kanë nevojë për kujdes social, këtu bëjnë pjesë familjet dhe personat të cilëve ju ofrohet ndihmë sociale dhe shërbime sociale; në komunën e Shtimës janë 4 familje (16 anëtarë); në komunën e Vushtrrisë në asistencë sociale për momentin janë 1585 shfrytëzues (duhet theksuar, vetëm kryefamiljari e jo personave), kurse në shërbimet sociale përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuar 147, strehimi familjar të afërmit 39, strehim familjar në komunitete 2, dhe shërbime tjera sociale që janë ofruar për afërsisht 1500 persona, komuna e Skenderaj nuk ka dhënë përgjigje; në komunën e Podujevës nuk ka ndihmë të ofruar; komuna e Obiliqit nuk ka dhënë përgjigje; në komunën e Pejës QPS ka identifikuar 1.769 persona që kanë nevojë për kujdesin social, mirëpo nga ky numër vetëm 1.404 e realizojnë këtë ndihmë; komuna e Prishtinës ka ndarë për familjet e përfshira në skemën sociale të cilat vizitohen se paku dy herë në vit. Po ashtu me grupet e tjera ka takime të rregullta, konferenca tryeza, në komunën e Novobërdës numri i familjeve të identifikuara në këtë qendër për përkrahje financiare është 350 raste të kujdesit social.

## **Ndihma e ofruar grupeve të cenuara (financiare, në të mira, etj)**

Komuna e Gjakovës është përgjigjur se grupet e cenuara përfitojnë mjete financiare, në komunën e Gjilanit numri i familjeve dhe individëve të ndihmuar financiarisht për vitin 2013 është 924 raste. Komuna e Malishevës ka ofruar përgjigje se qendra për pune sociale ka vepruar me urgjencë ku ka identifikuar 10 raste të dhunës në familje. Sa i përket dhunës në familje, në komunën e Lipjanit ndihmë ju është ofruar nga NJDNI me vizita në teren dhe në bashkëpunim me policinë dhe punëtorët social të QPS-së. Janë mbajtur takime me OJQ vendore dhe lokale për parandalimin e dhunës në familje, vizita në zonat rurale dhe urbane me nxënësit e shkollave fillore e të mesme për parandalimin e dhunës në familje. Komunitet pakicë janë përfshirë në të gjitha takimet dhe aktivitetet. Përveç takimeve dhe aktiviteteve ata i gëzojnë të gjitha të drejtat e barabarta në çdo aspekt në secilin drejtori dhe institucion duke respektuar të drejtën e fjalës dhe gjuhës. Në komunën e Prizrenit grupeve pa dallim që kanë nevojë për ndihmë iu është ofruar si në material ndërtimor në meremetimin e shtëpive familjare e po ashtu edhe në ndarjen e banesave sociale në shfrytëzim. Komuna e Kamenicës, Skenderajt, Mamushës dhe Graçanicës nuk kanë ofruar të dhëna, kurse në komunën e Ferizajt janë ndihmuar grupe të cenuara për 224 persona. Po ashtu edhe komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2013 ka ofruar ndihmë momentale me mjete financiare për 52 persona, ndërkaq në komunën e Istogut familjet/individët përfitues, marrin ndihmë në para sipas kategorisë së kualifikuar dhe numrin e anëtarëve në familje. Nga ana tjetër, Komuna në këtë periudhë raportuese ka ndihmuar 80 persona që lëngojnë nga sëmundjet e ndryshme, si dhe janë ndërtuar 7 shtëpi për të pa strehët. Komuna e Ranillugut u ka ofruar ndihmë financiare 773 personave dhe 44 familjeve, në komunën e Hani të Elezit në vitin 2013 janë evidentuar 2 raste me djegie shtëpie dhe strehim, ku komuna ka ofruar ndihmë në të holla në shumën prej 1000€, si dhe ka ofruar shtëpi banimi për personin e pa strehë, në komunën e Dragashit ndihma e ofruar grupeve të cenuara është 5318, në komunën e Klokotit numri i familjeve të cilëve u është ofruar ndihma janë 88 familje me gjithsejtë 390 anëtar të familjes. Në komunën e Klinës, QPS nuk ka fonde për të ofruar ndihma, ndërsa në Fushë Kosovës aktivitete e realizuar gjatë vitit 2013 implementimi i projektit "Fuqizimi i Grave për një të ardhme më të mirë", në Deçan numri i ndihmave të ofruara varion, në Drenas komuna ka ndihmuar grupet e cenuara sipas kategorive, personave më aftësi të kufizuara 10.000, për shërim dhe rehabilitim 40 raste Hendikosi për implementim të programit 10.200E me gjithsej 1250 persona ju ka ndihmuar 57 fëmijëve në rehabilitim e përmasimin e dy renovime të shtëpive, 250 familje ju janë dhënë ndihme emergjente me artikuj ushqimor miell. Në komunën e Junikut Q.P.S-përmes S.N.S, ka ndihmuar 420 familje me rreth 1800 persona me shumë prej 30,800.00 euro. Në komunën e Rahovecit përveç ndihmës sociale në të holla, janë ofruar edhe ndihma në ushqim dhe veshmbathje. Në komunën e Shtërpcës 13 familjeve janë ofruar ndihma emergjente financiare prej 100-300 euro, për periudhën raportuese 2013 janë bërë 25 vizita në terren. Në Mitrovicë ndër aktivitete nga Drejtoria për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, është përkujdesja për rastet me gjendje të rëndë ekonomike-sociale duke iu ofruar shërbime sikurse pako ushqimore, material ndërtimor për meremetimin e të paktën një dhome për banim. Pagesën e qerasë për rastet në nevojë, ndërsa komuna është angazhuar në zgjidhjen e çështjes së banimit të komunitetit RAE. Në ZAMV janë drejtuar rreth 1250 persona me nevoja të ndryshme sociale, ku nga fillimi i vitit 2013 e deri më tani, ndihmë kanë kërkuar gjithsej 450 persona. Në komunën e Vitisë ndihma financiare përmes asistencës sociale, ndihmë momentale-financiare si dhe ndihmë në ushqim dhe

veshmbathje grupeve të cenuara të popullatës; në komunën e Shtimës janë ndihmuar me pako ushqimore 8 familje; në komunën e Vushtrrisë ofrohen këto shërbime: asistencë sociale, ndihmë momentale, strehimin familjar, strehim familjar në komunitete, ndihma financiare për fëmijë me aftësi të përhershëm të kufizuara si dhe shërbimet tjera të cilat nuk paguhen me mjete financiare; në komunën e Podujevës janë ndihmuar 58 familje; në komunën e Obiliqit afërsisht 750 raste me një përqindje të madhe të minoriteteve; në komunën e Pejës, 1.404 individëve u ofrohet ndihmë financiare; komuna e Prishtinës është përgjigjur se në vitin 2012 janë ndarë 100.000 euro për familje, individë edhe shoqata që merren me fushën sociale. Krahas 100.000 eurove janë ndarë edhe ndihma me rastin e festave të ndryshme; në komunën e Novobërdës qendra për punë sociale gjatë periudhës janar-dhjetorë ka pas një rast të grupit të cënuar dhe janë marrë masat e sistemimit të këtij rasti.

### **Komuna a ka përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajt OJQ-të janë të përfshira në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, në komunën e Malishevës OJQ-të angazhohen për ofrimin e shërbimeve, sidomos të personave me aftësi të kufizuara ku janë evidentuar 130 raste, komuna e Lipjanit bashkëpunon me OJQ-në Amici de Bambini dhe përmes ueb-faqes ka lansuar njoftimin për fushatën sensibilizuese për strehim familjar. Po ashtu, DSHPS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-në Terre des Hommes e cila përmes QPS-së është duke ndihmuar familjet sociale. Komuna e Prizrenit i ndihmon OJQ-të ad hoc në ofrimin e shërbimeve sociale, mirëpo komuna ende nuk ka ndonjë marrëveshje për ndonjë periudhë më të gjatë me ndonjë OJQ që ofron shërbime sociale sepse ende nuk është bërë licencimi i OJQ-ve si dhe profilizimi i tyre. Për ofrimin e kujdesit social komuna do të nënshkruaj marrëveshje me OJQ -të si dhe grupe të tjera p.sh.: grupe studentesh për kujdes social shtresave që kanë nevojë. Po ashtu, komuna në të ardhshmen e afërme ka paraparë ndërtimin edhe të një qendre për persona të moshës së tretë që kanë nevojë për përkujdesje. Komuna e Kamenicës ka përfshirë Kryqin e Kuq, Hendikosin, Amiqi de bambini për fëmijët në strehim familjar strehimorja "Liria" në Gjilan në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale. Komuna e Kaçanikut ka bashkëpunim të mirë në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale me OJQ-të sidomos me Handikos dhe Kryqin e Kuq. Komuna e Istogut mbështet OJQ-të në ofrimin e shërbimeve sociale si dhe në financimin e projekteve të ndryshme, si OJQ-në "Handikos" por edhe projekte që kanë të bëjnë me promovimin e barazisë gjinore. Gjithashtu, edhe komuna e Ranillugut ka përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, komuna e Hanit të Elezit ende nuk ka angazhuar asnjë OJQ për ofrim të shërbimeve sociale ngase këto shërbime kryhen nga QPS-ja, komuna e Dragashit, Fushë e Kosovës, Junikut, Graçanicës, Mamushës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq komuna e Klokotit ka përfshirë OJQ-të në këtë fushë duke realizuar dy projekte me zyrën e CARITASIT. Në komunën e Klinës nuk ka OJQ-të të licencuara në këtë lëmi, në Deçan OJQ janë të përfshira në ofrimin e mirëqenies sociale. Në Drenas komuna ka mbështetur OJQ-të, ku ka nënshkruar kontratë bashkëfinancimi me "Caritas Kosovën" për përkujdesje shëndetësore, ofrimi i shërbimeve është kryer në shtëpi. Në komunën e Rahovecit QPS ka një raport të mirë me OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale familjeve dhe personave në nevojë. Shembull: OJQ "Humaniteti", OJQ "Hareja", në komunën e Shtërpcës nuk ka pasur raste të ofrimit të shërbimeve të mirëqenies sociale. Komuna e Mitrovicës me Drejtorinë për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, paguan qeran për Qendrën për Mbrojtjen e Grave

dhe Fëmijëve (QMGF) dhe për një familje i paguan qera Habitatit. Gjithashtu janë ndihmuar dhe ndihmohen Shoqatat e dala nga lufta, Handikos-i, shoqata e të shurdhërve etj për sa i përket ofrimit të shërbimeve të ndryshme për këto kategori. Lidhur me këtë fushë komuna e Vitisë dhe Skenderaj nuk ka ofruar përgjigje; komuna e Shtimes është përgjigjur se ka të përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, në komunën e Vushtrrisë ka të përfshirë numër të caktuar të OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale. Ndihma e tyre ka qenë e fokusuar më shumë në ndihma të ofruara dhe në mbështetje të rasteve të caktuara të komunës, komuna e Podujevës ka të përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale si: mjete financiare, pako ushqimore, veshmbathje, kryqi i kuq; në komunën e Obiliqit ka bashkëpunim me OJQ-të në raste nevojë; në komunën e Pejës në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale marrin pjesë edhe 6 OJQ-të: “Handikos”, “Qendra për jetë të pavarur”, “Lidhja e Invalidëve dhe viktimave të luftës”, “Shoqata e pensionistëve”, “Shoqata e invalidëve të punës” dhe “Qendra për Mirëqenien e Gruas”, në komunën e Prishtinës janë të përfshira OJQ-të si: Handikap internacional, koalicioni i strehimoreve të Kosovës, klubi dëshira etj; në komunën e Novobërdës AMICI DE BABINI OJQ-së e cila ka ndihmuara dhe ka ofruar përkrahej për strehim të fëmijëve.

**OFRIMI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE TË GJITHA KOMUNITETEVE MINORITARE, ME PRIORITET KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTAS, SI DHE KRYERJA E VEPRIMEVE PËR PËRMIRËSIMIN E REGJISTRIMIT, ZVOGËLIMIN E KONTAMINIMIT ME PLUMB DHE RRITJA E SHKALLËS SË VAKSINIMIT NË MESIN E BASHKËSISË RAE; NGRITJA E KAPACITETEVE TË NJËSISË PËR METALE TË RËNDA BRENDA MSH-SË**

*Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për komunitetet pakicë nga komuna*

**Plani i Veprimit Komunal përfshin komunitetet pakicë duke i kushtuar rëndësi të veçantë komunitetit RAE**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Prizrenit, Ferizajt, Klinës, Deçan është miratuar Plani i Veprimit Komunal ku tretman dominues ka komuniteti RAE, komuna e Malishevës është përgjigjur se komuniteti pakicë është i përfshirë dhe respektohet edhe pse kemi një numër të vogël të pakicave, komuna e Lipjanit është përgjigjur se i ofrohet shërbimi për të gjitha komunitetet përmes këtij plani, komuna e Kamenicës, Prishtinës, Kaçanikut, Dragashit, Fushë e Kosovës, Graçanicës, Rahovecit dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar të dhëna, kurse në komunën e Istogut plani i veprimit është në hartim e sipër, mirëpo duhet përmendur se QKMF-ja ka një plan veprimi që parasheh formën e komunikimit me Komunitetin RAE (Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptas). Komuna e Ranillugut nuk e posedon planin e veprimit komunal, ndërkaq komuna e Hanit të Elezit, Kllokotit dhe Junikut nuk kanë komunitet RAE, në Drenas dhe Shtërpçë, Mitrovicë kujdesi parësorë shëndetësor bëhet pa dallim, jo diskriminues, profesional për të gjithë qytetarët e komunës. Në komunën e Vitisë në kuadër të misionit që ka kujdesi primar dhe planit të punës për vitin 2013 është paraparë kujdesi i veçantë për kategoritë e rrezikuara siç janë: fëmijët, shtatzënat, të sëmurit kronikë, shtresat në asistencë sociale si dhe komunitetet pakice që të ju ofrohet shërbimi me një përkujdesje të veçantë, të barabartë në shërbimet shëndetësore duke filluar nga edukimi, prevenimi, imunizimi, mjekimi primar dhe

diagnostifikimi në kryesisht në QKMF dhe në QMF-të tjera; në komunën e Shtimës plani i veprimit komunal është hartuar me datë 18.09.2013; komuna e Mamushës është përgjigjur se nuk ka dallim për asnjë person sikurse të gjithë qytetarët e tjerë; në komunën e Vushtrrisë ky plan është në zbatim e sipër; komuna e Skenderaj nuk ka dhënë përgjigje; në komunën e Podujevës është miratuar, në komunën e Obiliqit është në proces të formimit; në komunën e Pejës plani i veprimit komunal është miratuar dhe në vazhdimësi e përkrah komunitetin RAE si komunitet pakicë, në komunën e Novobërdës drejtorja për shëndetësi nuk ka miratuar apo përgatitur planë të veprimit për përkushtim të veçantë për komunitetin rom.

### **Komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore (numri i pacientëve pakicë, lloji i shërbimeve shëndetësore të ofruara, etj)**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Prizrenit, Ferizajt, Kaçanikut, Istogut, Klllokotit, Klinës, Drenasit, Deçan, Rahovec, Shtërpcë, Mitrovicë, Hani të Elezit, Vitisë, Shtimes, Vushtrrisë, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës, Novobërdës, Klllokotit dhe Fushë Kosovës, të gjitha komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore, komuna e Kamenicës, Graçanicës dhe Dragashit nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq komuna e Ranillugut është përgjigjur se nuk ka pasur asnjë pacient, në komunën e Junikut nuk ka komunitet pakicë. Në ZMAV ka mundësi për të dalur në ndihmë personave në nevojë dhe personave të riatdhesuar për sigurimin e kujdesit shëndetësor parësor, sepse në këtë moment atë nuk e lejon situata në terren.

### **Fushatë informative për komunitetet pakicë rreth shëndetit familjar, parandalimin e infektimit, vaksinimit, etj)**

Komuna e Gjakovës është përgjigjur se kjo fushë bëhet në kuadër të strategjisë ku ofrojnë informata për parandalimin e infektimit dhe vaksinimit për të gjithë qytetarët pa dallim, në komunën e Gjilanit bëhen fushata informative duke përfshirë të gjitha komunitetet pa dallim, në komunën e Malishevës bëhet fushatë duke i vizituar komunitetet pakicë edhe në shtëpitë e tyre, në komunën e Lipjanit në vazhdimësi sektori i shëndetësisë i DSHP-së dhe QKMF-së organizojnë fushata sensibilizimi rreth parandalimit të sëmundjeve, në komunën e Prizrenit të gjitha fushat informative për komunitetin pakicë kryhen përmes projekteve edukativo-shëndetësore të cilat realizohen brenda vitit nga sektori i shëndetësisë pranë Drejtorisë Komunale për Shëndetësi. Në komunën e Ferizajt vazhdimisht bëhet fushat informative për komunitetin pakicë, kurse komuna e Kaçanikut, Dragashit, Junikut, Novobërdës, Mamushës, Graçanicës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar të dhëna. Në komunën e Istogut informimi bëhet përmes medie të shkruara dhe atyre elektronike/broshurave, fletëpalosjeve dhe të ngjashme dhe se kjo fushatë bëhet sipas kalendarit të vaksinimit për fëmijë dhe të rritur. Po ashtu mbahen ligjërata për higjienën personale, sëmundjet ngjitëse, etj. Në komunën e Ranillugut nuk është bërë asnjë fushatë, kurse në komunën e Hani të Elezit kryhen shërbimet e kujdesit primar, shërbimi i stomatologjisë, shërbimi i vaksinimit, shërbimi i laboratorit, shërbimi emergjent dhe shërbimi i rëntgenit, si dhe komuna e Klllokotit ka realizuar projektin për informimin e komunitetit (gruas) për mbrojtjen kundër kancerit të gjirit. Në komunën e Klinës në kuadër të fushatës për informim dhe vetëdijesimin, parandalimin e etheve hemorragjike dhe shfrytëzimin e shërbimeve, janë zhvilluar fushata informuese, të komuniteteve të ndryshme, ndërsa në



Komunën e Fushë Kosovës në vazhdimësi është punuar në sensibilizimin shëndetësor të komunitetit RAE. Në Komunën e Fushë Kosovës, punëtorët shëndetësor kanë vizituar 118 familje të Komunitetit RAE me qëllim të vetëdijesimit shëndetësor –sidomos puna në teren ka pasur qëllim të vaksinimit të fëmijëve. Në Deçan në kuadër të strategjisë kryhet informata për parandalimin e infektimit dhe vaksinimit për të gjithë qytetaret pa dallim, në Drenas dhe Rahovec informimi bëhet përmes medieve të shkruara elektronike dhe broshurave për të gjithë. Edhe komuna e Shtërpçës sikur komunat e tjera është e përfshirë në vaksinim. Mitrovica sa i përket fushatave informative për komunitetet pakicë rreth shëndetit familjar, parandalimin e infektimit, vaksinimin e tjerë, të gjitha komunitetet kanë qasje në mënyrë të barabartë në të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me preventivën mjekësore. Në komunën e Vitisë nuk ka fushatë të veçantë për promovim të vaksinimit, në komunën e Shtimes vetëm vaksinimi është kryer plotësisht, në komunën e Vushtrrisë nëse kërkohet nga komuniteti pakicë janë të gatshëm t’iu ofrojmë dhe këto shërbime; në komunën e Skenderaj gjatë kësaj periudhe janë mbajtur kontakte me komunitete përmes zyrës për komunitete. Kanë vizituar ambulancën në Bajë dhe Syrigane, dhe kemi ofruar mbështetje nga ana e komunës. Komunitetet nuk kanë paraqite ndonjë kërkesë të veçante. Janë në bisedime për punësimin e një mjeku dhe infermiere (komuniteti serb) në këtë lokalitet. Sa i përket komunitetit mysliman dhe RAE kanë qasje të papenguar në të gjitha shërbimet; në komunën e Podujevës gjatë vitit 2013 nuk është organizuar ndonjë fushat informative; në komunën e Obiliqit janë organizuar nga drejtoria e shëndetësisë; në komunën e Pejës janë organizuar fushatë për vaksinimin e komunitetit RAE. Janë bërë edhe vizita në teren nga ana e Ekipeve mobile për inkurajimin e tyre për t’u vaksinuar. Në kontinuitet mbahen tryeza dhe shpërndahet material propagandues nëpër QMF-të e Komunës dhe përmes medieve të shkruara dhe elektronike; në komunën e Prishtinës komuniteti RAE këshillohen që të sjellin fëmijët e tyre dhe për rëndësin e vaksinimit sipas kalendarit zyrtar. Nëse ata për çfarëdo arsye nuk i sjellin fëmijët kontaktohen përmes telefonit ose përmes ftesës së përsëritur.

### **Komunat kanë qasje pro-aktive në vaksinim (ekipe mobile, etj)**

Komuna e Gjakovës, Gjilanit, Vitisë, Shtimes, Vushtrrisë, Podujevës, Obiliqit, Pejës, Prishtinës dhe Kllokotit kanë qasje pro-aktive në vaksinim, në komunën e Malishevës shërbimi i vaksinimit është azhur dhe i rregullt për të gjithë pa dallim, në komunën e Lipjanit Vaksinimi i fëmijëve të komunitetit RAE bëhet sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit. Vaksinimi i fëmijëve shkollor është mbi 95% për moshat: mosha 6-7 vjet, mosha 12-13 vjet; mosha 18 vjet, ndërsa për moshat 1-5 vjet vaksinimi bëhet me terminë të caktuar në QMF. Në komunën e Prizrenit aty ku nuk mbulohet nga QKMF-të me shërbimin vaksinimit, ekipet mobile të vaksinimit e kryejnë këtë shërbim sipas ligjit për Vaksinim. Komuna e Kamenicës e posedon ekipin i cili vepron sipas planit vjetor për vaksinim ku në baza të rregullta kryen vaksinimin. Komuna e Ferizajt ka qasje pro aktive në vaksinim ku përveç komunitetit RAE janë vaksinuar edhe 87 fëmijë. Komuna e Kaçanikut, Dragashit, Ranillugut, Fushë Kosovës, Novobërdës, Mamushës, Skenderajt, Graçanicës dhe Klinës nuk kanë ofruar përgjigje, ndërkaq komuna e Istogut ka qasje pro aktive në vaksinim dhe ka të organizuara ekipet mobile, ekipe këto që vizitojnë personat që nuk kanë mundësi të vijnë në QKMF. Ekipet mobile (Mjeku, Infermieri/ja,) kryejnë këto shërbime nëpër shtëpi të qytetarëve, e veçmas kujdes i veçantë i kushtohet vizitave tek personat me aftësi të kufizuara. Komuna e Hani të Elezit ka shërbimin

për qasje pro - aktive në vaksinim. Komuna e Deçanit ka qasje pro-aktive në vaksinim, në Drenas vaksinimi bëhet në bazë të planit dhe orarit të vaksinimit për vitin 2013 është 97%, në komunë ekziston edhe sektori i shëndetit publik dhe ekipi mobil për s'mundje ngjitëse dhe vaksinim. Komuna e Junikut nuk ka pakica as minoritete dhe nuk kemi pas plan veprimi për pakica dhe minoritete. Komuna e Rahovecit ka qasje pro aktive në vaksinim dhe ka të organizuara ekipet mobile, ekipe këto që vizitojnë personat që nuk kanë mundësi të vijnë në QKMF. Shtërpa ka qasje pro aktive në vaksinim. Qasja pro aktive në vaksinim në komunën e Mitrovicës për komunitetet në fjalë vazhdon në mënyrë kontinuele, qasje kjo që realizohet nëpërmjet ekipeve mobile dhe Qendrave të Mjekësisë Familjare, ZMAV tani nuk ekziston ekipi mobil për vaksinim i cili në masë të madhe do ta kishte lehtësuar ofrimin e të gjitha shërbimeve mjekësore në terren, ku ato janë të domosdoshme.

## **7. MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE**

*Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin e mjedisit në nivelin qendror dhe lokal*

### **NGRITJA E KAPACITETEVE NË KOMUNËN TUAJ NË SEKTORIN E MJEDISIT**

#### **Numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për zbatimin e legjislacionit mjedisor**

Në Komunën e Gjakovës për vitin 2013 nuk ka pasur ndonjë trajnim për zyrtarët komunal lidhur me zbatimin e legjislacionit mjedisor, në komunën e Malishevës janë mbajtur 8 trajnime për zbatimin e legjislacionit mjedisor, në komunën e Lipjanit nuk është mbajtur asnjë trajnim, në komunën e Prizrenit janë mbajtur 2 trajnime, komuna e Kamenicës ka dhënë përgjigje të përgjithësuar duke thënë se zyrtarët komunal kanë marrë pjesë në trajnim lidhur me legjislacionin mjedisor gjatë periudhës raportuese, kurse komuna e Ferizajt ka mbajtur 4 trajnime. Në komunën e Kaçanikut për vitin 2013 kanë munguar trajnimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit, kurse në komunën e Gjilanit dhe Istogut është mbajtur vetëm nga 1 trajnim për vitin 2013. Në komunën e Ranillugut janë mbajtur 3 trajnime për mjedisin, në komunën e Hani të Elezit janë mbajtur trajnime të ndryshme jo qeveritare por edhe nga institucionet siç është IKAP, në komunën e Dragashit janë mbajtur 2 trajnime për zyrtarët komunal, kurse në komunën e Klllokotit nuk ka pasur trajnime të inspektoratit dhe zyrtarëve për mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit. Në Komunën e Klinës, MMPH ka organizuar 1 trajnim për vendbanimet joformale dhe dy trajnime në 2012 për zyrtarët komunal për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane ( 2 zyrtarë), Fushë e Kosova, Rahoveci, Gracanica, Shtërpa, Prishtina, Novobërda dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje, në Deçan janë mbajtur trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit, 2 trajnime në Drenas. Në komunën e Junikut trajnime për zbatimin e legjislaturës të mjedisit këtë vit nuk ka pasur. Në Mitrovicë janë mbajtur 3 trajnime për leje mjedisore komunale në bashkëpunim me inspektoratin e MMPH-së. Në komunën e Vitisë, Shtimes dhe Skenderajt janë mbajtur nga 2 trajnime për zbatim të legjislacionit mjedisor, në komunën e Mamushës është mbajtur 1 trajnim për legjislacion mjedisor, në komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 4 trajnime për zbatim të legjislacionit mjedisor, në komunën e Podujevës janë realizuar 8 trajnime lidhur me zbatimin e legjislacionit mjedisorë si: efiquencia e energjisë, hulumtimi mbi

ndotjen e tokave, dita e habitateve, sipërfaqet e gjelbëruara, mbeturinat etj;; në komunën e Obiliqit janë mbajtur 6 trajnime për zbatim të legjislacionit mjedisor; në komunën e Pejës gjatë vitit 2013 janë realizuar 3 trajnime për leje mjedisore komunale.

### **Numri i trajnimeve të mbajtura me inspektor komunal të ambientit**

Komuna e Gjakovës, Pejës, Vitisë, Mamushës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe Prishtinës kanë ofruar përgjigje duke theksuar se janë mbajtur 2 trajnime për inspektorët komunal të ambientit, në komunën e Malishevës janë mbajtur 4 trajnime në bashkëpunim me USAID-in, komuna e Gjilanit, Lipjanit, Ferizajt, Istogut, Dragashit, Shtimes, Novobërdës dhe Ranillugut nuk kanë mbajtur asnjë trajnim, në komunën e Prizrenit janë mbajtur 3 trajnime me inspektorë komunal, në komunën e Kamenicës inspektorët e ambientit kanë marrë pjesë në trajnim me temë lejet mjedisore komunale, komuna e Kaçanikut, Fushë Kosova, ZAMV, Hanit të Elezit Shtërpçës, Mitrovicës, Graçanicës dhe Kllokotit nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Klinës është trajnuar 1 inspektor për bujqësisë dhe ambient, në Deçan, Drenas, Podujevë, Junik dhe Rahovec me nga 1 trajnim, në komunën e Obiliqit dhe Prishtinës, janë mbajtur ng 4 trajnime me inspektor komunal të ambientit.

### **Numri i trajnimeve për zyrtarët komunal në trajtimin e vendbanimeve jo-formale**

Në komunën e Gjakovës ka përfunduar trajtimi i vendbanimeve jo -formale, në komunën e Gjilanit janë mbajtur 2 trajnime për zyrtarët komunal në trajnimin e vendbanimeve jo - formale, në komunën e Malishevës nuk ka vendbanime jo formale, komuna e Lipjanit dhe Mitrovicës kanë mbajtur nga 2 trajnime, komuna e Prizrenit, Ranillugut, Kaçanikut, Junikut dhe Istogut nuk kanë mbajtur trajnime lidhur me vendbanimet jo formale, komuna e Kamenicës, Hanit të Elezit, Dragashit, Kllokotit Klinës, Deçanit, Fushë Kosovës, Graçanicës, Novobërdës dhe ZAMV-s nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Ferizajt janë mbajtur 3 trajnime, në Drenas 1 trajnim, 5 trajnime në Rahovec, në Shtërpçë janë mbajtur 3 trajnime për trajtimin e vendbanimeve jo formale të cilat janë organizuara nga ana e MMPH. Në komunën e Vitisë, Mamushës, Skenderaj është mbajtur 1 trajnim me zyrtar komunal për trajtim të vendbanimeve joformale, në komunën e Shtimës janë mbajtur 2 trajnime, në komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 4 trajnime në trajnimin e vendbanimeve jo - formale; në komunën e Podujevës nuk ka pasur asnjë trajnim; në komunën e Obiliqit janë mbajtur 3 trajnime; në komunën e Pejës nuk është mbajtur asnjë trajnim, sepse vendbanimet joformale janë të trajtuara, në komunën e Prishtinës 0 trajnime.

### **Numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane**

Në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Prizrenit, Istogut, Junikut, Ranillugut nuk ka pasur trajnime për zyrtarët komunal për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane, kurse në komunën e Kaçanikut janë mbajtur 2 trajnime për procesin e hartimit te planeve rregulluese urbane dhe kanë marrë pjesë 4 zyrtar. Në Deçan është proces i përfunduar, 1 trajnim në Drenas, në Rahovec 5 trajnime. Për planet rregulluese urbane në Shtërpçë 1 trajnim është mbajtur nga ane e

UN-Habitatit në bashkëpunim edhe me MMPH si dhe 1 me Logos. Në komunën e Vitisë dhe Pejës nuk ka pasur trajnim për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urban; në komunën e Shtimës janë mbajtur 2 trajnime për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urban; në komunën e Vushtrrisë janë mbajtur 4 trajnime për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urban; në komunën e Skenderaj janë mbajtur 8 trajnime për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urban; në Komunën e Podujevës nuk ka pasur; në komunën e Obiliqit janë mbajtur 3 trajnime, komuna e Prishtinës është përgjigjur se Planet rregulluese hartohen nga kompanitë profesionale të kontraktuara, në komunën e Novobërdës plane rregullues nuk ka PZHK e ka hartuar dhe ka pas pjesëmarrje të zyrtarëve komunal gjatë hartimit. Komunat tjera nuk kanë ofruar të dhëna për këtë fushë,

### **Numri i trajnimeve për planerët urban komunal për interpretimin e Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor**

Në komunën e Gjakovës ky proces ka përfunduar, komuna e Lipjanit ka mbajtur 2 trajnime, në komunën e Prizrenit, Istogut, Junikut, Rahovecit, Vitisë, Prishtinës, Pejës dhe Ranillugut nuk kanë pasur trajnime për planerët urban komunal për interpretimin e Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor, në komunën e Ferizajt nuk është mbajtur asnjë trajnim, në komunën e Kaçanikut për planerët urban është mbajtur 1 trajnim dhe kanë marrë pjesë 3 zyrtar, si dhe në Drenas 2 trajnime, në komunën e Shtimës, Vushtrrisë janë mbajtur 2 trajnime për planerët urban komunal për interpretim të ligjit të ri për planifikim hapësinor, në komunën e Skenderajt janë mbajtur 8 trajnime për planerët urban komunal për interpretimin e ligjit të ri për planifikim hapësinor, në komunën e Obiliqit janë mbajtur 3 trajnime. Komuna tjera nuk kanë ofruar të dhëna për këtë fushë,

### **Numri i inspektorëve komunal të ambientit**

Komuna e Gjakovës dhe Prishtinës kanë nga 3 inspektor komunal të ambientit, komuna e Malishevës, Prizrenit, Kaçanikut, Drenasit, Ranillugut, Shtimës, Podujevës, Dragashit, Junik, Klinës, Rahovecit, kanë nga 1 inspektor komunal të ambientit, , në komunën e Kamenicës Vitisë, Vushtrrisë, Pejës, Obiliqit, Deçanit, janë nga 2 inspektor të ambientit, kurse në komunën e Ferizajt, Novobërdës dhe Istogut nuk ka asnjë inspektor. Komunat tjera nuk kanë ofruar të dhëna

### **Vendbanimet jo formale te përfshira në planet hapësinore komunale**

Në komunën e Gjakovës janë 5 vendbanime jo formale, 3 të përzgjedhura dhe 2 në proces të vendbanimeve joformale. Komuna e Malishevës dhe Ranillugut janë përgjigjur se nuk posedojnë vendbanime jo formale, në komunën e Lipjanit janë 7 vendbanime jo formale, komuna e Prizrenit, Hanit të Elezit, Dragashit, Fushë e Kosova, Mitrovica, ZAMV dhe Killokotit nuk kanë ofruar përgjigje, komuna e Kamenicës është përgjigjur se vendbanimet komunale janë të përfshira në PZHK, ndërkaq në komunën e Ferizajt për kohën e raportimit janë përfshirë gjithsejtë 3 vendbanime jo formale. Në komunën e Kaçanikut vendbanimet joformale janë të përfshira në planet hapësinore komunale. Komuna e Istogut është përgjigjur se janë dy vendbanime jo-formale të përfshira në Planin komunal hapësinor. Në komunën e Klinë janë 7 vendbanime joformale që mbeten të përfshihen në PRZH, në Deçan janë përfshirë në planin

zhvillimor hapësinor komunal, në Drenas 3 vendbanime, Poklek, Lagja Feronikeli dhe Komoran (Lagja e Re, në Junik janë gjithsejtë 3 vendbanime joformale të përfshira në planet hapësinore komunale të miratuara, një vendbanim jo formal në komunën e Rahovecit, nuk është trajtuar asnjë vendbanim joformal në komunën e Shtërpçës, Komuna e Graçanicës e ka hartuar Planin Lokal të Veprimtimit në Mjedis dhe i njëjti është duke u implementuar. Tek vendbanimet jo formale të përfshira në planet hapësinore komunale në komunën e Vitisë janë 3 vendbanime jo formale ku janë të përfshira në planet hapësinore komunale 3 vendbanime janë të rregulluara nga 6 sa ishin në fillim të vitit), në komunën e Shtërmës janë 3 vendbanime formale, komuna e Mamushës është përgjegjës se nuk ka vendbanime joformale, në komunën e Vushtrrisë disa vendbanime jo formale janë të përfshira në planet hapësinore komunale; në komunën e Skenderaj janë të evidentuara zyrtarisht dy vendbanime joformale: Runiku dhe Kopiliqi i ulët, këto vendbanime joformale janë të përfshira në planin zhvillimor komunal, në komunën e Podujevës 1 lagje (Lagja e Kuvajtit); në komunën e Obiliqit 5 vendbanime, në komunën e Pejës vendbanimet jo formale janë të përfshira të gjitha, në planet hapësinore komunale: “Zatra”, “Xh.Kada”, “7 Shtatori”, “Kristali” dhe “Asllan çesma”, në komunën e Prishtinës vendbanimet jo formale janë trajtuar përmes planeve rregullative, në komunën e Novobërdës vendbanimet jo formale janë të përfshira në PZHK.

## **TË THELLOHET BASHKËPUNIMI MES INSTITUCIONEVE QË KANË NDIKIM DHE PËRGJEGJËSI NË SEKTORIN E MJEDISIT**

### *Bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe komunës në sektorin e mjedisit*

#### **Numri i aktiviteteve të përbashkëta mjedisore mes komunës dhe ministrive relevante**

Komuna e Gjakovës ka pasur 3 aktivitete, në komunën e Gjilanit në vitin 2013 është realizuar projekti i Studimit të Fizibilitetit për ujëra të zeza dhe inçintri i pastrimit të ujërave nga kompania ( EYG) me donacion nga Komisioni Evropian, në komunën e Malishevës janë zhvilluar 2 aktivitete me ministrin e ambientit, janë vendosur kontejner në gjithë qytezën, si dhe janë përfshirë edhe 8 fshatra në shërbime të grumbullimit të mbeturinave ku janë vendosur pllakat me mbishkrimin “Mos hedhë mbeturina”, në komunën e Lipjanit është mbajtur 1 aktivitet ku është bërë identifikimi i deponive ilegale me AMMK-në, komuna e Prizrenit është përgjegjës se numri i aktiviteteve të përbashkëta mjedisore mes komunës dhe ministrive relevante është 5 aktivitete obligative dhe 10 jo obligative. Komuna e Kamenicës nuk ka ofruar përgjigje, kurse në komunën e Ferizajt ka pasur aktivitete të përbashkëta mjedisore me MMPH “Ta pastrojmë Kosovën”. Në komunën e Kaçanikut ka munguar bashkëpunimi në mes të MMPH-së dhe komunës në veçanti, në mes të inspekcioneve edhe përkundër ftesave të vazhdueshme nga inspekcioni komunal dërguar ministrisë për inspektime të përbashkëta, ndërkaq në komunën e Istogut nuk ka patur ndonjë aktivitet të tillë në vitin 2013. Komuna e Ranillugut ka mbajtur 2 aktivitete, komuna e Hani të Elezit gjatë vitit 2013 me MMPH kanë realizuar aksionin “Ta pastrojmë Kosovën”, monitorimi i rregullt i ndotjes së ajrit nga IHMK, identifikimi i deponive ilegale, pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit. Komuna e Dragashit ka realizuar 3 aktivitete, kurse komuna e Kllokotit nuk ka pasur takime të tilla. Është në vazhdim Projekti i Këshillit të Evropës, MMPH, MBPZHR dhe Komunës së Klinës për inventarizimin e PEJSAZHEVE NATYRORE, Fushë e Kosova nuk ka ofruar përgjigje, në Deçan

ka pasur 2 aktivitete, bashkëpunimi me Ministrinë përkatëse dhe pushtetit lokal, për efikasitetin e arritjes së qëllimeve për mbrojtjen të mjedisit, Komuna e Drenasit në bashkëpunim me (MPHZHR) në sektorin e mjedisit ka bërë këto aktivitete: janë caktuar lokacionet e deponive ilegale në Komunë, ka nxjerrë Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave ka grupin punues, ndër aktivitetet e zhvilluara janë -Zhvillimi i aksionit për pastrimin të mbeturinave me 1 Prill dhe me 22 Prill 2013 të organizuar nga Komuna(DSHP&E realizimi i dy pilot projekteve nga komuna në bashkëpunim me GIZ-in-Gjerman dhe një OJQ për dy bashkësitë në Terstenik dhe Komoran, duke i pajisur më 1300 kontinierë komuna ka blerë 27 kontinierë 1.2 m<sup>3</sup>. Aksioni "Ta pastrojmë komunën". Aksion i përbashkët i komunës së Junikut dhe MMPH-së. Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (dokument), Rehabilitimi i sentimentuesit për trajtimin e ujërave të zeza në lagjen Berishë (investim kapital) etj., Rahovec janë ndërmarr aktivitete Marrëdhëniet e bashkëpunimit janë në nivelin e asistencës në komunën e Graçanicës, në ZAMV Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për licencimin e operatorit dhe deponisë në Ballaban mungon dhe Mitrovica. Në komunën e Vitisë është shënuar 1 aktivitet i përbashkët mes ministrisë dhe komunës; në komunën e Shtimes është shënuar 1 aktivitet (ndotja nga guroret), në komunën e Mamushës është mbajtur Aktiviteti në MPH në përgatitjen e PZHK; në komunën e Vushtrrisë është mbajtur një (1) aktivitet - 24 maji; në komunën e Skenderaj janë mbajtur 6 aktivitete të përbashkëta që vlen të theksohet 1. Identifikimi i deponive ilegale të deponive me AMMK 2. Rregullimi i shtratit të lumit dhe rregullimi për rreth 3. Punimi i kanalizimit në disa fshatra; në komunën e Podujevës është zhvilluar 1 aktivitet lidhur me shpalljen e disa zonave të mbrojtura të natyrës; në komunën e Obiliqit janë realizuar 3 projekte; në komunën e Pejës bashkëpunimi me MMAPH është i kënaqshëm. Gjatë vitit 2013 kemi 2 aktivitete të përbashkëta: Me 24 Maj 2013 është mbajtur aktiviteti i përbashkët "Ta pastrojmë Kosovë për një ditë", është hartuar bashkërishtë "Plani Hapësinor për parkun nacional të Bjeshkëve të Nemuna", në komunën e Prishtinës numri i takimeve të përbashkëta mjedisore me ministrinë relevante vardon prej projekteve të përbashkëta që i kanë brenda vitit dhe aktiviteteve mjedisore të përbashkëta çdo muaj, po ashtu janë mbajtur takime të ndryshme me përfaqësuesit e Ombduspersonit sa i përket aplikimit në nivel lokal të ligjit të zhurmës ku kemi marrë ankesa të ndryshme nga qytetarët. Pjesëmarrje në prezantime të organizuara nga MMPH, me temë - "Studimi i ndotjes së tokës bujqësore në Kosovë". Pjesëmarrje në Ministrinë e Infrastrukturës me temë - "Zvogëlimi i PM nga trafiku, përmbushja e standardeve të BE-së për kualitet të ajrit në qytetin e Prishtinës 2020", me 28.05.2013 tryezë e rrumbullaket me temën "Krimet Mjedisore" akterët MMPH, Komuna e Prishtinës, OSCE, komuna e Novobërdës ka pasur disa takime me ministrin e MMPH rreth mjedisit.

## **IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE MJEDISORE ME QËLLIM TË PËRMIRËSIMIT TË GJENDJES SË MJEDISIT**

### *Zbatimi i politikave mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit*

#### **Krijimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese**

Në këto komuna janë bërë sipërfaqe të reja gjelbëruese: në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Malishevës, Lipjanit, Fushë Kosovës, Vitia, Prizrenit, Kamenicës, Drenasit, Shtërpçës, Vitisë, Shtëmës, Mamushës, Vushtrrisë, Kllokotit, Skenderaj, Klina, Podujevës, Obiliqit, Prishtinës. Ndërsa në këto komuna nuk ka pasur sipërfaqe të reja gjelbëruese: në komunën e Ferizajt, Rahovec dhe Istogut. Kurse komunat tjera nuk kanë ofruar të dhëna.

#### **Niveli i zbatimit të planit lokal të veprimit në mjedis**

Në komunën e Gjakovës dhe Gjilanit është i zbatueshëm në tërësi Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, komuna e Malishevës nuk ka ofruar përgjigje për këtë fushë, komuna e Lipjanit, Kaçanikut dhe Prizrenit ende nuk e kanë aprovuar PLVM-në, komuna e Kamenicës, Ranillugut, Hanit të Elezit, Graçanices, Mitrovicës, Mamushës, Novobërdës, Skenderaj, ZAMV-s dhe Kllokotit nuk kanë ofruar të dhëna, kurse komuna e Ferizajt është përgjigjur se është duke u zbatuar gradualisht plani lokal i veprimit në mjedis. Komuna e Istogut po e zbaton fazën e parë të planit lokal të veprimit në mjedis, ndërkaq komuna e Dragashit është në proces të miratimit të PLVM-së. Në komunën e Kinës, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2009-2015 (i miratuar më 01.10.2009 në Kuvendin e Komunës) është duke u zbatuar, në Fushë Kosovë zbatohet në mënyrë të konsiderueshme, në komunën e Deçanit është hartuar plani i mjedisit nga Drejtoria e Inspektionit, Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike për 2012-2017 dhe është në zbatim rregullorja për lejet mjedisore komunale dhe është miratuar. Komuna e Drenasit dhe Shtërpçë nuk ka Plan lokal të veprimit në mjedis. Komuna e Junikut dhe në Rahovec mesatarisht. Politikat mjedisore janë zbatuar sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit 2011- 2015, ka qenë një nga politikat kryesore. Në komunën e Vitisë plani lokal i veprimit në mjedis vetëm është draftuar - jo funksional, në komunën e Shtëmës zbatohet përmes kompanisë "Pastërtia", në komunën e Vushtrrisë është duke u hartuar PLV në mjedis, brenda 2 muajsh do të përfundohet; në komunën e Podujevës është nivel i shkëlqyer; në komunën e Obiliqit ka zbatim të plot; në komunën e Pejës PLVM është aprovuar më 2010 është duke u zbatuar në nivel të kënaqshëm, në komunën e Prishtinës nuk ka Plan Lokal të veprimit në mjedis, kanë pasur takime me donator dhe iu është premtuar se do të kenë përkrahje në hartimin e këtij plani.

#### **Planet komunale për menaxhimin e mbeturinave të hartuara dhe niveli i zbatimit të tyre**

Komuna e Gjakovës, Lipjanit, Dragashit, Fushë Kosovës, Mamushës, Podujevës dhe Kllokotit nuk e kanë planin për menaxhimin e mbeturinave, komuna e Malishevës është përgjigjur se mbeturinat menaxhohen nga "Eko - Regjioni" përmes njësisë Lumi, komuna e Gjilanit dhe Prizrenit e kanë planin për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, komuna e Kamenicës ka shprehur pakënaqësi lidhur me menaxhimin e ndërmarrjeve regjionale për mbeturina. Ndërkaq, komuna e Ferizajt është përgjigjur se është formuar komisioni i përbashkët në mes të drejtorisë së shërbimeve publike dhe ndërmarrjes regjionale -pastërtia për hartimin e Planit

komunal për menaxhimin e mbeturinave. Komuna e Kaçanikut Deçanit, Graçanicës dhe Hanit të Elezit nuk kanë ofruar përgjigje, kurse komuna e Istogut është përgjigjur se plani për menaxhimin e mbeturinave ekziston dhe i njëjti zbatohet në vazhdimësi. Komuna e Ranillugut ka ofruar përgjigje të përgjithësuar duke potencuar faktin se udhëheqja e mbeturinave komunale bëhet në bazë të Ligjit për formimin e ndërmarrjeve komunale. Në komunën e Kinës, plani i grumbullimit të mbeturinave është duke u zbatuar në tërësi. Rezultati shihet në zgjerimin e grumbullimit të mbeturinave edhe në zona rurale, në komuna e Drenasit në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman janë në procesin e hartimit të planit të menaxhimit të mbeturinave si dhe Implementimin e Pilot projektit për futjen në sistem të menaxhimit të mbeturinave në Komoran dhe Tërstenik, në Junik Plan komunal për menaxhimin e mbeturinave është hartuar dhe është në zbatim e sipër, në Rahovec ka plan për menaxhimin e mbeturinave dhe niveli i zbatimit është shumë i mirë. Planet për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtërpçës janë parapare me PZHK. Në Mitrovicë planet Komunale janë zbatuar sipas strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtjen e Mjedisit. Në ZAMV Licencimi i deponisë në Ballaban nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, licencimi i operatorit PP BOŠ VAL largimi i deponive ilegale në Veri të Mitrovicës -pastrimi i bregut të majtë të lumit Ibër tek tre soliterat, sanimi i kanalizimit në Kodrën e Minatorëve (Mikronaselje) kyçja e dy objekteve banesore në rrjetin e kanalizimit në lagjen Kroi i Vitakut (Brđani). Në komunën e Vitisë Plan komunal për menaxhimin e mbeturinave është hartuar dhe është në fazat e para të zbatimit; komuna e Shtimes dhe Skenderaj nuk kanë ofruar përgjigje, në komunën e Vushtrrisë drejtoria për shërbime publike në koordinim me ndërmarrjen publike “Uniteti” ka planin për menaxhim të mbeturinave i cili është duke u zbatuar pjesërisht, komuna e Obiliqi është përgjigjur plani komunal; komuna e Pejës së bashku me kompaninë e grumbullimit të mbeturinave “Higjiena” ka aprovuar dhe zbaton Planin e Menaxhimit të mbeturinave; në komunë e Prishtinës komuna e ka planin komunal për menaxhimin e mbeturinave po ashtu rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe kanë implementim të mirë, në komunën e Novobërdës edhe më tutje është duke vazhduar menaxhimin e mbeturinave në kuadër të kompanisë Eko Higjiena Gjilan, përmes njësisë në Novobërdë.

### **Raporti i gjendjes së mbeturinave i publikuar**

Në këto komuna është publikuar raporti i mbeturinave: komunën e Gjakovës, Obiliqi, Juniku, Deçan, Drenas, Rahovec Shtërpçë, Istogu, Ferizaj, Malishevës dhe Gjilanit, komuna e Lipjanit është përgjigjur se mbeturina kapin sasinë e 44.61 kg/ në vit për kokë banori, komuna e Prizrenit është përgjigjur se raportin e gjendjes së mbeturinave nuk e përgatit komuna sepse nuk menaxhon me mbeturinat, menaxhimi i mbeturinave bëhet nga KRM Eko Regjioni i cili i raporton ZRUM/së. Ndërkaq, komuna e Klllokotit mban evidencën dhe raporton përpara organeve komunale. Në komunën e Vitisë raportet e gjendjes së mbeturinave janë interne – nuk janë publikuar, në komunën e Vushtrrisë gjendja e mbeturinave është raportuar në kuadër të sistemit të menaxhimit të performancës në MAPL ku prej 67 vendbanimeve 27 prej tyre u ofrohen shërbimet, ky raport është publikuar me 15 janar 2014 në faqen zyrtare të MAPL-së; në komunën e Podujevës është raport i brendshëm komunal. Komunat tjera nuk kanë ofruar të dhëna.



## **Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonës së mbrojtur në komunë i përfunduar**

Studimi i arsyeshmërisë është kryer në komunat e Gjakovës, Pejës, Podujevës, Vitisë, Deçani, Lipjani, Ferizaj. Ndërsa komuna e Istogut dhe Obiliqit nuk kanë patur ndonjë aktivitet në këtë fushë për këtë periudhë raportuese, në Drenas është në proces, komuna e Junikut, Klllokotit dhe Rahovecit nuk kanë zona të mbrojtura. Në komunën e Shtërpcës, zonat e mbrojtura janë paraparë nga ana e ministrisë, në komunën e Shtimës nuk ka zona të mbrojtura në komunë, komuna e Vushtrrisë është përgjigjur se nuk është bërë studimi i arsyeshmërisë, ndërsa komunat tjerë nuk kanë ofruar të dhëna.

## **Numri i gurëthyesve në komunë dhe ndikimi i tyre në ambient**

Në komunën e Gjakovës, Dragashit, Kamenicës, Deçanit, Vushtrrisë, Podujeva, Peja dhe Klllokotit janë nga 2 gurëthyes, në komunën e Malishevës dhe Istogut janë nga 7 gurëthyes, në komunën e Lipjanit janë 9, në komunën e Prizrenit dhe Drenasit janë nga 5 gurëthyes, në komunën e Ferizajt gjithsejtë janë 6 gurëthyes, në komunën e Kaçanikut operojnë 8 gurëthyes. Komuna e Gjilanit, Ranillugut dhe Hanit të Elezit nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Klinës janë 8 gurëthyes, ndërsa Fushë e Kosova, Graçanica dhe ZAMV nuk kanë ofruar përgjigje. Në komunën e Junikut, Skenderaj dhe Shtërpcës është nga 1 gurëthyes. Në e komunës së Mitrovicës dhe Novobërdës janë nga 4 gurëthyes, në komunën e Vitisë dhe Prishtinës janë nga 3 gurëthyes, në komunën e Shtimes 11 gurëthyes (1 gurëthyes i identifikuar si ndotës), në komunën e Mamushës dhe Obiliqit nuk ka gurëthyes.

## **Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbatohet sipas dispozitave ligjore**

Në komunën e Gjakovës, Rahovec, Vushtrria, Peja, Prishtina, Fushë Kosovë, Mitrovica, Ferizaj, Deçani, Junik Istogu, Dragashit dhe Malishevës bëhet tërësisht vlerësimi i ndikimit në mjedis sipas dispozitave ligjore, në komunën e Lipjanit dhe të Prizrenit bëhet nga MMPH-ja, Komuna e Kamenicës e posedon rregulloren komunale, duke theksuar se ka mos-harmonizim të veprimeve në mes të komunës dhe ministrisë, në komunën e Klllokotit, Vitisë dhe Shtimës vlerësimi i ndikimit në mjedis zbatohet pjesërisht, në komunën e Drenasit nga janari i këtij viti kërkohet dhe leja mjedisore komunale, në komunën e Podujevës, Novobërdës dhe Obiliqit zbatohen në tërësi, kurse komunat tjera kanë ofruar përgjigje,

## **8. BASHKËPUNIMI FINANCIAR**

### *Programet e bashkëpunimit ndërkufitar*

#### **Niveli i bashkëpunimit ndërkufitar**

Komuna e Malishevës, Lipjanit është përgjigjur se nuk kemi asnjë projekt në sferën e bashkëpunimit ndërkufitar, në komunën e Gjilanit Këshilli i Evropës hapi Zyrën e Agjencionit për Demokratizim Lokal në Komunën e Gjilanit, që nga atëherë Komuna e Gjilanit është pjesë e Bashkëpunimit Ndërkufitar, komuna e Prizrenit ka ofruar përgjigje duke thënë se zhvillimi i

bazuar në rajone konsiderohet të jetë një qasje e re që mundëson zhvillim të qëndrueshëm të rajoneve rurale ndërkufitare nëpërmjet implementimit të parimit të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe qasjes fleksibile dhe siguron integritet dhe koherencë. Objektivi i përbashkët i një kuadri të tillë është shfrytëzimi i burimeve të mundshme kapitale, lokale dhe kombëtare, si edhe ndihmën e jashtme për krijimin e kushteve dhe ngritjen e kapaciteteve me qëllim të shtimit të konkurrueshmërisë ekonomike të rajonit ndërkufitar të "Sharrit". Komuna e Kamenicës ka potencuar se në bashkëveprim me gjimnazin janë binjakëzuar me një komunë në Turqi dhe në kuadër të kësaj kanë mbajtur takime me MAPL-në lidhur me bashkëpunimet ndërkufitare dhe binjakëzimet, si dhe me promovimin e ligjit lidhur me këtë çështje. Komuna Hani i Elezit ka marrëveshje të bashkëpunimit me komunat e Republikës së Maqedonisë si me komunën e Sopishtës, Haraqinës, Studeniqanit, Shutkës dhe ka realizuar vizita reciproke me komunat në fjalë, ndërkaq në komunën e Kllkotit nuk ka programe të tilla për bashkëpunim ndërkufitar. Në Fushë Kosovë i vetmi projekt në partneritet me komunën e Obiliqit i cili është përzgjedhur është projekti për stimulimin e bizneseve të vogla në lami të bujqësisë me mjete pune i cili është financuar 50%-50% nga komunat dhe MAPL, në Deçan niveli i bashkëpunimit ndërkufitar është në përputhje të plotë të procedurat juridike konform pikëpamjeve institucionale, në Junik momentalisht jemi në fazën fillestare të bashkëpunimit me ç' rast kemi shprehur interesin e përbashkët përmes 4 projekteve për bashkëpunim ndërkufitar dhe shpresojmë që këto projekte të përzgjidhen për financim në mënyrë që të thellojmë bashkëpunimin dhe të krijojmë struktura të përbashkëta për monitorim dhe funksionim. Komuna e Shtërpcës, Mitrovicës, Graçanices, ZAMV, Vushtrisë, Shtimës, Obiliqit, Prishtinës, Pejës dhe Rahovecit nuk kanë dhënë përgjigje, komuna e Drenasit dhe Klina kanë thënë se nuk kanë projektet për bashkëpunim ndërkufitar. Në komunën e Vitisë është mbajtur 1 takim me divizionin për bashkëpunim ndërkufitar përfaqësues ishin nga komuna e Vitisë dhe Kllkotit, ku janë diskutuar projektet e përbashkëta dhe mundësit e bashkëpunimit në të ardhmen, si dhe është diskutuar për projektet e binjakëzimit po ashtu është diskutuar mundësia që në të ardhmën edhe Ministria të asistoj në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkufitar dhe të binjakëzimit, në komunën e Mamushës nuk ka asnjë lloj bashkëpunimi ndërkufitar, komuna e Skenderaj është përgjigjur se nuk ka projekte të përbashkëta ndërkufitare, komuna e Podujevës është përgjigjur se tani për tani nuk kanë bashkëpunim ndërkufitar, komuna e Novobërdës është përgjigjur se deri më tani nuk ka pasur ndonjë bashkëpunim ndërkufitarë as ndonjë projekte vlerësues të përzgjedhur.

### **Numri i projekteve të vlerësuara dhe përzgjedhura**

Në komunën e Gjakovës janë përzgjedhur 41 projekte, në komunën e Gjilanit janë mbajtur konferenca dhe organizimi lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar mirëpo nuk kemi ndonjë numër lidhur me realizimin e projekteve, në komunën e Prizrenit është vlerësuar dhe përzgjedhur 1 projekt, komuna e Kamenicës është në partneritet me komunën e Zhelinës në Maqedoni ku pritet të jetë përfitues i një grandit në vlerë prej 250.000 euro. Komuna e Kaçanikut është përgjigjur se nuk kemi pasur projekte sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar në vitin 2013. Komuna e Istogut nuk ka patur ndonjë projekt ndërkufitar në vitin 2013, ndërkaq komuna e Dragashit ka realizuar 2 projekte. Në Deçan janë realizuar 27 projekte, në komunën e Junikut projektet në të cilat kemi aplikuar për bashkëpunim ndërkufitar janë akoma në fazën e vlerësimit dhe të përzgjedhjes. Në komunën e Vitisë janë iniciuar 3 projekte për bashkëpunim

ndërkufitar për vitin 2014, në komunën e Shtimës janë 2 projekte të përzgjedhura bashkë me komunat fqinje Ferizaj dhe Lipjan, në komunën e Obiliqit 1 projekt është përzgjedhur nga fondi i MAPL-së për zhvillim Ekonomik Regjional 2013, i cili ka qenë në partneritet me Komunën e Fushë Kosovës: titulli i projektit “Zhvillimi i bujqësisë kusht për zhvillim ekonomik”, në komunën e Pejës nuk ka pasur projekte të bashkëpunimit ndërkufitar të përzgjedhur gjatë vitit 2013. Komunitat tjera nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë,

#### **Numri i kontratave të nënshkruara**

Në komunën e Gjakovës janë nënshkruar 41 kontrata, në komunën e Prizrenit janë nënshkruar 4 kontrata, komuna e Kaçanikut dhe Istogut janë përgjigjur se nuk kanë pasur projekte sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar në vitin 2013, kurse komuna e Dragashit dhe Fushë Kosovës kanë nënshkruar nga 1 kontratë. Në Deçan janë 25 kontrata të nënshkruara, Junik dhe Drenasi nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar. Në komunën e Shtimes është 1 kontratë e nënshkruar me komunën e Ferizaj për rrugën Mollopolc-Dremjak, në komunën e Obiliqit është 1 kontratë e nënshkruar, komuna e Pejës ka marrëveshje me Komunën e Plavës (Mali i Zi). Komunitat tjera nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë,

#### **Numri i trajnimeve për aplikuesit potencial (K3 - 2013)**

Në komunën e Gjakovës nuk ka pasur asnjë trajnim, komuna e Kaçanikut është përgjigjur se nuk kemi pasur projekte sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar në vitin 2013. Komuna e Istogut ka ofruar pyetje të përgjithësuar duke vlerësuar se Agjencioni për Zhvillim Rajonal-Perëndim (AZHR) dhe Instituti Riinvest kanë organizuar për zyrtarë komunal të regjionit të Pejës trajnime për përgatitje të projekteve. Në komunën e Dragashit numri i trajnimeve për aplikuesit potencial është 1. Në Deçan 2 trajner, në Junik 4 trajnime, ndërsa Drenasi 2 trajnime. Komunitat tjera nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë,

#### **Thirrja për propozime e finalizuar dhe shpallur**

Në komunën e Gjakovës nuk ka pasur ndonjë propozim të finalizuar, në komunën e Gjilanit thirrja për projekt propozime është shpallur me numër të referencës: EuropeAid /135-229/LACT/MK, komuna e Gjilanit ka aplikuar në thirrjen e lartë shënuar në partneritetet me Komunën e Çairit (Maqedoni ) për masën 1.1, komuna e Kaçanikut dhe Pejës janë përgjigjur se nuk kanë pasur thirrje për projekte sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar në vitin 2013. Në komunën e Istogut janë duke u përgatitur për të aplikuar si për thirrje për propozim – fonde të BE-së ashtu edhe për projekte ndërkufitare. Në Deçan është hapur thirrja për projektet e perbashketa Kosovë-Mali i Zi nga BE-ja. Drenasi është përgjigjur pozitivisht. Fushë Kosova ka qenë pjesëmarrëse në shumicën e trajnimeve dhe thirrjeve për projekte propozime. Në Junik ka pasur 1 thirrje për bashkëpunim ndërkufitar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Komunitat tjera nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë

#### **Strukturat e përbashkëta për monitorim të themeluara dhe funksionale**

Në komunën e Gjakovës janë të themeluara dhe funksionale organet për monitorim, në komunën e Gjilanit pjesë e Sekretariatit të Përbashkët Teknik pjesë e së cilës është Zyra e

Antenës është vendosur në hapësirat e AZHR-së Lindje hapësirë e dhënë nga komuna e Gjilanit. Kjo dëshmon gatishmërinë e Komunës në përkrahjen e proceseve dhe zhvillimeve rajonale ndërkufitare. Komuna e Kaçanikut është përgjigjur se nuk kemi pasur projekte sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar në vitin 2013. Komuna e Istogut ka dhënë përgjigje duke theksuar se nuk ka struktura të tilla të themeluara. Në Juniku jemi në fazën fillestare të bashkëpunimit, nëse përzgjidhet ndonjë projekt atëherë do të krijohen strukturat e përbashkëta për monitorim, kurse në komunën e Drenasit nuk ka struktura të përbashkëta. Komuna e Shtimes ka të themeluara strukturat e përbashkëta të monitorimit, komuna e Obiliqit është përgjigjur se është funksionale, komuna e Pejës nuk ka të themeluara struktura të përbashkëta për monitorim. Komuna tjera nuk kanë ofruar përgjigje në këtë fushë,

## KONKLuzionET

- Të gjitha komunat kanë pranuar udhëzime nga niveli qendror përveç komunave Kamenicë, Skenderaj dhe Istogu të cilat nuk kanë pranuar asnjë udhëzim nga niveli qendror;
- Komunat dhe ministritë kanë ofruar trajnime të ndryshme për nivelin lokal;
- Pjesëmarrja e nëpunësve civil në trajnime është i kënaqshëm;
- Ngritja e performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve në nivelin lokal është evidente;
- Komunat kanë shënuar progres në thjeshtëzimin dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurave;
- Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara nga komunat kanë arritur nivel të kënaqshëm;
- Në komuna ende mbetet i lartë numri i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën fillore, të mesme të ultë dhe atë të lartë;
- Komunat ende nuk menaxhojnë me fondin për ri-integrim;
- Në komuna janë dorëzuar një numër i madh i kërkesave për fondin për ri-integrim;
- Të kthyerit në komuna janë ndihmuar në punësim, arsim, gjuhë dhe trajnime profesionale;
- Bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal në fushën e fondit për ri-integrim është përmirësuar;
- Në komunën e Ferizajt, Klinës dhe Klllokotit ende nuk është hartuar programi zhvillimor për sektorin e bujqësisë;
- Grupi i Veprimtimit Lokal nuk është i themeluar në komunën e Kamenicës dhe Klllokotit;
- Në komuna, niveli i dënimeve për kundërvajtje dhe vepra penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve është i lartë;
- Dëmet e shkaktuara nga zjarret në komuna është i konsiderueshëm;
- Komuna e Hanit të Elezit, Klinës, Fushë, Kosovës, Deçanit, Graçanicës, Vitisë dhe Klllokotit nuk i kanë të themeluar Qendrat për Këshilla Rurale dhe Këshilla për Biznese;
- Njësia Komonale për Auditim të Brendshëm nuk është themeluar në komunën e Hanit të Elezit dhe Klllokotit;
- Komunat Gjakovë, Lipjan, Istog, Shtërpçë dhe Hani i Elezit nuk e kanë të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm;
- Komunat kanë përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale;
- Në të gjitha komunat, komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore;

- Është ngritur bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe komunës në sektorin e mjedisit;
- Komuna e Gjakovës, Lipjanit, Dragashit, Fushë Kosovës, Mamushës, Podujevës dhe Klllokotit nuk e kanë planin për menaxhimin e mbeturinave;

## **REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME**

- Niveli qendror të ofrojë udhëzimet e nevojshme për nivelin lokal;
- Komunat të ofrojnë të dhëna në fushat e përcaktuara nga raporti për PVMSA-në 2013;
- Komunat të ndërmarrin veprime dhe masat duhura lidhur me parandalimin e nxënësve të cilët tentojnë të braktisin shkollën fillore, të mesme të ultë dhe atë të lartë;
- Komunat të menaxhojnë me fondin për ri-integrim;
- Të hartohet programi zhvillimor për sektorin e bujqësisë në komunën e Ferizajt, Klinës dhe Klllokotit;
- Të themelohet Grupi i Veprimit Lokal në komunën e Kamenicës dhe Klllokotit;
- Komunat të ndërmarrin veprime koherente me qëllim të parandalimit të dëmtimit dhe shfrytëzimit ilegal të pyjeve;
- Komunat të jenë vigjilente në parandalimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri;
- Komuna e Hanit të Elezit, Klinës, Fushë, Kosovës, Deçanit, Graçanicës, Vitisë dhe Klllokotit të themelojnë Qendrat për Këshilla Rurale dhe Këshilla për Biznese, këto shërbime këshilluese duhet të ofrohen sipas nenit 28 të Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Të themelohet Njësia Komunale për Auditim të Brendshëm në komunën e Hanit të Elezit dhe Klllokotit në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm;
- Të themelohet Komiteti i Auditimit të Brendshëm në komunat Gjakovë, Lipjan, Istog, Shtërpçë dhe Hani i Elezit në përputhje me nenin 6 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm.
- Komuna e Gjakovës, Lipjanit, Dragashit, Fushë Kosovës, Mamushës, Podujevës dhe Klllokotit të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave siç përcaktohet me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina;



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

Raporti është hartuar nga udhëheqësja dhe zyrtarët e Divizionit për Integritime Evropiane:

**Venera Kosumi** - Klinë, Junik, Deçan, Shtërpçë, Partesh, Graçanicë, Mitrovica e Veriut,  
Mitrovicë, Rahovec, Zveçan, Drenas dhe Fushë Kosovë

**Vjosa Shehu** - Viti, Shtime, Mamushë, Vushtrri, Skenderaj, Podujevë, Obiliq, Pejë, Prishtinë  
Novobërdë, Suharekë, Zubin Potok dhe Leposaviq

**Yll Valla** - Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Lipjan, Prizren, Kamenicë, Ferizaj, Hani I Elezit,  
Kaçanik, Dragash, Istog, Kllokot Dhe Ranillug

Për saktësinë e të dhënave të paraqitura në pjesë të raportit, përgjegjës janë zyrtarët komunal të integritimeve evropiane.

**E drejta autoriale e këtij raporti i takon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.**